



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MIRATOHET**

KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR

**Z. EDI RAMA**

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERJTIKËS

**Znj. BELINDA BALLUKI**

Kryetari i Këshillit Bashkiak

**Znj. Vera Thana**

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 23 Datë 28.02.2019

Kryetari i Bashkisë

**Z. Fiqiri Ismaili**

**PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË VORË**

**RREGULLORE E PLANIT**

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.3, Datë 17.05.2019

HARTOI: BASHKIA VORË

DPKZHT: LUAN BETA

MBËSHTETI: DOGMA, STUDIO B&L, LATITUDE, MILAN INGENIERIA





10

11

12  
13  
14  
15  
16  
17  
18  
19  
20  
21  
22  
23  
24  
25  
26  
27  
28  
29  
30  
31  
32  
33  
34  
35  
36  
37  
38  
39  
40  
41  
42  
43  
44  
45  
46  
47  
48  
49  
50  
51  
52  
53  
54  
55  
56  
57  
58  
59  
60  
61  
62  
63  
64  
65  
66  
67  
68  
69  
70  
71  
72  
73  
74  
75  
76  
77  
78  
79  
80  
81  
82  
83  
84  
85  
86  
87  
88  
89  
90  
91  
92  
93  
94  
95  
96  
97  
98  
99  
100

Pasqyra e lëndës

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	7
Neni 1 - Objektivat dhe drejtimet e rregullores	9
Neni 2 - Afatet dhe vlefshmëria e planit	9
Neni 3 - Zgjidhja e konflikteve dhe mospërputhjeve	9
Neni 4 – Ndryshime apo rishikime të dokumentit të planit	10
Neni 5 - Përkufizimet	10
KREU II – PËRKUFIZIMI I TERRITORIT DHE SISTEMET	15
Neni 6 – Përkufizimi i territorit	17
Neni 7 - 5 sistemet dhe elementët e territorit	17
Neni 8 - Hierarkia territoriale	20
KREU III – PËRCAKTIMI I TERRITORIT PËR PLANIFIKIM DHE ADMINISTRIM	23
Neni 9 – Kriteret e përcaktimit të zonës	25
Neni 10 - Kriteret e përcaktimit të njësive strukturore	25
Neni 11 – Kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës	26
Neni 12 - Kategoritë e parashikuara të përdorimit të tokës për njësitë strukturore me përdorim të përzier (mikse)	29
Neni 13 – Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të	30
Neni 14 – Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të	30
Neni 15 – Kategoritë e ndaluara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të	32
Neni 16 – Ndryshime në përdorimin e parashikuar të tokës për njësitë strukturore	33
KREU IV – NDARJA E TERRITORIT PËR QËLLIME PLANIFIKIMI DHE KONTROLI TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT	35
Neni 17 – Zonimi	37
Neni 18 –Njësitë strukturore	37
Neni 19 – Përcaktimi i njësive strukturore për të cilat hartohet PDV	38
Neni 20 – Rregulla për njësitë strukturore për të cilat parashikohet zhvillimi i PDV-ve	38
Neni 21 – Treguesit dhe rregullat për zonat, njësitë strukturore në	



sistemin bujqësor	39
Neni 22 – Rregulla dhe kritere të përgjithshme për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore	41
Neni 23 – Njësitë strukturore me përdorim bujqësi dhe natyrë	42
Neni 24 - Mënyra e ndërhyrjes në territor sipas përdorimeve të lejuara të tokës dhe të strukturave në të	42
<b>KREU V – PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR</b>	45
Neni 25 - Përkufizime dhe rregulla për njësitë strukturore që nuk janë subjekt hartimi i planeve të detajuara vendore	47
Neni 26 – Leja e zhvillimit	47
Neni 27 – Hartimi i planeve të detajuara vendore	48
Neni 28 – Kushte dhe norma për hartimin e planeve të detajuara vendore	49
Neni 29 – Përmbajtja dhe procedura e miratimit të PDV-ve	51
<b>KREU VI – PËRKUFIZIME DHE KUSHTE PLANIFIKIMI DHE KONTROLLI TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT</b>	53
Neni 30 – Tipologjitë hapësimore	55
Neni 31 – Tipologjitë e strukturave	55
Neni 32 – Tipologjitë e strukturave për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që ndërtohen në tokë bujqësore	58
Neni 33 – Hapësira publike	59
Neni 34 – Rregulla dhe kritere të veçanta për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore	60
Neni 35 – Banesat familjare në territorin urban dhe sub-urban	62
Neni 36 – Banesat familjare në territorin rural	63
Neni 37 – Komplekset mikse në territorin rural	63
Neni 38 - Koeficienti i shfrytëzimit të tokës (KSHT)	64
Neni 39 - Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për rrugë (KSHR)	66
Neni 40 - Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për hapësira publike (KSHP)	66
Neni 41 - Intensiteti i ndërtimit	67
Neni 42 - Parametrat e zhvillimit për strukturat me interes publik	68
Neni 43 - Distanca	68
Neni 44 – Vija e ndërtimit	70
Neni 45 – Lartësia e strukturave	70



Neni 46 – Ristrukturimi i strukturave ekzistuese	71
Neni 47 -Vazhdimësia e faqeve kallkan	73
Neni 48 - Parkimet	74
Neni 49 - Vërrezat	75
Neni 50 – Referencat ligjore	76
<b>KREU VII – INSTRUMENTE TË DREJTIMIT TË ZHVILLIMIT</b>	<b>81</b>
Neni 51 – Intensiteti i ndërtimit me kushte	83
<b>KREU VIII – SISTEMI I MOBILITETIT</b>	<b>87</b>
Neni 52 – Infrastruktura	89
Neni 53 – Struktura e rrjetit rrugor	91
Neni 54 – Profilet e rrugëve	93
Neni 55 – Përshkrimi i kryqëzimeve (ndërprerjeve) të rrugëve	97
Neni 56 – Parkimet publike	100
Neni 57 – Përshkrimi i kryqëzimeve	101
<b>KREU IX – SISTEMI MJEDISOR DHE PEIZAZHIK</b>	<b>107</b>
Neni 58 – Sistemet e kullimit të ujërave	109
Neni 59 – Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza	111
Neni 60 – Administrimi i mbetjeve	112
Neni 61 – Burimet e ujërave	112
Neni 62 – Prodhimi bujqësor	113
Neni 63 – Tarracat	113
Neni 64 – Infrastruktura bujqësore	114
Neni 65 – Mbrojtja nga rrëshqitjet e tokës	114
Neni 66 – Mbrojtja nga përmbytjet	115
Neni 67 – Sistemi ekologjik dhe mbrojtja	116
Neni 68 – Parku territorial	116
Neni 69 – Rregulla dhe kritere të përgjithshme për zhvillimet në territorin natyror	117
<b>KREU X - TABELAT PARAMETRIKE TË NJËSIVE STRUKTURE</b>	<b>119</b>
<b>SIPAS PËRCAKTIMEVE TË PPV</b>	<b>119</b>
<b>KREU XI – SHTOJCAT</b>	<b>273</b>
<b>SHTOJCA 2</b>	<b>297</b>





KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME



10/10/10

10/10/10

10/10/10



## **Neni 1 - Objektivat dhe drejtimet e rregullores**

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vorë, ka për objektiv kryesor zhvillimin e balancuar dhe të integruar rajonal të Vorës, nëpërmjet një shpërndarje të funksioneve të përdorimit të territorit kundrejt vizioneve strategjike për krijimin e një modeli të ri zhvillimi që mundëson harmonizimin e hapësirave me karakteristika të ndryshme gjeografike dhe social-ekonomike.

Nëpërmjet PPV-së në këtë rregullore synohet kushtëzimi ligjor i trajtimit të zonimit funksional të territorit kundrejt dy parimeve kryesore:

1. Përcaktimin e përdorimit të lejuar të tokës, sipas përcaktimeve të parashikuara nga ky plan; dhe
2. Identifikimin e kushteve bazë të mënyrës së ndërhyrjes në territor.

Në këtë rregullore do të përcaktohen rregullat, normat dhe standartet të cilat do të udhëheqin zhvillimin dhe transformimin e territorit në drejtim të objektivave të synuara nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vorë.

## **Neni 2 - Afatet dhe vlefshmëria e planit**

1. Plani i Përgjithshëm Vendor është hartuar në respektim të kushteve ligjore të përcaktuara nga Ligji i Planifikimit të Territorit Nr. 107/2014 (i ndryshuar) dhe Rregulloreve të Planifikimit dhe Zhvillimit në funksion të tij.
2. Ky plan është i vlefshëm për një periudhë kohore prej 15 vitesh.
3. Pas kësaj date, plani do të nënshtrohet rishikimit në përputhje me legjislacionin kombëtar që do të jetë në fuqi në kohën e rishikimit.

## **Neni 3 - Zgjidhja e konflikteve dhe mospërputhjeve**

1. Në rast të mospërputhjeve midis elementëve të këtij plani, dispozitat në tekst dhe formatet tabelare kanë prioritet mbi elementët grafike.
2. Në rast të mospërputhjeve të normave, parametrave dhe rregulloreve të këtij dokumenti, dispozitat kufizuese sundojnë mbi ato më pak kufizuese.
3. Në rastin e mospërputhjeve midis rregullave të këtij dokumenti dhe legjislacionit tjetër kombëtar, rregulloret kombëtare kanë prioritet kundrejt parashikimeve të këtij dokumenti.



#### Neni 4 – Ndryshime apo rishikime të dokumentit të planit

1. Plani është objekt ndryshimi apo rishikimi sipas përcaktimeve ligjore të Nenit 26 të ligjit të planifikimit të territorit, dhe në çdo rast objekt rishqyrtimi të plotë çdo 15 vjet.
2. Rastet për të cilat kërkohet rishikimi dhe që parashikohen në VKM Nr.686, datë 22.11.2017, neni 11 dhe neni 12, i nënshtrohen procedurës të thjeshtuar sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore në funksion të tij në fuqi.
3. Përcaktimet për infrastrukturën e shërbimeve apo të përkufizimeve të tjera në nivel planifikimi, subjekt të standarteve të rregulloreve kombëtare të planifikimit, janë subjekt rishikimi apo rishqyrtimi nëse standartet në fuqi në kohën e miratimit të këtij plani ndryshohen si pasojë e rishikimit apo nevojës të përshtatjes të tyre me kriteret dhe rregulloret e planifikimit sipas standarteve të kërkuara nga Bashkimit European.

#### Neni 5 - Përkufizimet

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a. **“Njësi strukturore”** - është sipërfaqja më e vogël e territorit e përkufizuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor, e identifikuar dhe planifikuar me kushte të njëtrajtshme zhvillimi sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.
  - b. **“Sistem territorial”** - është tërësia e përdorimeve, strukturave, punimeve të lejuara, aktiviteteve, funksioneve dhe elementeve natyrore dhe artificiale territoriale, të cilat kanë lidhje me njëri-tjetrin për nga karakteri dhe qëllimi i planifikimit dhe i zhvillimit të cilin synojnë të realizojnë.
  - c. **“UB”** - sistem urban
  - d. **“IN”** - Sistem infrastrukturor
  - e. **“B”** - sistem bujqësor
  - f. **“N”** - sistem natyror
  - g. **“U”** - sistem ujor
  - h. **“Sipërfaqe bruto e njësisë strukturore”**- është sipërfaqja brënda aksit të rrugëve që kufizojnë njësinë strukturore. Në rast se njësia strukturore nuk kufizohet nga rrugë, është sipërfaqja e territorit brënda vijës së kufirit të pronave që përfshihen në njësinë strukturore përfshirë prona private dhe



publike.

- i. **“Sipërfaqe neto e njësisë strukturore”**- është sipërfaqja e parcelave të përfshira në të drejta zhvillimi në njësinë strukturore.
- j. **“Zonimi”** - është ndarja e një territori në njësi strukturore për qëllime planifikimi dhe kontrolli të zhvillimit të territorit.
- k. **“Zonim i përdorimit të tokës”** - është përcaktimi i kategorive të lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të për secilën njësi strukturore, për qëllime planifikimi dhe kontrolli të zhvillimit të territorit.
- l. **“Tipologji hapësimore e përdorimit të tokës”** - është karakteri i një njësie strukturore bazuar në ndërthurjen e njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike.
- m. **“Përdorim homogjen”** - është përdorimi që karakterizohet nga ekzistenca e strukturave që i shërbejnë të njëjtit funksion mes njëra-tjetrës, ndonëse dhe miks në vetvete, në të gjithë sipërfaqen e tokës ku evidentohet përdorimi, dhe nga aktivitete të përputhshme që i shërbejnë të njëjtit funksion.
- n. **“KSHT, koeficienti i shfrytëzimit të tokës”** - për ndërtim është raporti ndërmjet sipërfaqes së gjurmës së strukturës të vendosur në parcelë/ grup-parcelash me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës/grup-parcelave
- o. **“Intensiteti”** – është raporti ndërmjet sipërfaqes të përgjithshme të ndërtimit mbi tokë / sipërfaqen e tokës në dispozicion për ndërtim.
- p. **“Intensiteti bruto”** – është raporti ndërmjet sipërfaqes të përgjithshme të ndërtimit mbi territorin e njësisë strukturore / sipërfaqen e përgjithshme të njësisë strukturore.
- q. **“Intensiteti neto”** – është raporti ndërmjet sipërfaqes të përgjithshme të ndërtimit mbi parcelë ose grup-parcelash / sipërfaqen e përgjithshme të parcelës ose grup-parcelave.
- r. **“Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të”** - për çdo njësi strukturore, kjo rregullore përcakton kategoritë e zhvillimeve të lejuara në përputhje me Planin e Përgjithshëm;
- s. **“Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të”** – janë ato kategori ndërhyrje në territor të cilat kushtëzohen përmes detyrimeve shtesë në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe të Planit të Përgjithshëm Vendor;



- t. **“Parcelë”** – është termi i përdorur në këtë rregullore zhvillimi që nënkupton të gjitha përkufizimet ligjore dhe teknike të konceptit pronë, e identifikuar me numër të parcelës dhe e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.
- u. **“Pole me prioritet zhvillimi”** - janë ato njësi apo zona, të cilat parashikojnë prioritet zhvillimi nga përcaktimet e këtij plani, sipas vizionit dhe objektivave strategjike të zhvillimit të qytetit të parashikuara nga ky Plan i Përgjithshëm Vendor. Polet janë subjekt i një Plani të Detajuar Vendor, sipas të cilit do të përcaktohen tregues të njëtrajtshëm dhe të detyrueshëm zhvillimi për kërkesat për zhvillim.
- v. **“Hapësira të hapura”** - janë hapësira të pandërtuara ndërmjet strukturave, publike apo private, sipas rastit rrugë për hyrje në strukturë ose hapësira me një mbulesë vegjetacioni, sheshe parkimi, vendqëndrime dhe hapësira të gjelbëra në funksion të strukturës së ndërtuar sipas parashikimeve të lejes të ndërtimit apo studimit dhe pjesë e parcelës së ndërtueshme.
- w. **“Zhvillim i qëndrueshëm”** - është zhvillimi social, ekonomik, territorial dhe mjedisor që u përgjigjet nevojave të brezave të sotëm dhe që nuk rrezikon, demton apo pakëson burimet për brezat e ardhshëm.
- x. **“Vijë ndërtimi”**- është kufiri maksimal i lejuar për vendosjen e një strukture në lidhje me trupin e rrugës ose kufirin e njësisë që i referohet.
- y. **“Gjelbërim filtrues”** – është pjesa e sipërfaqes së gjelbër për realizimin e filtrimit të ujërave në tokë, e lirë nga çdo lloj ndërtimi mbi apo nëntokë, e përllorgaritur si koeficient shfrytëzimi i territorit.
- z. **“Park”** – është hapësira natyrore e kufizuar, me gjelbërim të lartë dhe të mesëm, pjesë e territorit urban dhe sub-urban, me qëllimin e përmirësimit të cilësisë së kushteve mjedisore dhe social kulturore të banorëve të territorit.
- “Plan i Detajuar Vendor”** - instrumenti që përcakton kushtet e zhvillimit përmes analizës së detajuar të territorit dhe zbërthimit të rregullave të përcaktuara nga plani i përgjithshëm vendor për një apo më shumë njësi strukturore.
- ab. **“Ish shtrat lumi”** - nënkupton ish-shtratin e një lumi dhe sipërfaqen e shtrirjes së vjetër të tij, i cila ka karakteristika specifike gjeomorfologjike.
- ac. **“Mini rrjet i KUZ”** - nënkupton sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza të përbërë nga një rrjet i vogël i kanalizimeve të ujërave të zeza.



ad. **“SHBB”** - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor, janë ato shoqëri ku fermerët (së paku 3) bashkojnë burimet dhe produktet e tyre në fusha të caktuara të veprimtarisë.

ae.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në Ligj Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, i ndryshuar, apo në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.





KREU II – PËRKUFIZIMI I TERRITORIT DHE SISTEMET





10  
11  
12  
13  
14

15



## Neni 6 – Përkufizimi i territorit

1. Territori i Bashkisë Vorë është përkufizuar si një bashkësi Peizazhesh bazuar në kombinimin e 5 peizazheve të ndryshme të përcaktuara qartësisht në territor.
2. Pesë peizazhet janë:
  - a. Peizazhi urban
  - b. Peizazhi fushor
  - c. Peizazhi lumor
  - d. Peizazhi kodrinor
  - e. Peizazhi korridoreve

## Neni 7 - 5 sistemet dhe elementët e territorit

1. Secili Peizazh në vetvete përbëhet nga një seri elementësh që përfshijnë:
  - a. Elementët e ndërtuar
  - b. Elementët e pa-ndërtuar
  - c. Elementët natyror
  - d. Elementët nga impakti njerëzor;
2. Elementët, të vetëm dhe të kombinuar, formojnë 5 sistemet territoriale (ujor, urban, infrastrukturor, natyror dhe bujqësor).
  - a. **Sistemi urban:** formësohet nga kufiri i ndërthurjes të territorit urban me territorin natyror apo bujqësor. Elementët e këtij sistemi përmbledhin të gjitha strukturat e ndërtuara aktualisht, nga lashtësia deri në kohët moderne, nga ndërtesat publike në ato industriale. Kjo tipologji elementësh ofron një panoramë varietetit tipologjish strukturash.
    - i. Shtëpia urbane historike.
    - ii. Shtëpi rurale historike.
    - iii. Shtëpi nga koha socialiste.
    - iv. Banesa socialiste.
    - v. Shtëpi një-katëshe.



- vi. Shtëpi shumë-katëshe.
  - vii. Ndërtesa me apartamente.
  - viii. Struktura publike në shkallë të vogël.
  - ix. Struktura publike në shkallë të madhe.
  - x. Hapësirë publike.
  - xi. Ndërtesa tregtare/industriale me madhësi të vogël.
  - xii. Ndërtesa tregtare/industriale me madhësi mesatare.
- b. **Sistemi natyror:** përbëhet nga sipërfaqe të paprekura natyrore, korridore ekologjike në përputhje me përkufizimet ligjore. Ky sistem nuk konsiderohet si sipërfaqja e territorit që ngelet përtej territorit urban, por përkundrazi, duhet të ndërthuret me sistemin urban dhe ta përkufizojë atë në një marrdhënie funksionale mes njëri-tjetrit. Elementë të këtij sistemi përfshijnë:
- i. Shpat i pyllëzuar
  - ii. Shpat me rrëshqitje
  - iii. Kullotat
  - iv. Pyjet halorë
  - v. Lymishta të populluara e bimësi
  - vi. Breza të pyllëzuar përgjatë kanaleve/përrenjve
  - vii. Ish shtrat lumor
- c. **Sistemi bujqësor:** përbëhet nga sipërfaqe toke bujqësore, të zëna me të mbjella gruri, misri, vreshtash, ullishtesh, dru-frutorësh, arrorrësh, të kudo-ndodhura, si dhe infrastrukturën inxhinierike dhe teknike në shërbim të aktiviteteve të lidhura me këtë sistem. Elementë të këtij sistemi përfshijnë:
- i. Tokë e lërueshme
  - ii. Kulturat e pemëtarisë
  - iii. Kultivimet në tarraca
  - iv. Arat e pakultivuara (djerr)
  - v. Rezervuarë




- vi. Kanal kullues
  - vii. Kanal vaditës
  - viii. Kanal kullimi prej betoni
  - ix. Kanal kullimi i veshura me bimësi
  - x. Kanal i cekët (tretësor/vijë uji)
  - xi. Serrat
  - xii. Kopshtë (Bahçe), prodhime bujqësore shtëpiake
  - xiii. Ndërtesa ndihmëse të bujqësisë
- d. **Sistemi ujqor:** përfshin të gjithë sistemin e ujrave dhe burimeve nëntokësore dhe mbitokësore, të gjithë trupat ujqor përfshirë ato të përkufizuar nën legjislacionet specifike. Elementë të këtij sistemi përfshijnë:
- i. Lum "me argjinaturë"
  - ii. Lumi i 'gdhendur'
  - iii. Shtrat lumor gjarpërues
  - iv. Basene ujqor – mjedis argëtimi
- e. **Sistemi infrastrukturor:** përfshin të gjitha rrjetet e infrastrukturës në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar. Ky sistem formësohet nga rrjetet e infrastrukturës inxhinierike si dhe nga kategoritë bazë të përdorimit të tokës. Elementë të këtij sistemi përfshijnë:
- i. Autostrada Durrës-Tiranë
  - ii. Rrugët ndërurbane
  - iii. Rrugët lokale
  - iv. Rrugët e pashtuara lokale
  - v. Rrugë kryesore urbane
  - vi. Rrugë dytësore
  - vii. Rrugët këmbësore
  - viii. Hekurudhat




## Neni 8 - Hierarkia territoriale

1. Përtej përcaktimit të 5 sistemeve, territori urban i Bashkisë Vorë është klasifikuar në tre makro klasifikime për qëllim planifikimi dhe administrimi, në një ndarje hierarkie sipas zhvillimit aktual dhe të propozuar në territor, si vijon:
  - a. territor urban
  - b. territor sub-urban
  - c. territor rural
2. Plani përcakton si "*territor urban*" sipërfaqen e territorit të ndërtuar apo në proces zhvillimi dhe rizhvillimi, të përbërë nga territor urban kompakt, me densitet të lartë dhe mesatar, ku mbizotërojnë funksionet urbane të banimit, të shërbimit publik, kulturore, ekonomike dhe tregtare.
3. Plani përcakton si "*territor sub-urban*" të gjithë territorin periferik të *territorit urban*, me dendësi mesatare, të përbëra nga vend-banime nga ndërtime ku mbizotërojnë funksionet e banimit dhe industriale apo tregtare, në proces formalizimi dhe konsolidimi.
4. Plani përcakton si "*territor rural*" të gjithë territorin, të vendosur kryesisht përtej kufijve të territorit *sub-urban*, ku bëjnë pjesë grumbullimet e vogla tradicionale urbane si fshatrat, si dhe ndërtesat e shpërndara në territor të ndërthurura me territoret bujqësore dhe natyrore, ku ekonomia bazohet kryesisht në bujqësi dhe blegtori.
5. Përkufizimi dhe klasifikimi i territorit sipas parashikimeve të këtij neni është reflektuar në hartën përkatëse të hierarkisë territoriale. Parcelat apo strukturat e prekura nga kufiri i secilit nivel klasifikimi, do të jenë pjesë e territorit me hierarki më të lartë planifikimi vetëm nëse 60% ose më shumë e sipërfaqes të parcelës apo sipërfaqes totale të strukturës së tyre, ndodhet brënda territorit me hierarki më të lartë klasifikimi.







KREU III – PËRCAKTIMI I TERRITORIT PËR PLANIFIKIM DHE  
ADMINISTRIM





100

100





### Neni 9 – Kriteret e përcaktimit të zonës

1. Bazuar në përkufizim, zona është një pjesë e territorit, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese a të planifikuara në të.
2. Kriteret për përcaktimin e zonave në këtë plan të përgjithshëm vendor kanë qënë kryesisht nën-ndarja e sistemit urban që janë krijuar nga procesi i zonimit.
3. Zonat përbëhen nga një apo më shumë njësi strukturore dhe përcaktojnë kushte të përgjithshme administrimi dhe inventarizimi të parametrave të planifikimit të përlllogaritura sipas përcaktimeve ligjore në nivel zone.
4. Kufijtë e zonave, janë përcaktuar sipas përkufizimit të një apo disa njësive strukturore që përfshin në territorin e një zone, duke e sintetizuar ndarjen territoriale për qëllime planifikimi nga qëliza më e vogël territoriale, njësia strukturore, në nocionin përgjithësues të planifikimit dhe administrimit, zonës.

### Neni 10 - Kriteret e përcaktimit të njësive strukturore

1. Ndarja në njësi strukturore bëhet për qëllime të planifikimit, e të zbatimi të Planit të Përgjithshëm, të realizimit dhe kontrollit të zhvillimit dhe përbën qelizën më të vogël të planifikimit dhe qelizën më të madhe të zhvillimit në një territor. Çdo kërkesë për zhvillim bazohet në treguesit e planifikimit dhe kushtet e zhvillimit që vendosen në Planin e Përgjithshëm Vendor për njësinë strukturore përkatëse.
2. Njësitë strukturore krijohen në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të këtij neni dhe nga mbivendosja e hartës së kategorive të përdorimeve të tokës dhe të strukturave në të, sipas rastiit të propozuara ose ekzistuese, me hartat e tjera të planit të propozuar të përdorimit të tokës dhe planit të infrastrukturave dhe shërbimeve sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
3. Kufijtë e njësive strukturore, janë përcaktuar duke ju referuar këtyre kriterëve të detyrueshme, por pa u kufizuar vetëm në to:
  - a. Kufizimi nga rrjeti rrugor kryesor ekzistues dhe/ose i propozuar, dhe sipas rastiit edhe nga kufizues të tjerë natyralë e artificialë, të cilët krijojnë elementë me karakter qartësisht të matshëm në territor, dhe sipas rastiit mund të përfshijnë linja hekurudhore, vija ujore, lumenj ose përrenj, kanale të hapura, breza sanitare, dhe të tjera të kësaj natyre, kufijtë e pronës;
  - b. Ekzistenca e një ekuilibri midis përdorimeve dhe funksioneve brenda çdo njësie strukturore, që përcaktohet përmes treguesve të planifikimit dhe të zhvillimit të cilët garantohen në çdo njësi;



- c. Ekzistenca e funksioneve urbane që plotësojnë njëri-tjetrin dhe nevojat e popullatës urbane;
  - d. Bashkë-ekzistenca e përdorimeve të tokës dhe strukturave në një njësi strukturore, që janë të përputhshme dhe nuk paraqesin raste të përdorimeve të ndaluara, ose sipas rastit ekzistenca e përdorimit homogjen të tokës dhe strukturave në të, për të gjithë njësinë;
  - e. Rëndësia që ka njësia strukturore në historinë territoriale qytet-formuese të territorit përkatës;
  - f. Ekzistenca e identiteteve dhe karakteristikave të veçanta që njësia strukturore mund të ketë, duke përfshirë vlerat e trashëgimisë kulturore dhe vlera të rëndësishme mjedisore.
4. Në çdo rast, kriteret e detyrueshme për përcaktimin e një njësie strukturore, por pa u kufizuar vetëm në to, përfshijnë:
- a. Garantimin e kompaktësisë dhe njëtrajtshmërisë së tipologjisë hapësinore ekzistuese dhe/ose të propozuar;
  - b. Ekzistencën e treguesve të njëtrajtshëm të planifikimit dhe të zhvillimit;
  - c. Ekzistencën e përdorimit homogjen të tokës dhe të strukturave në të, sipas kategorive bazë të përdorimit dhe nënkategorive të përdorimit të parashikura nga Plani i Përgjithshëm Vendor, përfshirë edhe funksione ose aktivitete homogjene. Në rastet kur për arsye të përligjura, njësia ka ose parashikohet të ketë përdorim të përzier, atëherë treguesit e zhvillimit dhe të planifikimit paraqiten për çdo kategori ose nënkategori përdorimi;
  - d. Ekzistencën e vlerave të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe aspekte të rëndësishme të mjedisit dhe shëndetit, sipas rastit;
  - e. Kufizimin nga rrjeti rrugor, pavarësisht nga kategoritë e rrugëve, dhe nëse është rasti nga linja hekurudhore, kanale të hapura, breza sanitare, vija ujore, përrenj, lumenj, dhe të tjera të kësaj natyre;
  - f. Paracaktimin e një zone me prioritet zhvillimi ose për realizimin e një projekti me rëndësi në nivel qyteti nga Plani i Përgjithshëm Vendor.



#### **Neni 11 – Kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës**

1. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, shërbejnë si referencë në procesin e zonimit sipas përdorimit të tokës, të kryer nga autoriteti i plan-

ifikimit. Përcaktimi i tyre bëhet në zbatim të definicioneve të Nenit 80 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".

2. Autoriteti i planifikimit, i referohet dhe përdor gjatë procesit të zonimit sipas përdorimit të tokës dhe strukturave në të, këto kategori dhe kode:
  - a. "Banim (A)" përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit. Përmban nënkategoritë "Banim (A1)" dhe "Banim dhe Shërbime (A2)"
  - b. "Shërbime (S)" përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimeve tregtare, akomoduese dhe zyra. Përmban nënkategoritë "Shërbim Akomodimi dhe Argëtimi (S1)" dhe "Shërbime tregtare dhe Biznesi (S2)"
  - c. "Industri ekonomi (IE)" përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e industrisë së lehtë e të rëndë, si dhe funksione ekonomike komplekse. Përmban nënkategoritë "Industri e Lehtë (IE1)", "Industri e Rëndë (IE2)" dhe "Aktivitet Ekonomik Komplaks (IE3)"
  - d. "Institucione (IS)" përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e administrimit publik, shërbimeve publike, sociale, diplomatike, financiare dhe fetare. Përmban nënkategoritë Shërbim Publik (IS2), "Shërbim Social (IS3)", "Shërbim Diplomatik (IS4)", Institucione Financiare (IS5)" dhe "Institucion Fetar( IS6)"
  - e. "Arsim (AS)" përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e arsimit në të gjitha nivelet: parashkollor, i ulët, i mesëm dhe i lartë, sipas legjislacionit përkatës.
  - f. "Shëndetësi (SH)" përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimit ambulator dhe spitalor, sipas legjislacionit përkatës. Përmban nënkategoritë "Shërbim Ambulator (SH1)" dhe "Shërbim Spitalor (SH2)"
  - g. "Aktivitete shoqërore dhe argëtimi (SHA)" përfshin territore dhe struktura në shërbim të aktiviteteve kulturore e sportive, parqe dhe hapësira publike. Përmban nënkategoritë "Hapësira Publike (AR1)", "Aktivitete Kulturore(AR2)" dhe "Aktivitete Sportive (AR3)"
  - h. "Monumente kulturore (M)" përfshin territore dhe struktura, pjesë të trashëgimisë kulturore dhe historike. Përmban nënkategoritë "Monument Kulture (M1)"
  - i. "Varreza (V)" përfshin territoret dhe strukturat në shërbim të varrezave.



Përmban nënkategoritë “Varrëzë (V1)”, “Varrezë Dëshmorësh (V2)” dhe “Memorial (V3)”

- j. “Infrastrukturë transporti (INT)” përfshin infrastrukturën e transportit rrugor, hekurudhor, ujor, ajror dhe multimodal; rrjetet e përbëra nga linjat, stacionet dhe struktura të tjera në shërbim të tyre. Përmban nënkategoritë
- k. “Infrastrukturë Rrugore (INT1)”, “Infrastrukturë Hekurudhore (INT2)”, “Infrastrukturë Transporti Ujor (INT3)”, “Infrastrukturë Transporti Ajror (INT4)” dhe “Infrastrukturë Multimodale (INT3)”
- l. “Infrastrukturë e ujësjellës - kanalizimeve (IUK)” përfshin rrjetet dhe strukturat në shërbim të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Përmban nënkategoritë “Ujësjellës (IUK1)” dhe “Kanalizime (IUK2)”
- m. “Bujqësi (B)” përfshin tokat bujqësore me kultura të përhershme apo sezonale bujqësore, si dhe tokat djerrë, sipas legjislacionit përkatës. Përmban nënkategoritë “Kultura të Përhershme (B1)”, “Kultura Sezonale (B2)” dhe “Tokë Djerrë (B3)”
- n. “Infrastrukturë bujqësore (IB)” përfshin infrastrukturën në shërbim të aktivitetit bujqësor që mundëson vaditjen dhe kullimin e tokave bujqësore. Përmban nënkategoritë “Infrastrukturë Vaditje dhe Kullimi (IB3)”
- o. “Ekonomi bujqësore (EB)” përfshin strukturat dhe infrastrukturat në funksion të ekonomisë bujqësore e blegtorale, si dhe shërbimet e agroturizmit. Përmban nënkategoritë “Struktura në Funksion të Bujqësisë (EB1)”, “Struktura në Funksion të Blegtorisë (EB2)” dhe “Agroturizëm (EB3)”
- p. “Bujqësi - Banim (BA)” përfshin banimin në funksion të aktivitetit bujqësor. Përmban nënkategoritë “Bujqësi - Banim (BA1)”
- q. Tokë natyrore (N)” përfshin territoret natyrore, si: pyje, kullota, livadhe, shkurre e të tjera, të paprekura nga aktiviteti njerëzor. Përmban nënkategoritë “Pyje (N1)”, “Kullotë (N2)”, “Livadh (N3)”, “Shkurrë (N4)” dhe “Tokë pa Frut (N5)”
- r. Natyrë dhe argëtim (NAR)” përfshin territoret natyrore, infrastrukturat ekologjike në funksion të aktivitetit njerëzor në natyrë, si: parqe, plazhe, shtigje dhe strukturat në funksion të ekoturizmit. Përmban nënkategoritë “Park Natyror (NAR1)”, “Plazh (NAR2)”, “Shtigje (NAR3)” dhe “Ekoturizëm (NAR4)”
- s. Ujëra (U)” përfshin të gjithë trupat ujorë: dete, laguna, kënetë, liqene,



lumenj, përrenj e burime ujore, sipas legjislacionit përkatës. Përmban nënkategoritë “Det (U1)”, “Lagunë (U2)”, “Kënetë (U3)”, “Liqen (U4)”, “Lumë (U5)”, “Përrua (U6)” dhe “Burim Ujor (U7)”

#### **Neni 12 - Kategoritë e parashikuara të përdorimit të tokës për njësitë strukturore me përdorim të përzier (mikse)**

1. Në mënyrë që të theksohet dinamika urbane dhe të krijohen mundësi të mëdha për kombinimin e aktiviteteve në qytet, do të përcaktohen njësitë strukturore me përdorim të përzier (mikse).
2. Kombinimi i këtyre aktiviteteve duhet të jetë në përputhje me treguesit e ndikimit në mjedis (ndotja e ajrit dhe akustike, gjenerimi i trafikut, prania e infrastrukturës dhe administrimi i rrezikut).
3. Kur % e përdorimit për të dy kategoritë është 100, lejohet mundësia e zhvillimit deri në 100% për secilën kategori.
4. Për njësitë strukturore të cilat nuk kanë vetëm një nga kategoritë e përdorimit të përcaktuara në Nenin 14 të kësaj rregulloreje, si edhe për të gjitha njësitë strukturore me përdorime të përziera, do të përcaktohen :
  - a. Përdorimet e lejuara, të ndalura apo të kushtëzuara për njësinë;
  - b. Përqindja (%) përkatëse e çdo përdorimi apo sipërfaqja përkatëse e përcaktuar për secilin përdorim.
  - c. Mënyrat e ndërhyrjes dhe kushtet e zhvillimit për secilin përdorim sipas raportit përkatës në njësi.
5. Për njësitë strukturore të përziera me kategorinë e përdorimit A-banim, transformimet e banesave në objekte tregtare ose zyra, janë të lejuara vetëm përgjatë rrugëve kryesore që kufizojnë njësinë.
6. Ndërthurja e përdorimeve përfshin kategoritë e përcaktuara në legjendën e mëposhtme:
  - a. **(A,S) - Banim dhe shërbime (tregtare);** Kjo kategori e përdorimit të tokës përqendrohet në përzierjen e banimit me shërbime tregtare si zyra, dyqane, bare, zyra, restorante, supermarkete, ipermarkete, aktivitete të vogla prodhuese, tregtim me shumice dhe pakice, etj, brenda të njëjtës njësi ndërtimore. Synimi kryesor i kësaj kategorie të përdorimit të tokës është të mbështesë fleksibilitetin e të jetuarit dhe punuarit brenda të njëjtës strukturë;



- b. **(IE,S) – Industri, ekonomi dhe shërbime (tregtare);** Kjo kategori e përdorimit të tokës bazohet në përzierjen e funksioneve të banimit, atyre tregtare, dyqane, bare, zyra, restorante, supermarket, ipermarkete, aktivitete të vogla prodhuese, panairë, tregtim me shumice dhe pakice, etj, brenda të njëjtës njësi ndërtimore. Qëllimi kryesor i kësaj tipologjie është të mbështesë fleksibilitetin e veprimtarive prodhuese brenda të njëjtave hapësira;
- c. **(IS,AS,SH) – Institucione, arsim dhe shëndetësi;** Kjo kategori e përdorimit të tokës përqëndrohet në përzierjen e përdorimeve të arsimit, shëndetësisë dhe institucioneve në territor.

### Neni 13 – Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të

1. Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të për një zonë të caktuar, nënkuptojnë kategoritë e zhvillimeve të lejuara në atë zonë sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për kategoritë bazë dhe në përputhje me instrumentet e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit në fuqi.
2. Për çdo njësi strukturore, për të cilat janë përcaktuar “përdorime të tjera të lejuara”, këto lloj përdorimesh realizohen vetëm për disa nën-kategori sipas rastit dhe deri në atë masë që mund të akomodojë kapaciteti mbajtës i zonës. Ky përkufizim nuk përfshin kategoritë e ndaluara.
3. Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të:
  - a. ndajnë përkatësisht përfitimet e ndërsjella,
  - b. nuk bien në kundërshtim me qëllimin e zonimit, me funksionet dhe me natyrën e kategorive bazë të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të në një zonë,
  - c. përputhen me kushtet e vendosura nga dispozitat ligjore në fuqi dhe nga instrumentet e planifikimit në fuqi, për sigurinë e mjedisit, të shëndetit, të tokës bujqësore dhe të vlerave historike dhe kulturore për përdorimet dhe funksionet ekzistuese dhe të autorizuara apo propozuara në njësinë përkatëse dhe ato fqinje apo kufitare.



### Neni 14 – Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të

1. Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të për një

njësi të caktuar, vlerësohen zhvillimet jo të ndaluara, realizimi i të cilave lejohet përmes plotësimit të kushteve shtesë ose të reja në kërkesën përkatëse për zhvillim dhe në përputhje me përcaktimet e kësaj rregullore zhvillimi dhe të rregulloreve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit në fuqi.

2. Në çdo rast, edhe nëse autoriteti i planifikimit nuk e ka përcaktuar paraprakisht nëse një zhvillim është i lejuar, i ndaluar ose i kushtëzuar, ose nuk ka parashikuar kushte shtesë për zhvillimin e kushtëzuar, ai mund t'i kërkojë zhvilluesit të përgatitë një studim/plan të ndikimit nga zhvillimi para se të vendosë për lejimin ose jo të zhvillimit.
3. Përdorime të kushtëzuara janë ato që përcaktohen për çdo njësi strukturore/ zonë me prioritet zhvillimi në këtë rregullore. Përjashtim bëjnë ato raste të cilat përcaktohen ndryshe në këtë rregullore:
  - a. Përdorimet e kushtëzuara përmbushin përcaktimet e rregullores së planifikimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
  - b. Pikat e furnizimit të karburantit lejohen në zonë urbane vetëm pasi plotësojnë kushtet e distancave prej të paktën 60 m nga ndërtimet e tjera të çdo lloji, të pajisen me lejen mjedisore përkatëse dhe miratimin nga institucioni përgjegjës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
  - c. Djegia e mbeturinave organike të aktivitetit bujqësor në tokë bujqësore është aktivitet i kushtëzuar. Lejohet vetëm pas vlerësimit të rrishtit të ndotjes nga bashkia dhe kur pika e djegies është të paktën 300 metra nga ndërtimi më i afërt, pavarësisht funksionit të tij.
  - d. Industria e përpunimit dhe paketimit të produkteve ushqimore është aktivitet i kushtëzuar në zonë banimi dhe/ose në zonat fqinjë me ato të banimit, si dhe lejohet vetëm pasi plotëson kushtet e distancave nga ndërtimet e tjera, pajiset me lejen mjedisore përkatëse dhe kur institucioni përgjegjës miraton Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Kjo industri është e kushtëzuar edhe në territoret e sistemeve urbane dhe natyrore, apo në brigjet ujore dhe lejohet vetëm pasi plotëson kërkesat ligjore sektoriale të ujërave, mjedisit, tokës bujqësore, pyjeve dhe kullotave, zonave të mbrojtura natyrore dhe biodiversitetit.
  - e. Përdorimet e kushtëzuara në territoret e zonave të mbrojtura natyrore dhe në zonat e tyre buferike, si dhe në zonat që mbrohen nga legjislacioni për trashëgiminë kulturore, përfshirë brezat mbrojtës/zonat buferike të këtyre zonave/objekteve, përcaktohen rast pas rasti në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi. Kushtet përcaktohen në legjislacionin në fuqi.



### Neni 15 – Kategoritë e ndaluara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të

1. Me kategori të ndaluara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të për një njësi të caktuar, nënkuptohen zhvillimet e ndaluara në atë njësi, sipas përcaktimeve të kësaj rregullore, për kategoritë bazë dhe në përputhje me instrumentet e përgjithshme të planifikimit në fuqi.
2. Kriteret për përcaktimin e zhvillimeve të ndaluara në një zonë, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:
  - a. Kategoritë e përdorimit të tokës që bien në kundërshtim me qëllimet e zonimit sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi dhe instrumenteve të planifikimit në fuqi;
  - b. Kur një zhvillim kërkohet të realizohet në një zonë që i përket një kategorie bazë të ndryshme nga ajo e zhvillimit të kërkuar, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe dhe në mënyrë të argumentuar në instrumentin e planifikimit në fuqi;
  - c. Çdo përdorim që pavarësisht nga kategoria bazë të cilës i përket, krijon ndotje në mjedis përtej parametrave dhe standardeve të parashikuara në legjislacionin e posaçëm mjedisor, dëmton shëndetin, dëmton strukturat dhe monumentet e trashëgimisë kulturore;
  - d. Çdo zhvillim në tokë bujqësore që edhe pse mund të jetë brënda kategorisë bazë të përdorimit të tokës dhe strukturave në të, nuk respekton rregullat, standardet dhe treguesit e planifikimit dhe të zhvillimit sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi dhe të instrumentëve të planifikimit në fuqi;
3. Përdorime të ndaluara janë ato që përcaktohen për çdo njësi strukturore/zonë me prioritet zhvillimi në këtë Rregullore. Si rregull i përgjithshëm, përveç sa përcaktohet ndryshe në këtë rregullore:
  - a. Përdorimet e ndaluara përmbushin përcaktimet e rregullores së planifikimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
  - b. Përdorime të ndaluara për njësitë e banimit janë: industrinë e rënda, kimike dhe të tjera ndotëse me ndikim të lartë në mjedis; ndërtimet ushtarake; varrezat; impijantet e trajtimit të ujërave të ndotura; landfill-et; inceneratorët; parcelat komunitare të kompostimit të mbetjeve organike;
  - c. Aktivitetet e zonës rurale, pavarësisht shkallës, si rritja e bletëve, mbajtja e bagëtitve dhe gjedhëve, etj., të ngjashme janë të ndaluara në zonën urbane.





Lejohen vetëm aktivitete të kultivimit dhe ortikulturës në oborret dhe kopshtet individuale të ndërtesave, në kuadër të bujqësisë urbane.

- d. Nuk lejohen aktivitete si djegia e mbeturinave të çfarëdo lloji në zonat e sistemit urban, të sistemit natyror apo në brigjet e burimeve ujore.
- e. Përdorimet industriale janë të ndaluara të vendosen në brigjet ujore, në zonën buferike të zonave të mbrojtura natyrore pavarësisht kategorive, në zonat që mbrohen nga legjislacioni për monumentet e kulturës, përfshirë zonat buferike apo brezat mbrojtës të këtyre zonave/objekteve.
- f. Përdorimet e ndaluara në territoret e zonave të mbrojtura natyrore dhe në zonat e tyre buferike, si dhe në zonat që mbrohen nga legjislacioni për trashëgiminë kulturore, përfshirë brezat mbrojtës/zonat buferike të këtyre zonave/objekteve, përcaktohen në legjislacionin sektorial në fuqi.
- g. Të gjitha funksionet janë të ndaluara në hapësirën e përcaktuar si brez mbrojtës/përkatës, apo tampon/buferik për infrastrukturën rrugore dhe kanalet e kullimit dhe vaditjes të tokave bujqësore nga legjislacioni në fuqi.

#### **Neni 16 – Ndryshime në përdorimin e parashikuar të tokës për njësitë strukturore**

- 1. Lejohen ndryshime të kategorisë të parashikuar të përdorimit të tokës në rastin e zhvillimeve komplekse të cilat janë të përputhshme me kategoritë ekzistuese të përdorimit ekzistues të tokës në njësinë përkatëse.
- 2. Në rastet kur bashkë-ekzistenca mes përdorimeve të lejuara të tokës dhe të propozuara për ndryshim sipas parashikimeve të këtij neni, janë të përputhshme, atëherë ndryshimi në përdorimin e parashikuar të tokës do të lejohet vetëm nga KKT sipas përcaktimeve ligjore për ndryshime në planin e përgjithshëm vendor dhe rregulloret e zhvillimit në funksion të tij.
- 3. Çdo rast ndryshimi sipas përcaktimeve të këtij neni, do të dokumentohet nga autoritetet vendore dhe do të publikohet në regjistrin e integruar të territorit, dhe do të reflektohet në dokumentin e planit, hartat treguese si dhe rregulloren e zhvillimit, në rastin e parë të ndryshimeve apo përditësimeve të planit sipas përcaktimeve të Nenit 4 të kësaj rregullore dhe legjislacionit në fuqi.





KREU IV –NDARJA E TERRITORIT PËR QËLLIME PLANIFIKIMI DHE  
KONTROLLI TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT





## Neni 17 – Zonimi

1. Zonimi i territorit bëhet për qëllime të planifikimit, për të lehtësuar përcaktimin e kategorive të tokës në bazë zone dhe njësie dhe ka për qëllim:
  - a. Harmonizimin e përdorimeve të propozuara të tokës
  - b. Ruajtjen dhe përmirësimin e vlerave apo karakterit të një zone në përputhje me harmonizimin e interesave publike dhe private
  - c. Zhvillimin e qëndrueshëm të territorit
2. Zonimi detajon strategjinë e zhvillimit të territorit, e cila përcakton përmbajtjen thelbësore të PPV-së, që konsiston në:
  - a. Zonimin e përdorimeve urbane sipas shkallës dhe tipologjive
  - b. Zonimin e poleve të zhvillimit
  - c. Programin e veprimeve për implementimin e planit

## Neni 18 –Njësitë strukturore

1. Njësia strukturore është qeliza më e vogël e territorit për qëllime planifikimi e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe përcaktimet e këtij plani.
2. Njësitë strukturore përmbajnë kushtet bazë të ndërhyrjes dhe administrimit të asaj pjese territoriale të përkufizuar si “njësi strukturore” duke mbajtur në konsideratë treguesit e mëposhtëm:
  - a. Klasifikimin e mundësive të zhvillimit në përputhje me mënyrat e ndërhyrjes në territor dhe përdorimet e lejuara të tokës për secilën njësi sipas përcaktimeve të këtij plani dhe kësaj rregullore.
  - b. Krijimin e kompaktësisë hapësinore për secilën tipologji ndërhyrje në territor për çdo njësi strukturore.
  - c. Njëtrajtshmëri të treguesve të zhvillimit për çdo sipërfaqe të studjuar të territorit.
3. Kodi unik për territorin sipas njësive formohet nga “Bashkia\_Kodi i Sistemit\_Kodi/et i Nënkatëgorisë së Përdorimit të Tokës\_Nr.”, ndjekur nga kodi rendor identifikues për çdo njësi specifike brënda grupit të njësive të identifikuara me kodin.



### Neni 19 – Përcaktimi i njësive strukturore për të cilat hartohet PDV

1. Njësiti strukturore për të cilat është e detyrueshme të hartohet PDV-ja janë përcaktuar nga plani duke mbajtur në konsideratë treguesit si vijon:
  - a. Njësi strukturore me zhvillim intensiv, në presion zhvillimi, njësi strukturore banimi sipas kategorisë A të përdorimeve bazë, njësi strukturore të reja dhe të pazhvilluara, ose bujqësore dhe/ose natyrore që janë klasifikuar në sistemin e urbanizueshëm nga PPV dhe që ndahen për qëllime zhvillimi, si edhe njësi strukturore të degraduara të sistemit urban të cilat janë subjekt i programeve të rigjenerimit urban;
  - b. Janë propozim për rizonim dhe ndryshim të përdorimit të lejuar të tokës dhe strukturave në të, sipas kategorive bazë të përcaktuara në vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores të planifikimit" dhe nënkategorive më të detajuara të përcaktuara në PPV dhe kjo rregullore, dhe janë klasifikuar ose mund të klasifikohen si përdorime të kushtëzuara dhe/ose të ndaluara për njësinë strukturore ku propozohen të zhvillohen;
  - c. Synimi i zhvillimeve në njësinë e përzgjedhur, përbën një projekt publik të rëndësishëm të tillë si, program konservimi, program rigjenerimi, të propozuar nga autoriteti i planifikimit në instrumentet e përgjithshme të planifikimit në fuqi, ose të identifikuar bazuar në politikën vendore të planifikimit apo në strategjitë e zhvillimit të miratuara në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore, ose në politikat dhe programet sektoriale në nivel qëndror;



### Neni 20 – Rregulla për njësiti strukturore për të cilat parashikohet zhvillimi i PDV-ve

1. Sipërfaqja totale e një njësie strukturore është sipërfaqja minimale e territorit, që i nënshtrohet hartimit të PDV-së, sipas përcaktimeve të hartës së zonimit të përdorimit të tokës të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe kësaj rregullore zhvillimi.
2. Sipërfaqja totale e të gjitha parcelave publike dhe private të përfshira brënda kufirit të njësisë strukturore duhet të planifikohen, menaxhohen dhe zhvillohen sipas procedurave dhe kushteve të legjislacionit në fuqi si dhe ato të përcaktuara nga ky plan dhe kjo rregullore.



3. Planet e Detajuara Vendore duhet të sigurojnë zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, nëpërmjet respektimit të instrumenteve të planifikimit të përcaktuara nga kuadri ligjor në fushën e planifikimit dhe rregullat dhe kushtet e përcaktuara nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi.
4. Për parcelat të cilat shtrihen përtej kufijve të njësisë strukturore do të gjykohet nga autoritetet vendore sipas rastit mundësia e zhvillimit të tyre në njësinë pararendëse për të cilën hartohet PDV-ja, duke respektuar kushtet përcaktuara në Pikën 6 të Nenit 41 të kësaj rregullore zhvillimi.
5. Subjekti privat apo publik (zhvilluesi/investitori), që kërkon fillimin e procesit të hartimit të PDV-së, duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm sipas përcaktimeve dhe procedurave të përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.
6. Madhësia minimale e parcelës të cilës i jepet e drejta për zhvillim sipas kushteve të përcaktuara nga plani apo kjo rregullore zhvillimi, përcaktohet nga PDV e njësisë përkatëse dhe është e detyrueshme në të gjitha rastet.
7. Autoritetet vendore kanë të drejtën e nënshtrimit të një propozimi për zhvillim në përkufizimin e të drejtës për zhvillim sipas përcaktimit të një plani të detajuar vendor, kur kërkohet nga PPV apo nga një politikë e caktuar vendore rritja e cilësisë së zhvillimit dhe lehtësimi i zhvillimit të njësive strukturore urbane të mëdha, e realizueshme kjo si nëpërmjet planifikimit më të mirë e të integruar dhe administrimit të tyre, ashtu edhe menaxhimit të zhvillimit (jo të copëzuar).
8. Në zonat apo njësitë strukturore, pjesë të zonave me rëndësi kombëtare, sipas përkufizimeve territoriale të përcaktuara në PINS, gjatë hartimit të planit të zhvillimit të reflektohen rekomandimet e përcaktuara në PINS.
9. Plani i Detajuar Vendor për një njësi strukturore, ruan të drejtën e propozimit dhe kushtëzimit të bashkimit dhe/ose nëndarjes të parcelave për qëllime zhvillimi, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, për ato raste të cilat identifikohen si të domosdoshme bazuar në politikën vendore të planifikimit apo në ato raste kur është e nevojshme ruajtja e tipologjive ekzistuese të strukturave në territorin subjekt studimi.



#### **Neni 21 – Treguesit dhe rregullat për zonat, njësitë strukturore në sistemin bujqësor**

1. Zhvillimi dhe ndërtimi në territoret e sistemit bujqësor kryhet vetëm në bazë të përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9244, datë 16.6.2004, "Për mbrojtjen

e tokës bujqësore”, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 655, datë 28.7.2010, “Për rregullat dhe procedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”.

2. Në njësitë që i përkasin kategorisë së përdorimit bujqësi, pavarësisht përzierjes së kategorive, dhe sipas tabelave parametrike të kësaj rregullore, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës dhe ndërtimin në tokë bujqësore. Në këto zona:

a. Ndërtimet për qëllime, apo në funksion të aktivitetit bujqësor e blegtoral, të cilat kryhen në tokë bujqësore, në të paktën një nga rastet e mëposhtme, do të përcaktohen si zhvillime me karakter tranzitor në tokë bujqësore dhe për këtë qëllim nuk do të ndryshojë kategoria e parcelës përkatëse e ndërtimit/zhvillimit nga bujqësore në urbane, në rastet kur zhvillimi i propozuar shtrihet:

- i. në brendësi të tokës bujqësore dhe/ose larg rrugëve interurbane,
- ii. larg fshatrave, qendrave urbane apo sub-urbane dhe/ose qendrave të banuara në tërësi,
- iii. ose në zona të cilat nuk përcaktohen për ndryshim të kategorisë së sistemit bujqësor të cilit i përkasin në një tjetër sistem.

b. Kur Bashkia Vorë duhet të ndërtojë rrugë shërbimi në tokë bujqësore me qëllim sigurimin e aksesit për aktivitete në funksion të bujqësisë dhe blegtorisë, apo zhvillimit ekonomik mbi bazën e bujqësisë dhe blegtorisë, atëherë ato do të projektohen mbi gjurmën e rrugës bujqësore ekzistuese, duke parashikuar në të dy krahët sistemin e kanaleve kulluese e ujitëse, sipas kategorive që lejohen në ligj. Rruga e shërbimit do të ketë minimalisht 2 korsi pa trotuare. Korsi të planifikohen në vlerën e tyre minimale të gjerësisë sipas legjislacionit në fuqi për rrugët. Nuk lejohet ndërtimi i rrugës së shërbimit mbi tokë bujqësore.

c. Rrugët bujqësore të ndërtuara përgjatë kanaleve kulluese e vaditëse sipas kategorive përkatëse dhe legjislacionit në fuqi për infrastrukturën e kullimit dhe ujitjes, ruhen të pacënuara nga ndërtime dhe ndërhyrje të çdo lloji tjetër, përveç atyre rikonstruktuese, rehabilituese, ristrukturuese. Çdo aktivitet që cënon funksionin e rrugës bujqësore është i paligjshëm.

d. Në parcelat bujqësore të cilat paraqesin nivel të lartë të fragmentimit të tokës bujqësore ku identifikohet prezenca e banesave një-familjare të shpërndara, mund të ndërtohet deri në 1 (një) kat shtesë në lartësi në





banesën ekzistuese, dhe vetëm njëherë, ose të realizojë shtesë anësore në parcelën e tij ndërtimore, të njohur si truall për ndërtim nga procedurat ligjore mbi tokën bujqësore, sipas parashikimeve të këtij plani, tabelave të njëjësive dhe zonave si dhe të përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi dhe në çdo rast të mos kalojë sipërfaqen totale prej 250 m<sup>2</sup>. Në çdo rast, banesa nuk duhet të çënojë distancat e përcaktuara në legjislacion dhe në këtë rregullore zhvillimi për çdo objekt në tokë bujqësore. Ky rregull zbatohet edhe për strukturat e banimit, të cilat janë legalizuar ose kanë përfunduar vetë-deklarimin dhe janë në proces legalizimi në momentin e hyrjes në fuqi të Planit dhe të kësaj rregullore zhvillimi. Në këtë pikë nuk përfshihen ndërtesat e pa deklaruara dhe të pa legalizuara, këto struktura duhet në çdo rast të ndërmarrin procesin e legjitimitimit në zbatim të legjislacionit përkatës.

#### **Neni 22 – Rregulla dhe kritere të përgjithshme për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore**

1. 1. Për të gjitha objektet për qëllime bujqësore duhet të respektohen distancat nga rrugët, hekurudhat, aeroportet, linjat e tensionit të lartë e çdo infrastrukturë tjetër publike dhe distancat nga kanalet ujtëse e kulluese, si dhe brigjet e lumenjve, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. 2. Lejet e ndërtimit për objektet e përcaktuara në nenin 32 të kësaj Rregullore jepen vetëm pasi të jetë verifikuar ekzistenca e infrastrukturave të nevojshme, për sa u përket rrugëve lidhëse, elektricitetit dhe ujit të pijshëm ose marrjes për sipër të realizimit të tyre nga investitori njëkohësisht me ndërtimin e objekteve të sipërpërmendura.
3. 3. Leja e ndërtimit për objektet e kësaj kategorie, jepet vetëm me kushtin e ruajtjes dhe mosndryshimit të destinacionit për qëllim bujqësor/blegtoral të objektit për të cilin është lëshuar.
4. 4. Për qëllim të llogaritjes së vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit, në intensitetin e ndërtimit përfshihet ngastra ose bllok ngastrash edhe kur ndahen nga rrugë, kanale apo kufij të tjerë natyralë, në pronësi apo përdorim. Lëshimi i lejes së ndërtimit për objektet, sipas kësaj pike, shteron mundësinë e ndërtimit në të gjitha ngastrat që janë përdorur për llogaritjen e vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit.
5. 5. Ndërtimet e lejuara në tokë bujqësore nuk duhet në asnjë rast të çënojë infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore.



### Neni 23 – Njësitë strukturore me përdorim bujqësi dhe natyrë

1. Në të gjitha njësitë strukturore me përdorim natyrë (N) apo me përdorim të përzier bujqësi dhe natyrë (BN), lejohet ndryshimi i raporteve mes të dy përdorimeve, vetëm në rastet e parashikuara nga pika 3 e Nenit 3.
2. Në rastet kur një pronë e përfshirë nga ky plan brenda njësisë me përdorim *natyrë* (N) ose *bujqësi* (B), gëzon statusin “truall” para miratimit të këtij plani, lejohet ndërtimi sipas përcaktimeve për kategorinë e përdorimit të tokës “Banim” në Shtojcën 1 të VKM 686, datë 22/11/2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” duke respektuar këto përcaktime:
  - h maksimale 2.5 kate;
  - sipërfaqe minimale e pronës = 300m<sup>2</sup>;
  - sipërfaqe më e madhe e lejuar e gjurmës së ndërtesës = 150m<sup>2</sup>.
3. Autoritetet vendore të zhvillojnë programe stimulimi për zhvillimin ekonomik të bazuar në politika agrare që stimulojnë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm nëpërmjet rijetëzimit të prodhimeve bujqësore për ekonominë e familjeve individuale si dhe krijimin e investimeve centralizuese për zhvillimin e prodhimeve kolektive.

### Neni 24 - Mënyra e ndërhyrjes në territor sipas përdorimeve të lejuara të tokës dhe të strukturave në të

1. Mënyra e ndërhyrjes (zhvillimit ose kufizimit të zhvillimit) në njësitë strukturore, evidentojnë objektivat e ndërhyrjes në strukturën urbane ekzistuese që duhet të arrihen për njësitë përkatëse. Këto mënyra përfshijnë:
  - a. Rizhvillim
  - b. Konsolidim urban
  - c. Konservim
  - d. Ristrukturim/rigjenerim
2. Në vijim të pikës 1 të këtij neni, mënyrat e ndërhyrjes në njësitë strukturore nënkuptojnë konceptet si vijon:
  - a. **“Rizhvillim”** – apo zhvillimi, janë mënyra veprimi në procesin e planifikimit, në njësi strukturore me dendësi të ulët deri të lartë banimi dhe përdorimi, të cilat kanë për qëllim të rivlerësojnë treguesit e zhvillimit të një-

sisë strukturore dhe të transformojnë strukturën ekzistuese urbane.

- b. **“Konsolidimi urban”** - procesi i densifikimit dhe mbushjes urbane të një njësie strukturore apo të një pjese të saj, pjesërisht të zhvilluar dhe kryesisht homogjene për nga kategoria e përdorimit të tokës, me struktura të të njëjtit karakter, funksion, përdorim, tregues të planifikimit, zhvillimit dhe ndërtimit me ato të pronave/strukturave me të cilat kufizohet. Në këto raste në respektim të kushteve të kësaj pike, lejohen zhvillime pa PDV me kushtin që treguesit e zhvillimit për parcelën apo grup-parcelat për zhvillim nëpërmjet mbushjes urbane, nuk i kalojnë vlerat numerike të treguesve të zhvillimit maksimal të objekteve kufitare dhe respektojnë përcaktimet ligjore për distancat.
  - c. **“Konservimi”** - përfshin tërësinë e veprimeve të ndërmarra nga plani të cilat synojnë ruajtjen e pasurisë urbane, ekonomike dhe sociale si edhe të vlerave historike, kulturore dhe mjedisore në kohë, sipas përcaktimeve të këtij Plani të Përgjithshëm Vendor dhe të legjislacionit të posaçëm në fuqi;
  - d. **“Ristrukturimi/Rigjenerimi”** - përfshin veprimet në procesin e planifikimit, të cilat kanë për qëllim të rivlerësojnë dhe ripërtërijnë strukturën ekzistuese urbane dhe të hapësirave publike, të cilat nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të tokës/strukturës, karakterin, funksionin si dhe treguesit e planifikimit. Ky proces nuk parashikon zhvillimin apo rrizhvillimin e hapësirave apo parcelave, përveç rasteve kur parashikohen ndërhyrje të kombinuara për njësinë specifike sipas përcaktimeve të këtij plani dhe kësaj rregullore zhvillimi. Procesi i rigjenerimit synon gjithashtu rigjallërimin e tipologjive ekzistuese hapësinore, të përdorimeve bujqësore, natyrore, etj, duke ruajtur karakterin ekzistues dhe stimuluar zhvillimin ekonomik në territor.
3. Në mënyrë që të theksohet dinamika urbane do të përcaktohen sipas rasteve edhe ndërhyrje të kombinuara për njësi strukturore me karakteristika të veçanta zhvillimi ekzistues, si p.sh. “Ristrukturim dhe Konsolidim Urban” apo “Konservim dhe Ristrukturim”. Në këto raste, strukturat e reja mund të ndërtohen vetëm pas miratimit të Lejes të Zhvillimit e cila do të përcaktojë mënyrën dhe dimensionin e ndërhyrjes në territor, përmirësimin e infrastrukturave të shërbimeve për njësinë dhe kufirin e ruajtjes së territoreve me përdorim natyror.
  4. Mënyra e ndërhyrjes për çdo tipologji njësie strukturore do të përcaktohet në Kreun X, të kësaj rregullore.





KREU V – PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR





**Neni 25 - Përkufizime dhe rregulla për njësitë strukturore që nuk janë subjekt hartimi i planeve të detajuara vendore**

1. Çdo kërkesë zhvillimi për të gjitha njësitë strukturore për të cilat nuk parashikohet nevoja e hartimit të planeve të detajuara vendore do të procedohet direkt në fazën e Lejes të Zhvillimit, ku aplikanti do të duhet të paraqesë kërkesën për zhvillim sipas përkufizimeve ligjore të përcaktuara nga rregulloren e zhvillimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 408, datë 13.05.2015 (i ndryshuar).
2. Në rastet kur projekti përfshin zhvillimin e njëkohshëm të më shumë se 4 strukturave apo të më shumë se një tipologjie përdorimi të tokës dhe strukturave në të, atëherë aplikimi për Leje Zhvillimi do të përfshijë edhe studimin e volumetrisë urbane, e cila do të definojë mënyrat e ndërhyrjes në territor sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi.

**Neni 26 – Leja e zhvillimit**

1. Leja e Zhvillimit nënkupton instrumentin e kontrollit të zhvillimit të territorit, në kuptim të këtij neni dhe të përcaktimeve ligjore sipas ligjit 107/2014, i ndryshuar, për "Planifikimin e Territorit" dhe "Rregullores të Zhvillimit" miratuar me V.K.M., nr. 408, datë 13.05.2015 (i ndryshuar).
2. Dokumenti i Lejes të Zhvillimit do të përmbajë:
  - a. Përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme
  - b. Planin e vendosjes të strukturës/strukturave
  - c. Volumetrisë e strukturave të propozuara për zhvillim
  - d. Përdorimin e tokës dhe të strukturave në të
  - e. Intensitetin e ndërtimit
  - f. Koefficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim
  - g. Lartësinë e objektit
  - h. Distancat
  - i. Hapësirat e gjelbra publike
  - j. Parkimet



- k. Fragmentin e hartës në gjëndjen ekzistuese, që pasqyron edhe lidhjen me infrastrukturën në zonë
  - l. Informacion rreth kufizimeve apo kushtëzimeve të veçanta në pronën përkatëse
3. Në rastet kur Leja e Zhvillimit kërkohet pas miratimit të Planit të Detajuar Vendor, Leja e Zhvillimit mund të jetë edhe ekstrakt i PDV-së, me kushtin që të përmbajë informacionin bazë të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, për zonën e menaxhimit për të cilën kërkohet e Leja e Zhvillimit.
  4. Për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të Lejes të Zhvillimit do të veprohet sipas ligjit të planifikimit dhe rregulloreve në funksion të tij, në fuqi.

#### **Neni 27 – Hartimi i planeve të detajuara vendore**

1. Njësitë strukturore të cilat do të nënshtrohen hartimit të PDV janë të përcaktuara në hartën treguese dhe në pasaportat parametrike të treguesve të zhvillimit në vijim të kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore përcakton:
  - a. Njësi strukturore ku mund të procedohet me leje zhvillimi dhe në mungesë të PDV, sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi, këtij plani dhe akteve ligjore në fuqi.
  - b. Njësi strukturore të cilat do të zhvillohen vetëm pas hartimit të Planeve të detajuara vendore si dhe kushtet e përgjithshme që këto PDV duhet të respektojnë.
  - c. Mënyra ndërhyrje në territor të cilave u jepet e drejtë zhvillimi pa PDV edhe nëse rregullat për njësinë përcaktojnë përcaktimin e mundësive të zhvillimit nëpërmjet hartimit të Planeve të Detajuara Vendore.
3. Hartimi i PDV për çdo njësi, mund të bëhet edhe në dy faza. Në këto raste, në fazën e parë, dokumentacioni do të përmbajë:
  - a. Planin e detajuar të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, në përputhje me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe Planin e Përgjithshëm Vendor;
  - b. Shpërndarjen e treguesve të zhvillimit dhe të planifikimit për çdo zonë zhvillimi në nivel parcele, tipologjitë e ndryshme të ndërtimeve dhe vendosjen e tyre në lidhje me kufijtë e pronave dhe rrugët, balancimin e interesave



- të palëve, përfshirë Bashkinë Vorë, dhe përshkrimin e mënyrës se si do të alokohen dhe shpërndahen kostot dhe përfitimet;
- c. Plani teknik i infrastrukturave dhe shërbimeve të zonës, përfshirë buxhetin për realizimin e punimeve në infrastrukturë dhe shërbime, formën e kontributit në zhvillim dhe vlerën e përgjithshme të tij;
  - d. Hapësirat për strukturat me interes publik, të tipit sheshe publike, zona të gjelbra, shkolla etj., dhe orientime volumetrike mbi trajtimin e tyre nga pikëpamja e projektimit urban;
  - e. Madhësinë e parcelës minimale dhe asaj maksimale për efekt zhvillimi;
  - f. Mënyrën e plotësimit të elementeve të tjerë të nevojshëm për kontrollin e zhvillimit në territor sipas përcaktimeve të VKM nr.686, dt.29.07.2015 "Për miratimin e rregulloreve të instrumentave të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit".
4. Autoritetet vendore të planifikimit, me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuara në këtë rregullore, nuk lejohet të procedojnë me leje zhvillimi apo ndërtimi për ato njësi strukturore që parashikohet të hartohet PDV sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe kësaj rregullore zhvillimi.
  5. Në rast se brënda territorit të njësisë strukturore, përfshihen edhe struktura të pallateve të ndërtuara përpara viteve '90, PDV nuk do të përfshijë në studim për zhvillim apo rizhvillim, këto struktura dhe hapësirat e hapura rreth tyre, me përjashtim të rasteve kur për arsye të qëndrueshmërisë konstruktive të këtyre strukturave, parashikohet prishje e tyre. Këto struktura dhe hapësirat e hapura rreth tyre, mund të nënshtrohen ristrukturimit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
  6. Autoritetet vendore duhet të sigurojnë hartimin dhe miratimin e planeve të detajuara vendore për të gjithë njësitë strukturore të përcaktuara nga PPV-ja si subjekt PDV-je, brënda 18 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij plani të përgjithshëm vendor dhe rregullores së zhvillimit të tij.



#### **Neni 28 – Kushte dhe norma për hartimin e planeve të detajuara vendore**

1. Plani i detajuar vendor sipas përcaktimit të ligjit të planifikimit dhe rregulloreve në funksion të tij, është procesi i detajuar i planifikimit i cili siguron implementimin dhe respektimin e instrumenteve vendore dhe kombëtare të planifikimit për një apo më shumë njësi strukturore.
2. Në kushtet e hartimit të PDV-së, territori në studim, i përbërë nga një apo disa



njësi strukturore, do të nën-ndahet për efekt detajimi në nënzona sipas këtij rendi hierarkik:

- a. Zonat e zhvillimit dhe ristrukturimit, të cilat përfshijnë nën-ndarjen bazë për qëllimin e analizës territoriale dhe shpërndarjen parametrike të treguesve të zhvillimit për secilën zonë zhvillimi
  - b. Zonat e menaxhimit, të cilat do të formësohen sipas projektimit urban dhe planit të menaxhimit të pronave në funksion të tij
3. Hartimi i PDV-së do të sigurojë shpërndarjen e barabartë proporcionalisht të treguesve të zhvillimit për secilën zonë zhvillimi.
  4. Pronat me përdorim publik, të cilat nuk përfshijnë rrugë dhe sheshe do të përfshihen në zonimin për zhvillim dhe do të konsiderohet me të drejta të barabarta zhvillimi si të gjitha pronat e tjera private. Në këto raste mbi pronat me përdorim publik do të delegohen të drejta zhvillimi proporcionalisht të barabarta me të gjitha pronat private, pjesë të zonave të zhvillimit.
  5. Zonat e ristrukturimit do të përcaktohen nga analiza e territorit subjekt hartimi i PDV-së, duke përkufizuar strukturat të cilat do të konsiderohen situatë e formuar dhe parcelat e manaxhuara apo hapësirat e hapura në funksion të tyre.
  6. Strukturat të cilat do të konsiderohen si situatë e formuar, do jenë ato struktura të cilat i përkasin hierarkisë më të ulët të lartësisë, sipas përcaktimeve të pikës 4 të Nenit 44 të kësaj rregullore. Në rastet kur një strukturë ekzistuese më e lartë kërkon të drejta rizhvillimi, atëherë struktura dhe parcela në funksion të saj do futet për rizhvillim sipas përcaktimeve të këtij plani dhe kësaj rregullore zhvillimi, edhe në rastet kur PDV është miratuar. Përfshirja e strukturave të reja për qëllime rizhvillimi, do të reflektohet në rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit sipas përcaktimeve të kësaj rregullore dhe kushteve ligjore për rishikimin dhe miratimin e PDV-së.
  7. Përcaktimi i zonave të zhvillimit dhe ristrukturimit do të bëhet bazuar në rrjetin rrugor ekzistues dhe të propozuar, apo sipas rastit në akset e pronave publike, kur këto të fundit përkufizojnë apo ndihmojnë në nën-ndarjen zonale për qëllime zhvillimi.
  8. Rrjeti rrugor i propozuar nga ky plan apo nga projektuesi gjatë procesit të hartimit të planit të detajuar vendor, do të shërbejë kryesisht për nën-ndarjen e zonave të zhvillimit, përjashtuar zonat e ristrukturimit të cilat sipas rastit mund të ndahen nga zonat e zhvillimit edhe sipas përkufizimit të parcelave të manaxhuara apo përfshira në zhvillimin e situatës të formuar.



9. Gjatë përkufizimit të zonave për zhvillim, projektuesi të ketë në konsideratë nevojat për plotësimin e njësisë me infrastrukturën e shërbimeve e cila kërkon sipërfaqe kompakte për realizimin e implementimit të tyre. Në të tilla raste, zonat e rihvillimit duhet të jenë të mëdha në mënyrë që të realizojnë gjenerimin e sipërfaqeve publike kompakte në shërbim të realizimit të infrastrukturës të shërbimeve të nevojshme në zonë.
10. Në rastet kur rrezet e mbulimit prekin disa njësi paralelisht, autoritetet vendore do të gjykojnë nëse njësia për të cilën kërkohet zhvillimi është e përshtatshme për realizimin e infrastrukturës së kërkuar, në të kundërt, infrastruktura do të sigurohet në njësinë kufitare sipas standarteve. Në këto raste, projektuesit ti kërkohet të hartohet PDV paralelisht për të dy njësitë strukturore të cilat i përgjigjen si interesit për zhvillim ashtu dhe nevojave të përcaktimit të hapësirave për realizimin e infrastrukturës të shërbimeve në territor.
11. Projektimi urban për secilën zonë menaxhimi, pjesë të një zone zhvillimi, duhet të mundësojë realizimin e mundësive proporcionalisht të barabarta të zhvillimit. Realizim proporcionalisht i barabartë do të thotë një diferencë jo më e madhe se 0.5 për intensitetin e secilës zone menaxhimi pjesë të një zone zhvillimi.
12. Në rastet kur në një zonë zhvillimi, si pasojë e situatës së formuar në territor apo e formës së veçantë të një apo më shumë zonash menaxhimi, nuk arrihet nga projektimi urban realizimi i mundësive të zhvillimit proporcionalisht të barabarta për secilën zonë menaxhimi, atëherë projektuesi duhet ta argumentojë teknikisht pamundësinë duke paraqitur pranë autoriteteve vendore të planifikimit më shumë se dy varjante zgjidhje të projektimit urban në funksion të përafrimit të diferencës mes zonave të menaxhimit.

#### **Neni 29 – Përmbajtja dhe procedura e miratimit të PDV-ve**

1. Përmbajtja dhe formati i planit të detajuar vendor do të përcaktohet me rregullore të veçantë nga autoritetet vendore të planifikimit, në përputhje me kushtet dhe përcaktimet ligjore të kësaj rregullore të zhvillimit dhe rregullores të planifikimit në fuqi.
2. Procedura e miratimit të planit të detajuar vendor do të përcaktohet me rregullore të veçantë nga autoritetet vendore të planifikimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.





11

12

KREU VI – PËRKUFIZIME DHE KUSHTE PLANIFIKIMI DHE KONTROLLI I  
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT





### Neni 30 – Tipologjitë hapësinore

1. Ndërtesat që ndodhen në territorin e bashkisë formësojnë tre tipologji kryesore hapësinore në territor: të vendosura në mënyrë lineare, në blloqe dhe përgjatë rrugicave pa krye (“qorre” - cul de sac).
  - a. *Linearet:* Tipologjia hapësinore e parë bazohet në organizimin e vendosjes të strukturave në rresht, njëra pas tjetrës, të shtëpive, shërbimeve, etj., përgjatë linjave kryesore të infrastrukturës së lëvizjes. Këto ndërtesa janë zakonisht të aksesueshme direkt nga rruga dhe pozicionime të këtij tipi mund të plotësohen me struktura të dimensioneve dhe tipologjive të ndryshme arkitektonike, duke variuar nga disa shtëpi në qyteza të tëra. Tipologjitë lineare të hapësirave urbane të vërejtura janë si pasojë e vendosjes të të gjitha strukturave përgjatë anëve të një rruge kryesore në një apo më shumë rreshta.
  - b. *Blloku:* Kjo tipologji hapësinore përbën bllokun urban. Perimetri i një blloku tradicionalisht përkufizohet nga një rrjet rrugor. Brënda këtij territori të përkufizuar nga rrjeti rrugor pozicionohen një numër i limituar strukturash të ulta apo të larta të vendosura sipas projektimit urban. Blloqet gjënden kryesisht në qytet dhe ndonjë lagje e ndonjë fshat punëtorësh gjatë periudhës socialiste.
  - c. *Cul de sac:* Tipologjia e tretë hapësinore bazohet në organizimin e elementëve dhe strukturave përgjatë rrugëve apo rrugicëzave qorre të ndërlidhura me nyje apo akse kryesore. Në këto raste, shtëpitë apo strukturat e vendosura në këto rrugë, kanë si hapësirë të vetme publike në funksion të tyre rrugën, e cila është dhe akses i vetëm në çdo ndërtesë të kësaj tipologjie hapësinore.

### Neni 31 – Tipologjitë e strukturave

1. Në kuptim të kësaj rregullore zhvillimi dhe këtij plani të përgjithshëm vendor, analiza e territorit dhe e tipologjiive hapësinore të studjuara në territor përfshijnë një varietet tipologjish të pjesës më të madhe të strukturave që gjënden në territorin administrativ. Në këtë kuptim, këto struktura janë:
  - a. **Shtëpia urbane historike.** Kjo tipologji i referohet shtëpive 2-katëshe të ndërtuara në Vorë gjatë periudhës 1912-1940 dhe ndërtesave 1-katëshe që



datojnë nga periudha e pushtimit Osman. Ndërsa tipologjia e parë janë vila të rrethuara nga një kopësht apo nga një ndërtesë agregat në krah, e dyta i përket tipit të shtëpive të vogla me bahçe që bashkërisht formëzojnë një strukturë urbane të dendësuar.

- b. **Shtëpi rurale historike.** Në zonat rurale, grumbull shtëpish të vjetra të ndërtuara me gur datojnë para periudhës të regjimit socialist. Këto shtëpi janë një ose dy katëshe, drejtëkëndore kryesisht, me dimensione të gjanshme (rreth 13.5 x 5.5 m). Muret perimetrale janë ndërtuar prej guri dhe elementësh druri, me çati me skelet druri.
- c. **Shtëpi nga koha socialiste.** Të ndërtuara pas 1946 nga regjimi Komunist, këto tipe shtëpish variojnë mes tipologjive një katëshe (9 x 12 m) dhe shtëpive dy katëshe apo atyre të vendosura zinxhir. Shtëpitë e vogla një-katëshe përbëhen nga një hyrje/portik, një holl dhe katër dhoma kryesore (e ditës, e gatimit, 2 dhoma gjumi) dhe një banjë. Parcela është zakonisht rreth 400 m<sup>2</sup> dhe përgjithësisht e rrethuar me gardh metalik. Vitet e fundit këto shtëpi kanë pësuar shtesa në pjesët e jashtme të strukturave të cilat në disa raste e bëjnë të pamundur evidentimin e formës origjinale të strukturës.
- d. **Banesa socialiste.** Blloku i apartamenteve socialiste është një tipologji ndërtesash tip, zakonisht me 5 dhe 6 kate, kryesisht të përbëra nga një shkallë qendrore. Këto struktura gjenden të vendosura në mënyrë individuale në modelin e tipit kullë, apo në seri, duke formësuar struktura lineare përgjatë rrugëve kryesore. Hyrja në këto ndërtesa është pa derë dhe kafazët e shkallëve janë të aksesueshme në mënyrë të atillë sa e sjellin përkatësinë publike të ndjeshme deri te dera e apartamentit. Këto struktura bazohen në dy tipologji kryesore ndërtimi: tulla dhe beton apo paletë të parafabrikuara betoni, të fundit kryesisht gjatë fundit të periudhës komuniste, viteve 70-80. Pas viteve 90, shumë nga këto ndërtesa kanë pësuar transformime në mënyra të ndryshme si pasojë e ndërtimeve të paligjshme/informale. Kryesisht ndërhyrjet janë në drejtim të mbylljes të ballkoneve, shtesave të volumeve në kate të sipërme dhe anësore, ndërsa gradualisht ka filluar dhe mbyllja e shkallëve për të krijuar privatësi.
- e. **Shtëpi një-katëshe.** Në zonat rurale ka shumë ndërtesa një katëshe të riprodhuara nga një tip i tipologjisë të banesave një-katëshe të periudhës socialiste, me një sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, të përbëra nga struktura betoni, me hyrje nga një portik dhe në disa raste me terracë.
- f. **Shtëpi shumë-katëshe.** Të ndërtuara sidomos gjatë periudhës së 25 viteve të fundit, shtëpitë familjare disa-katëshe gjëndet kudo përgjatë territorit,





kryesisht në afërsi të qendrave kryesore urbane apo përgjatë infrastrukturës rrugore kryesore. Këto shtëpi përbëhen nga struktura b/a dhe mure tullash termike. Shpesh këto shtëpi paraqesin pjesë të papërfunduar në një kat të tërë. Kur pjesa e papërfunduar gjëndet në katin përdhe, kjo sipërfaqe përdoret kryesisht për shërbimet e kopshtit, bahçes, garazh, depo, etj., ndërsa kur kati i papërfunduar është i sipërmi përdoret kryesisht për të nderë rrobat ose është totalisht i papërdorur. Në disa raste, shtëpitë disa katëshe kanë shërbime apo aktivitete ekonomike të vendosura në katet përdhe të tyre.

- g. **Ndërtesa me apartamente.** Të ndërtuara pas 1992, ndërtesat kolektive shumëkatëshe të tipologjive, përmasave dhe lartësive të ndryshme gjëndet kudo në zonat urbane. Këto ndërtesa gjëndet në tipologji kullë dhe lineare, si agregate apo të vetmuara, të ulëta apo të larta, me struktura b/a dhe me tulla termike (për kohën). Katet përdhe zakonisht janë me funksione ekonomike. Çdo kat përbëhet nga një apo më shumë apartamente në varësi të dimensionit të katit, zakonisht me një shkallë dhe një ashensor.
- h. **Struktura publike në shkallë të vogël.** Këto përfshijnë qendra shëndetësore (kryesisht ambulancat e ndërtuara gjatë periudhës të regjimit socialist), shkolla fillore të vogla, kopshte në zonat rurale dhe gjatë kohëve të fundit ndërtesa fetare të shpërhapura kudo pranë zonave të banuara. Në këtë kategori përfshihen edhe stacionet e policisë apo komisariatet dhe varrezat.
- i. **Struktura publike në shkallë të madhe.** Këto përfshijnë qendrat kulturore, ndërtesat e administratës vendore apo të njëjësive administrative – dikur ndërtesa administrate vendore të territorit, struktura ushtarake, shkolla të mesme dhe profesionale kryesisht në qendrat urbane, etj.
- j. **Hapësirë publike.** Këto përfshijnë hapësirat publike për përdorim kolektiv si sheshe, kopshte, lulishte, parqe dhe fushat sportive. Këto gjëndet përgjithësisht në zonat kryesore urbane.
- k. **Zonë/Trashëgimi arkeologjike.** Zonat arkeologjike kryesisht në qytetin e Vorës përfshijnë zona si ajo e kalasë dhe amfiteatrit, ajo e “forum macellum”, banjat termale, “Porto Romano”, etj. Zonat e trashëgimisë përfshijnë kryesisht territoret e kalave apo kështjellave si ajo e kalasë të Rodonit, të Vorës, të Ishmit, Tre-Muret kryesore të qytetit të ndërtuara në periudhën Romake, etj. Gjithashtu me rëndësi janë dhe ndërtesat fetare si Basilika e Arapajt, Kisha e Shën Antonit në Kep të Rodonit, Xhamia e Ishmit dhe kisha e Shën Luçisë të Vorës.
- l. **Ndërtesa tregtare/industriale me madhësi të vogël.** Aktivitete ekono-



mike të vogla streohen kudo në struktura të vogla apo në katet e para të ndërtesave mikse. Këto aktivitete ekonomike përfshijnë përdorime kafesh, ushqimoresh, shërbimesh si rrobaqepës apo floktore apo lavazhesh a lavanderish, dyqanesh të ndryshme, kryesisht të vendosura pranë qendrave dhe përgjatë rrugëve kryesore.

- m. **Ndërtesa tregtare/industriale me madhësi mesatare.** Kjo tipologji korrespondon me strukturat industriale të mesme, në të cilat zhvillohen aktivitete ekonomike si fasoneri, përpunime, shërbime, magazinime apo struktura logjistike, etj. Kjo tipologji ndërtesash gjëndet e ndërtuar prej strukturash metalike apo prej strukturash b/a dhe tullë apo vetratash xhami dhe elementësh duralumini. Kryesisht këto ndërtesa gjënden përgjatë autostradës Tiranë-Vorë apo përgjatë rrugëve kryesore kombëtare.

### **Neni 32 – Tipologjitë e strukturave për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që ndërtohen në tokë bujqësore**

1. Në kuptimin e kësaj rregulloreje, përkufizimi dhe rregullat e zhvillimit të strukturave për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që ndërtohen në tokë bujqësore, i referohen legjislacionit të posaçëm Ligjit nr.8752, datë 26.03.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës” të ndryshuar, dhe Vendimit të KM nr.283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar, janë:

- a. stallet për mbarështimin e kafshëve dhe objektet ndihmëse funksionale, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në depo silazhi, hangar, silos, ambiente për përpunimin e ushqimeve, sallë mjeljeje, padoqe, plehrishte, depozita uji;
- b. serat me themele të vazhduara, të cilat janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën;
- c. objektet ndihmëse funksionale të serave, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në magazina për standardizimin e prodhimit dhe mbajtjen e pajisjeve, imputeve;
- d. objektet për tharjen dhe trajtimin paraprak të nevojshëm të produkteve në kultura, të tilla si bimët medicinale etj.;
- e. objektet për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e bleg-



torale, përfshirë dhe ato frigoriferike;

- f. objekte për përpunimin e produkteve primare, bujqësore dhe blegtorale;
  - g. Thertoret.
  - h. Strukturat për agro-turizëm, me përdorim primar tregtimin e prodhimeve bujqësore. Këto struktura mund të përfshijnë zhvillimin e restoranteve, hoteleve, dhomave të shërbimit (si për agro-turizëm ashtu dhe për aktivitetin bujqësor), pika shitje për produktet, mullinj/fabrika prodhimi vajrash ulliri/luledielli/misri/etj, vere, etj.
2. Këto struktura planifikohen bazuar në analizat e përvitshme të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, duke marrë në konsideratë dhe nevojat e zonave specifike. Në çdo rast ndërtimi i këtyre strukturave do të kryehet në zbatim të pikës 3 të këtij neni dhe legjislacionit në fuqi duke vlerësuar ndikimin në mjedis që sjell zhvillimi.
  3. Lejimi i zhvillimit të këtyre strukturave do të bëhet vetëm nëse fermeri apo SHBB e investitorit privat përfshin një sipërfaqe minimale prej 1 Ha tokë bujqësore të kultivuar/kultivueshme. Përkatësia pronësore nuk është detyruese, por sipërfaqja minimale është kusht. Fermerët privatë/SHBB/sipërmarrësit, të cilët sigurojnë lëshimin e lejes së ndërtimit duhet të garantojnë kultivimin e sipërfaqes minimale prej 1 Ha, për një periudhë minimale prej 10 vitesh, në të kundërt, licenca për aktivitetin ekonomik në fushën e agro-turizmit do t'i hiqet sipërmarrësit.
  4. Lejohet ndërtimi i strukturave për strehimin e prodhimeve bujqësore, në parcela minimale prej 9000 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe maksimale 35 m<sup>2</sup> dhe një lartësi maksimale prej 4.5 m. Këto struktura duhet të jenë të karakterit të përkohshëm dhe nuk lejohet të përdoren për banim.

### Neni 33 – Hapësira publike

1. Të gjitha hapësirat publike në shërbim të komunitetit, me menaxhim privat apo publik, të cilat përfshijnë rrugëkalime, mjedise të hapura dhe rekreative, sheshe, lulishte, parqe, etj., pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", janë në administrim të autoritetit vendor të Bashkisë Vorë, në respektim të Nenit 4/1, të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin e Territorit".
2. Të gjitha planet e detajuara vendore, lejet e zhvillimit dhe lejet e ndërtimit, do të sigurojnë zhvillimin e hapësirave publike dhe atyre rekreative në respektim të përcaktimeve të këtij neni, të kësaj rregullore zhvillimi dhe kushteve ligjore ne



fuqi.

3. Të gjitha zhvillimet e strukturave të banesave kolektive, do të sigurojnë realizimin e këndit të lojrave të fëmijëve, sipas grup-moshave, duke siguruar aktivitete sportive dhe rekreative sipas standarteve të projektimit, si pjesë e detyrueshme e sistemimeve të jashtme gjatë punimeve, sipas përcaktimeve të kësaj rregullore zhvillimi dhe kushteve të lejes të ndërtimit në respektin të këtij neni.
4. Në respektim të kushteve të këtij neni, dhe prioritizimit të gjenerimit të hapësirave publike, në të gjitha ndërhyrjet për rizhvillim, në komplekset e banimit apo grup-strukturat e banesave kolektive, gjatë projektimit urban autoritetet e planifikimit të njësisë vendore do të kujdesen për gjenerimin e hapësirave publike kompakte në funksion të aktiviteteve rekreative dhe gjenerimit të sipërfaqeve me gjelbërim të lartë në blloqet e banimit.

#### **Neni 34 – Rregulla dhe kritere të veçanta për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore**

1. Ndërtimet e objekteve ndihmëse funksionale për tipat sipas nenin 32, të kësaj rregulloreje, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
  - a. Zhvillimi maksimal i strukturave të mos tejkalojë e ndërtimit 0.03
  - b. Të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektojnë lartësinë maksimale 6 metër në kulmin e mbulesës dhe 4,50 në ullukun horizontal, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi për shkak të karakteristikave teknike dhe përveç strukturave për agro - turizëm që mund të ndjekin rregullat e pasaportës përkatës;
  - c. Të realizohen sipas tipologjive të përshtatshme për funksionin që do të kryejnë dhe që nuk lejojnë ndryshimin e destinacionit të përdorimit;
  - d. Për ç' do strukturë bujqësore të realizueshme sipas nenit 32 të kësaj rregulloreje duhet të parashikohet zbatimi i strukturave të nevojshme për vënie në regjim, mbledhjen, kana lizimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të reshjeve dhe të atyre që janë rezultat i proceseve të impiantit.
2. Ndërtimet e reja të stallave lejohen me kusht që të garantojnë menaxhimin e jashtëqitjeve shtazore, me filtrim paraprak.
3. Stallat, që mbarëshojnë mbi 50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, duhet të kenë këto karakteristika:

- a. Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:
    - i. 20 metër nga kufijtë e pronës;
    - ii. 500 metër nga qendrat e banuara;
    - iii. 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.
  - b. Të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektojnë lartësinë maksimale 6 metër në kulmin e mbulesës dhe 4,50 në ullukun horizontal, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi për shkak të karakteristikave teknike dhe përveç strukturave për agro - turizëm që ndjekin rregullat e pasaportës përkatëse;
  - c. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej  $0.5 \text{ m}^3/\text{m}^2$
4. Për stallat që mbarështojnë 10-50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 10 metër, ndërsa karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 3.
  5. Për stallat që mbarështojnë 5-10 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 5 metër, ndërsa nga banesa më e afërt 50 metër. Karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 3, të këtij neni.
  6. Strukturat për grumbullimin e jashtëqitjeve me origjinë shtazore duhet të vendosen në distancë jo më të vogël se 50 metër nga banesat për stallat me 5-10 njësi gjedhi dhe 100 metër për stallat më të mëdha.
  7. Sipërfaqja e serave me themele të vazhduara, të cilat janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, nuk duhet të tejkalojë 70% të sipërfaqes së pronës.
  8. Për serat e përcaktuara në pikën 7 duhet të respektohen distancat e mëposhtme:
    - a. jo më pak se 5 metër nga banesat ekzistuese në të njëjtën ngastër dhe 10 metër nga banesat e tjera;
    - b. jo më pak se 3 m nga kufiri i pronës.
  9. Për serat e tipave të tjera, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, nuk kërkohet pajisja me një leje ndërtimi dhe ato janë objekt i një deklarate paraprake për kryerje punimesh. Distancat për ndërtimin e tyre janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 8 të këtij neni.



10. Ndërtimet e objekteve për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
  - a. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej  $1 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ;
  - b. Të respektojnë distancat minimale 7 metër nga kufijtë e pronës dhe 10 m nga ndërtesa të tjera.
11. Ndërtimet e objekteve për thertore duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
  - a. Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej  $1 \text{ m}^3/\text{m}^2$ ;
  - b. Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:
    - i. 20 metër nga kufijtë e pronës;
    - ii. 500 metër nga qendrat e banuara;
    - iii. 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.
12. Rregullat dhe kriteret e përcaktuara në të gjitha pikat e këtij neni zbatohen në të gjitha rastet, përveçse kur me akte të tjera, ligjore e nënligjore, përcaktohet ndryshe.

### Neni 35 – Banesat familjare në territorin urban dhe sub-urban

1. Zhvillimi i strukturave një-familjare me përdorim banim lejohet pa nevojën e hartimit të planit të detajuar vendor, pavarësisht përcaktimeve të njësisë strukturore, në ato njësi për të cilat lejohet përdorimi i kësaj kategorie.
2. Në rastet kur zhvilluesi apo pronari i parcelës kërkon të drejtë zhvillimi për banesë një-familjare, gjatë hartimit të PDV-së, të përcaktuar nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi, lartësia maksimale e lejuar për zhvillim është 2 kate.
3. Në këto raste, kur mënyra e përcaktuar e ndërhyrjes në territor parashikon mundësi rizhvillimi me intensitet të mesëm dhe të lartë, gjatë hartimit të PDV-së, autoritetet vendore do të tregojnë kujdes në shpërndarjen e treguesve të zhvillimit dhe përcaktimin e zonave të zhvillimit, për të dhënë mundësi zhvillimit të barabartë edhe parcelave të zhvilluara nga parashikimet e këtij neni me të gjitha parcelat apo grup-parcelat e tjera të studjuara dhe vlerësuara për zhvillim.
4. Për të gjitha rastet e tjera, për përcaktimin e procedurave të të drejtës për zhvillim

për banesat nje-familjare apo shumë-familjare, do të veqrohet sipas parashikimeve të këtij plani, kësaj rregullore zhvillimi dhe kuadrit ligjor në fuqi.

### **Neni 36 – Banesat familjare në territorin rural**

1. Lejohet zhvillimi i strukturave individuale me përdorim banim, në njësitë strukturore me përdorim natyror dhe bujqësor vetëm në zonat urbane të përcaktuara nga ky plan, me kushtin e respektimit të parametrave zhvillimore sipas parashikimeve të përcaktuara nga kjo rregullore për territorin rural.
2. Përjashtim nga përcaktimet e pikës 1 të këtij neni, apo rregullat e rindërtimit nëpërmjet ristrukturimit, bëjnë ato raste në të cilat rihvillimi apo rindërtimi prek strukturat ekzistuese apo historike, pjesë të territorit historik urban apo rural të fshatrave, sipas përcaktimeve të specifikuara në pasaportat e njësive.
3. Në rastin e zhvillimit të strukturave individuale, zhvilluesi merr përsipër ndërtimin me shpenzimet e veta të të gjithë infrastrukturës inxhinierike dhe teknike të nevojshme për shfrytëzimin e territorit rural për banim.
4. Në të gjitha rastet e kërkesave të zhvillimit për banim në territorin rural, në të cilin nuk është zhvilluar infrastruktura inxhinierike, sipas parashikimeve të këtij neni dhe kësaj rregullore zhvillimi, struktura e propozuar do të parashikojë realizimin e infrastrukturës septike sipas standarteve teknike.
5. Për të gjitha lejet e ndërtimit të lejuara sipas përcaktimeve të këtij neni, rendi dhe grafiku i punimeve ndërtimore do të kërkohet të parashikojë realizimin e infrastrukturës inxhinierike për furnizimin me ujë dhe depozitimet septike, sipas standarteve të përcaktuara nga ky nen dhe kjo rregullore zhvillimi, përpara fillimit të punimeve ndërtimore për zhvillimin e strukturës së banimit. Vetëm pas kontrollit nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit të territorit për implementimin e infrastrukturës inxhinierike, do të lejohet fillimi i punimeve ndërtimore për strukturat e banimit.
6. Përcaktimet e të gjitha pikave të këtij neni, vlejnd dhe për të gjitha kategoritë e përdorimeve të tjera.

### **Neni 37 – Komplekset mikse në territorin rural**

1. Komplekse mikse janë ato zhvillime të cilat përfshijnë zhvillimin e njëkohshëm të më shumë se 4 banesave nje-familjare apo të më shumë se një tipologjie për-



dorimi të tokës dhe strukturave në të dhe që përmbushin kushtet e përcaktuara në Nenin 25, Kreu V, i kësaj rregullore zhvillimi.

2. Për miratimin e tipologjive të komplekseve të banimit dhe shërbimeve në territor apo njësi-strukturore, autoritetet vendore do procedojnë me Leje Ndërtimi vetëm pas miratimit të Lejes të Zhvillimit, e cili do të definojë teknikisht dhe grafikisht të gjitha mënyrat e ndërhyrjes në territor, grafikun e punimeve në rend kategorie ndërhyrje në territor, duke priorizuar realizimin e infrastrukturës inxhinierike dhe septike sipas standarteve teknike në fuqi.
3. Në rastet kur zhvillimet komplekse prekin njëkohësisht territoret gjeografike të dy apo më shumë njësive strukturore, në një sipërfaqe totale që nuk i kalon 30% të sipërfaqes totale të këtyre njësive strukturore të prekura nga strategjia e zhvillimit, kërkesa për zhvillim do të shoqërohet me aplikimin për miratimin e Lejes të Zhvillimit e cila do të paracakttojë kushtet e zhvillimit në aplikimin për Leje Ndërtimi.
4. Në rastet kur interesi për zhvillimit prek pjesë të territorit subjekt PDV, atëherë procedura e kërkesës për zhvillim do t'i nënshtrohet procedurës për PDV sipas parashikimeve të ligjit dhe kësaj rregullore vendore.

#### Neni 38 - Koeficienti i shfrytëzimit të tokës (KSHT)

1. Koeficienti i shfrytëzimit të tokës (Ksht) për ndërtim është raporti ndërmjet sipërfaqes së gjurmës së strukturës të vendosur në parcelë/grup-parcelash me sipërfaqen e përgjithshme të parcelës/grup-parcelave.
2. Gjurma e strukturës matet nga vendosja e planit të katit përdhe në parcelë/grup parcelash.
3. KSHT-ja matet në përqindje (%).
4. KSHT-ja maksimale për kategoritë banim për njësitë strukturore pjesë të zonave urbane lejohet deri në masën 50%, për njësitë strukturore pjesë të zonave sub-urbane lejohet deri në masën 30% dhe për njësitë strukturore pjesë të zonave rurale lejohet deri në masën 20%, ndërsa në tokat bujqësore KSHT do të jetë 0%.
5. KSHT-ja maksimale e lejuar për kategorinë e shërbimeve në territor, pjesë të zonave urbane, lejohet deri në masën 45%. Për territorin sub-urban rekomandohet të jetë deri në masën 25%.
6. KSHT-ja maksimale e lejuar për kategorinë e përdorimeve për struktura dhe terr-



itore industriale dhe ekonomike është 70%.

7. Në të gjitha rastet dhe tipologjitë e ndërhyrjeve mikse në territor, KSHT do të matet sipas përdorimeve. Në rastet kur ndërthurjet bëhen në lartësi, KSHT do të zbatohet sipas përkufizimeve për kategorinë e përdorimit të vendosur në katin përdhe. Në rastet kur ndërthurjet e përdorimeve bëhen në plan, atëherë KSHT do të llogaritet për të gjitha përdorimet bashkërisht, me kushtin e respektimit të kufizimit maksimal të shfrytëzimit të territorit, sipas përcaktimeve të pikave 4 dhe 13 të këtij neni.
8. Për të gjitha tipologjitë e tjera të ndërhyrjes në territor dhe mënyrat e përdorimit të tokës, KSHT-ja do të përcaktohet në kodet e zonimit të tokës dhe kushtet e zhvillimit të njësive strukturore, përveç parashikimeve të pikës 4 të këtij neni.
9. Nuk konsiderohen gjurmë strukturore dhe nuk përfshihen në përlllogaritjen e KSHT-së vetëm ato raste të arkadave gjatësore të cilat kanë një gjerësi minimale prej 3 metrash përgjatë të gjithë gjatësisë të strukturës dhe vetëm ato raste tunelesh të cilat kanë një gjerësi minimale prej 6 metrash dhe lartësi minimale prej 8 metrash për shfrytëzim publik.
10. Nuk konsiderohen gjurmë ndërtimi dhe nuk përlllogariten në KSHT për ndërtim strukturat e përkohshme apo sipërfaqet e shfrytëzuara për rekreacion si pishina, shatërvane, pista hipizmi, etj, me përdorim publik apo privat, me kushtin që këto të fundit të jenë të hapura. Në rastin kur mjediset rekreative të përherëshme parashikohen të mbyllura, do të konsiderohen struktura dhe do të përfshihen në parashikimet e përcaktuara nga kjo rregullore dhe legjisllacioni në fuqi.
11. Përjashtim nga parashikimet e këtij neni bëjnë ato raste për të cilat Lejet e Ndërtimit janë kompetencë e Këshillit Kombëtar të Territorit, sipas përcaktimeve të ligjit të planifikimit dhe rregulloreve të zhvillimit në fuqi.
12. Në rastet kur zhvilluesi vë në dispozicion të interesit publik pjesë nga sipërfaqja e parcelës apo zhvillimit të kërkuar prej tij, apo kualifikohet për të përfituar nga parashikimet e zhvillimit me kushte për të përfituar sipërfaqe ndërtimore shtesë, sipas parashikimeve të kësaj rregullore, mund të përfitojë shtesë të koeficientit të shfrytëzimit të tokës deri në masën 55% të parcelës apo grup parcelave. Rastet kur vlera e përfitimit dhe kushtet për të cilat fitohet e drejta e shtimit të KSHT-së do të përcaktohen në PDV apo në dokumentin e Lejes të Zhvillimit. Në të gjitha rastet dhe përdorimet, përjashtuar vetëm pikën 6 të këtij neni, zhvilluesi nuk duhet të shfrytëzojë më shumë se 55% të territorit, parcelës apo grup-parcelave, për zhvillim.
13. Përjashtim nga pika 4 dhe 5 të këtij neni bëjnë vetëm rastet e rihvillimit të pallateve shumëfamiljare, dy kate e më shumë, ku transformimi urban kushtëzohet nga



shfrytëzimi i gjurmëve ekzistuese të godinave. Në këto raste, KSHT-ja mund të maksimalizohet deri në zëvendësim të plotë të gjurmëve të godinave ekzistuese, me kushtin e ruajtjes së siluetës së unifikuar të rrugëve në drejtim të vijave të ndërtimit.

14. Ksht-ja e lejuar për çdo njësi strukturore, për çdo lloj përdorimi, përcaktohet duke respektuar:
  - a. vlerat mjedisore dhe ekologjike në njësi;
  - b. vlerat e trashëgimisë kulturore në njësi;
  - c. diellëzimin dhe orientimin;
  - d. nevojën e krijimit të hapësirave publike.

#### **Neni 39 - Koefficienti i shfrytëzimit të territorit për rrugë (KSHR)**

1. Koefficienti i shfrytëzimit të parcelave për rrugë dhe zona të shtruara (KSHR) është raporti midis sipërfaqes së gjurmës në tokë të këtyre të fundit dhe sipërfaqes territoriale bruto të njësisë strukturore.
2. KSHR-ja matet në përqindje (%).
3. Përqindja e rekomanduar e KSHR-së për njësinë strukturore është minimalisht 10%.

#### **Neni 40 - Koefficienti i shfrytëzimit të territorit për hapësira publike (KSHP)**

1. Koefficienti i shfrytëzimit të parcelave për hapësira publike (KSHP) është raporti midis sipërfaqes së gjurmës në tokë të këtyre të fundit dhe sipërfaqes territoriale bruto të njësisë strukturore.
2. KSHP-ja matet në përqindje (%). Përqindja minimale e KSHP-së e rekomanduar për njësinë strukturore duhet të jetë 40%.
3. Për njësitë strukturore të cilat zhvillohen me anë të PDV-së duke parashikuar mbrojtjen e më shumë se 60% të ndërtimeve ekzistuese të zonës, koefficienti i shfrytëzimit të territorit për hapësira publike, në mënyrë përjashtimore mund të zvogëlohet deri në 20%.
4. Çdo tipologji ndërhyrje në territor, në respektim të këtij neni, duhet të sigurojë zhvillimin gjelbërimin filtrues për sipërfaqe minimale prej 10% të sipërfaqes të



parcelës apo grup-parcelave të përfshira në ndërtim, si pjesë përbërëse e territorit në funksion të KSHP-së.

#### **Neni 41 - Intensiteti i ndërtimit**

1. Intensiteti i ndërtimit (I) për një njësi strukturore jepet në vlerë numerike dhe shpreh sipërfaqen maksimale të ndërtimit për një njësi strukturore.
2. Intensiteti i ndërtimit (I) në Planin e Përgjithshëm Vendor, jepet në nivel bruto vetëm për ato njësi strukturore që janë objekt hartimi i Planeve të Detajuara Vendore dhe është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të pritshme të ndërtimit (shumën e metrave katrorë total ndërtim i pritshëm) për të gjitha kategoritë për një njësi strukturore / sipërfaqen totale të njësisë, pavarësisht përkatësisë pronësore të secilës parcelë, të llogaritur deri në akse të rrugëve të propozuara apo kufirit njësisë strukturore të përcaktuar nga PPV.
3. Rregullimi i raportit të intensitetit (I) nga Bruto në Neto, do të bëhet nëpërmjet analizës së territorit nga Planet e Detajuara Vendore, të cilat do të shprehin grafikisht dhe numerikisht diferencën mes sasisë së parashikuar totale për zhvillim për të gjithë njësinë strukturore dhe asaj të ndërtuar (situatë e formuar definitivisht). Diferenca do të shpërndahet në vijim në mënyrë proporcionale duke përcaktuar saktësisht sasinë volumore të pritshme për zhvillim për parcelat apo grup-parcelat e secilës zone zhvillimi.
4. Shpërndarja e parametrave të zhvillimit për të gjitha zonat e zhvillimit, subjekt i hartimit të PDV-ve, gjatë analizës së mënyrës së ndërhyrjes në territor, do të jetë proporcionale për të gjitha zonat e zhvillimit.
5. Për të gjitha njësitë strukturore të cilat nuk janë subjekt i hartimit të Planeve të Detajuara Vendore sipas përcaktimeve të këtij Plani të Përgjithshëm Vendor dhe kësaj Rregullore të Zhvillimit, intensiteti (I) për njësinë strukturore jepet në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me të gjitha parcelat apo grup-parcelat e njësisë strukturore dhe është i njëjtë si për njësinë ashtu dhe për çdo parcelë brenda territorit të njësisë strukturore.
6. Parcelat të cilat shtrihen në dy njësi strukturore do të gjykohen rast pas rasti, duke prioritetizuar mundësimin e manaxhimit të vlerave të zhvillimit të një parcele brenda një njësie strukturore gjatë hartimit të PDV-ve apo zhvillimit. Në rastet kur njësitë kufitare kanë vlera apo mundësi të ndryshme zhvillimi, atëherë do të gjykohet sipas rastit duke përfshirë parcelen për zhvillim në njësinë strukturore me mundësi më të madhe zhvillimi nëse:



- a. një mundësi e tillë kërkohet nga zhvilluesi;
- b. parcela ka mbi 60% e sipërfaqes së saj brënda njësisë strukturore me hierarki zhvillimi më të lartë; apo
- c. zona zhvillimore e njësisë kufitare ku shtrihet parcela paraqitet e zhvilluar.

Për të gjitha rastet e tjera, parcela do të parashikohet me mundësi të ndryshme zhvillimi, sipas kufirit të njësisë strukturore, të cilat do të orientojnë zhvilluesit për riparcelizimet e nevojshme sipas mënyrave të zhvillimit të përcaktuara në këtë rregullore dhe planet e detajuara vendore.

- 7. Intensiteti i ndërtimit (I) për çdo tipologji njësie strukturore do të përcaktohet në kodet e zonimit të tokës dhe kushtet e zhvillimit të njësisë strukturore, pjesë të Kreu X, të kësaj rregullore.

#### **Neni 42 - Parametrat e zhvillimit për strukturat me interes publik**

- 1. Parametrat e zhvillimit për strukturat e interesit publik, strukturat për arsim publik dhe për shërbimin shëndetësor, do të shqyrtohen rast pas rasti bazuar në kodet/standartet e projektimit.
- 2. Në rastin kur këto kode/standarde mungojnë, zhvillimi do t'i referohet manualeve të projektimit dhe standardeve të vendosura nga Bashkimi Evropian.

#### **Neni 43 - Distancat**

- 1. Treguesit bazë të përcaktuar nga kjo rregullore janë të detyrueshëm për t'u zbatuar projektuesit gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

Distancat sipas këtij neni duhet të jenë të tilla që të mos cenojnë lirinë e përdorimit të pronës, të krijojnë hapësira publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe të garantojnë siguri individuale dhe shëndetësore.

- 3. Distancat e përcaktuara në këtë rregullore janë: distancat midis ndërtimeve; distancat midis ndërtimit dhe kufirit të parcelës/pronës; distancat midis ndërtimit dhe kufirit të trupit të rrugës;
- 4. Përcaktimi i distancave bëhet nga autoriteti i planifikimit sipas përcaktimeve në këtë rregullore, dhe në PDV, në përputhje me këtë nen, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm sektorial në fuqi.
- 5. Për përcaktimin e distancave vlerësohen: orientimi dhe diellzimi, gjendja e ndërt-

imeve kufitare, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë sipas legjislacionit të posaçëm.

6. Për përcaktimin e distancave ndërtesë-ndërtesë, ndërtesë-rrugë dhe ndërtesë-kufij prone, në projektim, do të zbatohen normat minimale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me përjashtim të rasteve kur PDV propozon distanca të tjera më të mëdha se minimumi i parashikuar.
7. Në zonat e konservimit apo ristrukturimit, që nuk janë subjekt për hartimin e PDV-ve, në rastet e nevojës së rindërtimit të banesave të vjetra dhe të papërshtatshme për të jetuar në parcelën ekzistuese, do të ruhen distancat e ndërtesës ekzistuese edhe për ndërtimin e ri, me kusht që të mos ndryshojnë koeficienti i shfrytëzimit të truallit dhe intensiteti i ndërtimit ekzistues.
8. Për arsye të zhvillimit të parashikuar nga PPV-ja për një zonë urbane të konsoliduar, ku do të aplikohet konsolidimi urban ose rizhvillimi, veçanërisht në kushtet e zbatimit të instrumenteve financiare të drejtimit të zhvillimit, të aplikuara nëpërmjet hartimit të planit të detajuar vendor apo kur diktohet nga nevoja për krijim të hapësirës publike të kompakte, në një zonë urbane me zhvillim intensiv, distanca e objektit/ndërtesës nga rruga duhet të respektojë vijën e ndërtimit ekzistuese të formuar. Në këto raste kjo distancë mund të jetë edhe 0 metër nga kufiri i pronës/parcelës.
9. Në rastet e zhvillimit pa PDV, gjatë procesit të konsolidimit urban, nëse pronari i një ndërtese ekzistuese të ulët, shpreh interesin për të zhvilluar pronën e tij, ndërkohë që strukturat kufitare me parcelën kur kërkohet zhvillimi, të ndërtuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, nuk kanë respektuar të gjitha kushtet e distancave (ndërtesë-ndërtesë, ndërtesë-kufij prone, ndërtesë-rrugë) të legjislacionit përkatës në kohën kur është kryer ndërtimi, atëherë pronarit të ndërtesës ekzistuese që ka interes, i lind e drejta të zhvillojë/ndërtojë, duke ruajtur vetëm distancat nga kufiri i pronës përkatëse dhe/ose nga rruga duke respektuar vijën e ndërtimit të formuar.
10. Distanca nga kufiri i pronës llogaritet sipas VKM 408/2015, Neni 35 që përcakton se *distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m ( $d = nr. k + 1m$ ) ku:  $d$  - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe  $nr. k$  - numri i kateve.*
11. Në zonat historike dhe të mbrojtura monument kulture dhe të ansamblit urban sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi, të respektohen distancat ekzistuese të tipologjisë arkitektonike historike të zonës, duke ruajtur vijën e ndërtimit të for-



muar në kohë nga ndërtimet.

12. Në rastet kur përdoret gropë septike dhe pus individual për furnizimin me ujë, në çdo zonë banimi, distanca mes të dyjave do të jetë minimalisht 15 metër.

#### Neni 44 – Vija e ndërtimit

1. Vija e ndërtimit është kufiri maksimal i lejuar për vendosjen e një strukture në lidhje me trupin e rrugës ose kufirin e zonës zhvillimore apo njësisë që i referohet, referuar kushteve ligjore të përcaktuara në Kodin Rrugor apo vijave të ndërtimit ekzistuese të përcaktuara nga situata e formuar në terren apo analiza mbi terrenin nga studimi i rrjetit rrugor apo planet e detajuara vendore.
2. Vija e ndërtimit përcakton pozicionimin e faqes të një strukture në raport me kufirin e trupit të rrugës ekzistuese apo të propozuar.
3. Faqe e strukturës nënkupton trupin e përgjithshëm të strukturës përfshirë çdo dalje konsol.
4. Në rastet kur planet e sistemimit dhe të vendosjes të katit përdhe parashikojnë nevojën e vendosjes së shkallëve dhe rampave për akses, nuk lejohet që pozicionimi i tyre të tejkalojë vijën e ndërtimit.
5. Në çdo rast, volumetria e strukturës duhet të jetë brenda kufijve të parcelës apo grup-parcelave të pronave të përfshira në zhvillim.

#### Neni 45 – Lartësia e strukturave

1. Përcaktimi apo saktësimi i lartësisë maksimale të lejuar për efekt planifikimi për çdo zonë zhvillimore pjesë të njësisve strukturore subjekt hartimi plani të detajuar vendor, të shprehur në numër katesh dhe në metra, bëhet gjatë hartimit të PDV-së duke respektuar:
  - a. lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re të propozuar;
  - b. normat e lejuara të distancave;
  - c. vlerat mjedisore dhe ekologjike në njësi;
  - d. vlerat e trashëgimisë kulturore në njësi;
  - e. diellëzimin dhe orientimin;



- f. respektimin dhe harmonizimin e siluetës ekzistuese me atë të propozuar;
  - g. respektimin e normave mjedisore.
2. Lartësia e strukturave përcaktohet në numër katesh apo në metra në bazë të lartësisë të propozuar të katit, llojit të zhvillimit të strukturave dhe numrit maksimal të kateve.
  3. Në rastet kur lartësia e strukturës shprehet në metra, lartësia e çdo kati me përdorim banim apo shërbime, llogaritet sipas përcaktimeve të lartësisë minimale nga rregulloret e zhvillimit në fuqi. Në rastet e strukturave të shërbimit, qendrave komerciale apo kullave të biznesit, lartësia e katit do të përllogaritet nga përcaktimet e PDV-së apo dokumentit të Lejes të Zhvillimit sipas rastit, duke e arsyetuar teknikisht nëpërmjet prezantimit të projekt idesë të zhvillimit.
  4. Zhvillimet e strukturave, në varësi të kategorive të zonimit, ndahen në:
    - a. Zhvillim i strukturave të ulta (deri në 3k);
    - b. Zhvillim i strukturave të mesme (3 – 6 k);
    - c. Zhvillim i strukturave të larta (mbi 6 k).
  5. Në zonat urbane dhe sub-urbane, lartësia maksimale e strukturave e lejuar për ndërtim është 6 kate. Përrjashtim nga ky kusht bëjnë vetëm rastet e zhvillimit sipas të intensitetit të ndërtimit me kushte në të cilat lejohen deri në 2 kate shtesë me lartësi totale të strukturës që nuk i kalon 8 kate.
  6. Strukturat mbi tarracë e çati, si: oxhaqet, tubat, pajisjet e ashensorëve, panele diellore dhe elemente të tjera të ngjashme, nuk llogariten në lartësinë e strukturave.
  7. Në rastet kur si pasojë e terrenit të pjerrët, ekzistues apo të sistemuar, njëra nga faqet e strukturës del tërësisht në dukje mbi tokë, atëherë e gjithë sipërfaqja e soletës të katit deri në thellësi 8m nga faqja që merr dritë, do të konsiderohet kat mbi tokë dhe për të do të llogariten kushtet e zhvillimit. Në respektim të këtij rregulli, katet që marrin dritë nga 2 faqe konsiderohen mbi tokë, dhe për to do të llogariten kushtet e zhvillimit sipas përcaktimeve të rregullores vendore.

#### **Neni 46 – Ristrukturimi i strukturave ekzistuese**

1. Proçesi i ristrukturimit të strukturave ekzistuese përfshin veprimet e ndërhyrjes për rivlerësimin apo rindërtimin e strukturave ekzistuese.
2. Proçesi i ristrukturimit lejohet pa nevojën e hartimit të planit të detajuar vendor,



pavarësisht përcaktimeve të njësisë strukturore, me përjashtim të punimeve që parashikojnë shëmbje dhe rindërtim të strukturave.

3. Në rastet kur ristrukturimi i strukturës ekzistuese parashikon zhvillimin apo shtimin pjesor volumetrik anësore apo në lartësi të strukturave ekzistuese në territor, sipas përcaktimeve të PDV-së, propozimi do të shoqërohet gjatë aplikimit për Leje Zhvillimi, me vendosjen e strukturës të propozuar për shtim apo plotësim të volumetrisë ekzistuese në raport me volumetrinë urbane ekzistuese, duke pasqyruar në plan dhe volumetri impaktin urban të propozimit sipas kushteve ligjore të distancave apo shfrytëzimit të territorit në fuqi.
4. Ristrukturimi përfshin edhe procesin e rindërtimit, për ato raste të ndërtesave të degraduara strukturalisht apo që përbëjnë rrezik për banorët e ndërtesave, për të cilat lejohet procesi i shëmbjes dhe rindërtimit edhe në zonat e konservimit, me kushtin e respektimit të gjurmës dhe kushteve urbanistike të strukturës origjinale. Në rastin rindërtimit apo ristrukturimit të një strukture monument kulture apo pjese të një ansambli kulturor, çdo ndërhyrje do të lejohet vetëm pas miratimit të organeve kompetente për monumentet e kulturës, sipas ligjit për monumentet e kulturës në fuqi.
5. Në të gjitha rastet kur ndërhyrjet për ristrukturim parashtrajnë dhe nevojën e shtesës volumetrike, kjo e fundit do të lejohet vetëm në respektim të kushteve ligjore të bashkëpronësisë sipas parashikimeve të përcaktuara në Kodin Civil në fuqi me miratimin e jo më pak se  $\frac{3}{4}$  të bashkëpronarëve të ndërtesës, apo në vlerësim të kushteve teknike të strukturës dhe kushteve arkitektonike, të cilat e lejojnë ndërhyrjen.
6. Në të gjitha strukturat buzë rrugëve kryesore dhe dytësore, shtesat lejohen vetëm për ndërhyrje nga autoritetet vendore, në respektim të politikave të zhvillimit për interes publik, për stimulimin e ristrukturimit të arkitekturës urbane dhe rigjenerimit Peizazhik të rrugëve kryesore dhe dytësore të qytetit.
7. Gjatë procesit të ristrukturimit, lejohen mbylljet e plota apo të pjesëshme të verandave apo terracave të shfrytëzueshme për shfrytëzim individual, në rastin kur këto gëzojnë titullin e pronësisë, me kushtin e respektimit të distancave të ndriçimit apo në rastet kur ndërhyrja nuk çënon arkitekturën Peizazhike të bllokut. Në të kundërt, në rastin e bashkëpronësisë, çdo ndërhyrje do të lejohet në respektim të pikës 5 të këtij neni, dhe kushteve ligjore në fuqi.
8. Në rastet kur ristrukturimi parashikon mbylljet e plota apo të pjesëshme të verandave apo terracave të shfrytëzueshme për shfrytëzim individual, apo në rastet kur parashikohet mbyllja e ballkoneve, kërkesa do të shoqërohet me projekt-idenë e zhvillimit e cila përcakton kushtet dhe mënyrën e ndikimit në fasadën origjinale





të strukturës. Autoritetet vendore të planifikimit do të gjykojnë rast pas rasti duke prioritetuar ruajtjen dhe unifikimin e ndërhyrjes në fasadë dhe arkitekturë. Vendimmarrja mund të kushtëzojë dhe ndërhyrje vetëm në ato raste kur ristrukturimi prek të gjithë fasadën e strukturës.

9. Proçesi i ristrukturimit, mënyrat e ndërhyrjes së rivlerësimit dhe proçesi i miratimit rregullohen sipas rregulloreve të zhvillimit dhe ligjit të planifikimit në fuqi, nëpërmjet autorizimit apo aplikimit për Leje Zhvillimi në varësi të tipologjisë të ndërhyrjes në strukturë.

#### **Neni 47 -Vazhdimësia e faqeve kallkan**

1. Në të gjitha ato territore të mundshme për zhvillim, që ballafaqohen me struktura ekzistuese me faqe kallkan, për të kryer mbylljen e zhvillimit (duke qënë se kallkani ka krijuar konceptin e vazhdimësisë në terren të situatës urbane) lejohen të drejta zhvillimi sipas parametrave të parashikuara nga kjo rregullore dhe ky plan. Këto të drejta përfshijnë mundësinë e zhvillimit sipas rasteve përjashtimore për stimulimin e një lloji të caktuar zhvillimi, sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 52 të kësaj rregullore zhvillimi.
2. Zhvillimi për mbylljen e faqeve kallkan sipas pikës 1 të këtij neni, lejohen vetëm me kushtin që:
  - a. Në zonat sub-urbane dhe rurale, struktura e re e paraqitur nga kërkuesi, në rast se nuk është parashikuar ndryshe në PDV, të mos ketë vijuese një faqe të re kallkan, për një zhvillim të ri vijues (por të vijë në kallkan vetëm me faqen e objektit ekzistues kallkan-për të mbyllur situatën e formuar-dhe në faqet/drejtimet e tjera-me faqe me distanca/dritare);
  - b. Propozimi për zhvillim i paraqitur nga kërkuesi nuk bie ndesh apo çënon zhvillimin e veprave me interes publik të nën-njësisë, si rrjetin rrugor, ndërtim facilitetesh publike si çerdhe, kopshte, shkolla (sipas parashikimeve të PPV ).
  - c. Propozimi për zhvillim i paraqitur nga kërkuesi nuk duhet të çënojë hapësirat e hapura, por të krijojë mundësi zhvillimi vetëm në ato territore ku sot ka aktualisht të ndërtuara banesa të ulta;
  - d. Zhvillimi i propozuar në këto njësi strukturore të respektojë karakterin urban të njësisë.



- e. Parametrat urbanë të këtyre rasteve do të gjykohen/shqyrtohen individualisht rast mbas rasti mbi përputhshmërinë me situatën urbane dhe parashikimet e Planit, nga autoritetet vendore, të cilat mund të miratojnë dhe/ose refuzojnë në mënyrë të arsyetuar kërkesën.
3. Gjatë hartimit të PDV-ve apo paraqitjes të kërkesave të reja për zhvillim, lejohet që zhvillimi i propozuar të përfundojë me një faqe të re kallkan, kur kjo e fundit është e domosdoshme për vijimësinë e zhvillimit.
  4. Nuk lejohet distancim i strukturave nga kufiri i pronës pavarësisht se ruhen distancat nga kufiri i pronës apo nga strukturat ekzistuese, në rastet kur zhvillimi i ri i propozuar nuk lejon mundësitë e zhvillimit me të njëjtat parametra për parcelat kufitare. Në këto raste autoritetet vendore duhet të sigurojnë vazhdimësinë e mundësisë së zhvillimit në perspektivë për parcelat kufitare nëpërmjet realizimit të zhvillimit me faqe kallkan sipas kushteve ligjore në fuqi.
  5. Pa rënë ndesh me pikën 4 të këtij neni, nën-ndarja e pronës për qëllime zhvillimi dhe dhënia e dakordësisë ligjore mes parcelave të reja të përfuara për krijimin e një faqe kallkan lejohet vetëm për pronat me sipërfaqe mbi 600 m<sup>2</sup> ku parcela me e vogël e përfuar nga nën-ndarja është mbi 150 m<sup>2</sup>.

#### Neni 48 - Parkimet

1. Çdo zhvillim duhet të sigurojë numrin e parkimeve për banorët dhe në raste të caktuara, për vizitorët dhe përdoruesit. Numri i parkimeve për banorët duhet të sigurohet brenda sipërfaqes së përgjithshme të parcelës apo grup-parcelave për zhvillim, mbi ose nëntokë.
2. Nga përcaktimet e pikës 1 të këtij neni mund të bëhet përjashtim, kur brenda njësisë ka parkime publike për tu ndërtuar sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm dhe kësaj rregulloreje nga organet publike ose subjekte private të cilat plotësojnë nevojat për parkim të banorëve të njësisë.
3. Në rastet kur për realizimin e parkimeve nevojitet shtrirja e tyre mbi tokë dhe ndërthurja e sipërfaqeve të parkimeve me sipërfaqet e gjelbra, atëherë zgjidhja duhet të jetë me pllaka të gjelbëra dhe parkimet duhet të përkufizohen me gjelbërim të mesëm dhe të lartë hijëzues.
4. Në këto raste, raporti i vënd-parkimeve të parashikuara nëntokë me ato të parashikuara mbi tokë nuk lejohet të tej-kalojë masën 70% nëntokë me 30% mbi tokë.
5. Sigurimi i parkimeve përgjatë rrugëve, me qëllim që objektet/zhvillimet private

të plotësojnë parametrat e kërkuara të parkimeve nuk është një përgjegjësi e detyrshme e organeve publike.

6. Numri i parkimeve që duhet të sigurohet për çdo objekt, është i lidhur me menaxhimin e trafikut dhe lëvizshmërinë. Mbështetur në studimet për transportin, duhet të mbahen në konsideratë këto normativa:
  - a. Banim - minimalisht 1 vënd parkimi për apartament / apo minimalisht 100 m<sup>2</sup> ndërtim;
  - b. Hotel – minimalisht 1 vend parkimi për çdo 3 dhoma (në këto raste projekti duhet ti përshtatet normativave ndërkombëtare për përcaktimin e cilësisë të shërbimit dhe kualifikimit të hotelit sipas standarteve të projektimit dhe planifikimit të shërbimeve në projekt;
  - c. Aktivitet tregtar - brenda qendrës: 1 vend parkimi për 100m<sup>2</sup>;
  - d. Nën-njësi strukturore tregtare periferike - 2 vende parkimi për 100m<sup>2</sup>;
  - e. Shërbime dhe facilitete - 1 vend parkimi për 100 m<sup>2</sup> sipërfaqe
  - f. Shkolla dhe edukim - 1 vend parkimi për çdo klasë;
7. Sipërfaqja minimale bruto e parkimit për makina private është 25m<sup>2</sup>
8. Në njësi strukturore të kategorisë Banim, për çdo zhvillim të parashikohet të paktën një vend parkimi për çdo njësi banimi, në respektim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.
9. Numri i parkimeve në objektet shumë funksionale mund të variojë në varësi të përqindjes së funksioneve.
10. Në të gjitha rastet, hyrja në parkimet nëntokësore duhet të sigurohet nëpërmjet rampës. Në rastet kur zhvilluesi propozon hyrje në parkim nëpërmjet ashensorit, kjo do të jetë suplementare e rampës.
11. Këto kërkesa mund të rishikohen, gjatë hartimit të PDV-ve, në varësi të politikave të transportit që synojnë të ulin kërkesën për parkim në qendër në lidhje me një akses të mirë të transportit publik dhe rritjen e nevojave për parkim në periferi.
12. Parkimet nëntokësore dhe strukturat e dedikuara për parkim publik, sipas pozicioneve të identifikuara në territor në PPV, do të trajtohen me studim të veçantë nga autoritetet vendore.

#### Neni 49 - Varrezat



1. Varrezat duhet të jenë të izoluar nga zonat e banimit nëpërmjet brezit të rezervuar. Ndalohen ndërtime të reja apo të zgjerohen ato ekzistuese brënda brezit të rezervuar prej 300 metra.
2. Këshilli i Bashkisë Vorë, ka të drejtë të vendosë për ndryshimin e gjerësisë të brezit të rezervuar.
3. Varreza private mund të ngrihen nga subjekte private mbi troje në pronësi të tyre. Ngritja e varrezave private do të bëhet me miratim të Këshillit të Bashkisë. Kriteret dhe procedurat për ngritjen e varrezave private përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 50 – Referencat ligjore

1. Në hartimin e kësaj rregulloreje janë mbajtur parasysht përcaktimet e ligjeve të poshtë-shënuara si dhe të gjithë akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.

1	Ligj nr.44/2015, datë 30.04.2015	Kodi i procedurave administrative
2	Ligj nr.139/2015, datë 17.12.2015	Për vetëqeverisjen vendore, ( i ndryshuar)
3	Ligj nr.9632, datë 30.10.2006	Për sistemin e taksave vendore, (i ndryshuar)
4	Ligj nr.8561, datë 22.12.1999	Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik
5	Ligj nr.7850, datë 29.07.1994	Kodi civil i Republikës së Shqipërisë, (i ndryshuar)
6	Ligj, Nr.33/2012, Dt.Aktit; 21.03.2012	Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme, (i ndryshuar)
7	Ligj nr.8743, datë 22.02.2001	Për pronat e paluajtshme të shtetit, ( i ndryshuar)
8	Ligj nr.8744, datë 22.02.2001	Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore,( i ndryshuar)
10	Ligj nr.133/2015, datë 05.12.2015	Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave
11	Ligj nr.9948, datë 07.07.2008	Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore (i ndryshuar)



12	Ligj nr.9482, datë 03.04.2006	Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e strukturave pa leje, (i ndryshuar)
13	Ligj nr.8402, datë 10.09.1998	Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit,( i ndryshuar)
14	Ligj nr.9780, datë 16.07.2007	Për inspektimin e ndërtimit ( i ndryshuar)
15	Ligj nr.9290, datë 07.10.2004	Për produktet e ndërtimit, ( i ndryshuar)
16	Ligj nr.152/2015, datë 21.12.2015	Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin
17	Ligj nr.8734, datë 01.02.2001	Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike, (i ndryshuar)
18	Ligj nr.32/2016 datë 24.03.2016	Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion,( i ndryshuar)
19	Ligj nr.6/2015, datë 12.02.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"
20	Ligj nr.9232, datë 13.05.2004	Për programet sociale për strehimin e banorëve të nën-njësi strukturore urbane, (i ndryshuar)
21	Ligji nr.8308, datë 18.03.1998	Për transportet rrugore, (i ndryshuar)
22	Ligji nr.8378, datë 22.07.1998	Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë, (i ndryshuar)
23	Ligji nr.9918, datë 19.05.2008	Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar)
24	Ligj nr.125/2013, datë 25.04.2013	Për koncesionet dhe partneritetin publik – privat (i ndryshuar)
25	Ligj nr.9869, datë 04.02.2008	Për huamarrjen e qeverisjes vendore (i ndryshuar)
26	Ligji nr.8527, datë 23.09.1999	Për privatizimin e hidrocentraleve vendore, (i ndryshuar)
27	Ligji nr.9789, datë 19.07.2007	Për krijimin dhe funksionimin e nën-njësiteve strukturore ekonomike
28	Ligj nr.9817, datë 22.10.2007	Për bujqësinë dhe zhvillimin rural



29	Ligj nr.111/2012, datë 15.11.2012	Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, (i ndryshuar)
30	Ligj nr.8102, datë 28.03.1996	Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, (i ndryshuar)
31	Ligj nr.8681, datë 02.11.2001	Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave (i ndryshuar)
32	Ligj nr.24/2017, datë 09.03.2017	Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit
33	Ligj nr.10431, datë 09.06.2011	Për mbrojtjen e mjedisit (i ndryshuar)
34	Ligj nr.8672, datë 26.10.2000	Për Ratifikimin e "Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit"
35	Ligj nr.10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis (i ndryshuar)
36	Ligj nr.10448, datë 14.07.2011	Për lejet mjedisore (i ndryshuar)
37	Ligj nr.9424, datë 06.10.2005	Për ratifikimin e "Protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor"
38	Ligj nr.81/2017, datë 18.05.2017	Për zonat e mbrojtura
39	Ligj nr.10/463, datë 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve (i ndryshuar)
40	Ligj nr.8094, datë 21.03.1996	Për largimin publik të mbeturinave
41	Ligj nr.162/2014, datë 04.12.2014	Për mbrojtjen e cilësisë të ajrit në mjedis
42	Ligj nr.9774, datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis (i ndryshuar)
43	Ligj nr.27/2018, datë 17.05.2018	Për Trashëgiminë kulturore dhe muzetë
44	Ligji Nr. 142/2016, datë 22.12.2016	Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë



45	Ligj nr.93/2015, datë 27.07.2015	Për turizmin
46	Ligj nr.10186 datë 05.11.2009	Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në nën- njësitë strukturore me përparësi turizmin.
47	Ligj nr.7893, datë 22.12.1994	Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik, (i ndryshuar)
48	Ligj nr.69/2012, datë 21.06.2012	Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë
49	Ligj nr.15/2017, datë 16.02.2017	Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë
50	Ligj nr.80/2015, datë 22.07.2015	Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar)
51	Ligj nr.9136, datë 11.09.2003	Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar)
52	Ligj nr.3766, datë 17.12.1963	Mbi shërbimin shëndetësor dhe dhënien falas të ndihmës mjekësore të shtetit, (i ndryshuar)
53	Ligj nr.62/2013, datë 14.11.2013	Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë
54	Ligj nr.107/2014, datë 31.07.2014	Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit (i ndryshuar)
55	Ligj nr. 93/2014, datë 09.11.2014	Për përfshirjen Sociale dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara
56	Ligj Nr. 8093, datë 21.03.1996	Për rezervat ujore, (i ndryshuar)





10



KREU VII – INSTRUMENTE TË DREJTIMIT TË ZHVILLIMIT





### Neni 51 – Intensiteti i ndërtimit me kushte

1. Intensiteti i ndërtimit me kushte është instrumenti i zhvillimit i cili synon të sigurojë kontribut për financimin e investimeve kapitale në infrastrukturë dhe shërbime të përgjithshme me interes publik apo social për Bashkinë e Vorës.
2. Kontributi për sigurimin e zhvillimit të interesit publik dhe social, jepet nga kërkuesi i të drejtës për zhvillim në kushtet e pajisjes me leje zhvillimi, në marrëveshje me autoritetin vendor, sipas përcaktimeve të identifikuaras mes palëve gjatë hartimit të PDV-së apo miratimit të Lejes së Zhvillimit.
3. Treguesit e zhvillimit të përcaktuara nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi, do të rriten proporcionalisht për zhvillimin e kërkuar sipas përcaktimeve të dakorduara mes palëve në respektim të kushteve ligjore të përcaktuara në këtë nen, me kushtin e respektimit të limiteve të vendosura në këtë rregullore zhvillimi dhe sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
4. Intensiteti i ndërtimit me kusht sipas përcaktimeve të këtij neni, përfshijnë të drejtën e shtimit të numrit të kateve të parashikuara si orientim i lartësisë të zhvillimit nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi.
5. Në respektim të kushteve të distancave sipas nenit 42 të kësaj rregullore dhe pikës 3 të nenit 35 të “Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, miratuar me VKM Nr. 408, datë 13.05.2015, katet shtesë subjekt i të drejtës të intensitetit të ndërtimit me kushte, të cilat do të nxisin një intensifikim dhe densifikim të ndërtimit në zonë sipas përcaktimeve të këtij neni, nuk do t’i nënshtrohen treguesve të distancave. Në këto raste, volumi i kateve shtesë do të përcjellë në altimetri siluetën e shkallëzimit të katit më të lartë të detyruar nga përcaktimet ligjore të neneve të treguesve të distancave, sipas lartësisë të propozuar nga ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi dhe në respektim të kushtit shkallëzimeve të strukturës, në të cilën nuk lejohen më shumë se një shkallëzim dhe më pak se 2 kate në volumnin e shkallëzuar.
6. Në rastet kur rregullore e zhvillimit i jep të drejtë PDV-së të përcaktojë lartësinë maksimale të strukturave, vendim-marrja për formën urbane në respektim të kushteve ligjore dhe përcaktimeve të distancave për zonat me dendësi të lartë, do të jetë subjekt i autoriteteve vendore të planifikimit, në respektim të pikës 5 të këtij neni dhe kushteve ligjore në fuqi.
7. Kontributi që zhvilluesi do të dhurojë njësisë vendore në këmbim të të drejtës shtimit të intensitetit sipas programit të intensitetit të ndërtimit me kushte, do të përfshijë 10%-15% të sipërfaqes totale shtesë, sipas përcaktimeve të këtij neni.
8. Vlera dhe pozicioni i saktë i sipërfaqes, kontribut, që përftohet nga programi i




Intensitetit të Ndërtimit me Kushte, do të përcaktohen nga PDV apo dokumenti i Lejes së Zhvillimit, e cila do të saktësohet nëpërmjet kontratave të shkëmbimit të pjesëve takuese për njësinë vendore.

9. Në përlllogaritjen e kontributit, do të vlerësohet hierarkia e vlerës së shitjes sipas çmimit të referencës, e cila do të saktësohet duke patur në konsideratë trendin e zbritjes të kontributit nga qendra drejt periferisë, në raport me zbritjen e vlerës së çmimit të referencës.
10. Rastet në të cilat zhvilluesi përfshihet në programin e Intensitetit të Ndërtimit me Kushte përfshijnë dhe ato raste kur zhvilluesi strehon në zhvillimin e tij ndërtues informalë, apo banorë në nevojë për strehim social apo banorë të strukturave të degraduara që përbëjnë rrezik për to dhe komunitetin. Në këto raste, strehimi i banorëve në nevojë konsiderohet si kontribut me interes publik dhe zhvilluesi nuk ka nevojë të përfshihet në marrveshjet për shkëmbimin e të drejtës për zhvillim, sipas pikave 7 deri 9 të këtij neni.
11. Procedura për miratimin e Intensitetit të Ndërtimit me Kushte, do të përcaktohet me rregullore të veçantë nga autoritetet vendore të planifikimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.








KREU VIII – SISTEMI I MOBILITETIT





Instrumente të drejtimit të zhvillimit



## Neni 52 – Infrastruktura

1. Koncepti i rrjetit rrugor në planin rregullues bazohet në dy shtylla kryesore :
  - a. Rrjeti Rrugor ekzistues i klasifikuar në përputhje me shpërndarjen e lëvizjes.
  - b. Rrjeti Rrugor i ri i cili do të ndërtohet si në zonat ekzistuese të urbanizuara po ashtu dhe shtrirjet dhe zgjerimet e planifikuara së bashku me klasifikimin.
2. Rrjeti ekzistues rrugor në Vore karakterizohet nga zhvillim kryesisht i mjaftueshëm për sa i përket distancave të rrugëve dhe intensitetit të rrjetit, kjo dhe për shkak të investimeve të kryera ndër vite, por gjithsesi zgjerimi dhe përmirësimet janë ende një faktor i rëndësishëm. Konfigurimi i rrjetit të propozuar rrugor është hartuar me qëllim plotësimin e kërkesave që plani urban parashikon. Në të njëjtën kohë, është prezantuar një shtim i rrjetit, i cili lehtëson plotësimin e hallkave që mungojnë në rrjetin ekzistues. Plotësimi i sistemit rrugor me zgjatime dhe zgjerime është ndër aspektet më kryesore në zhvillimin e sistemit rrugor në Vorë dhe ky sistem është një nga pikat kyçe që përfshihet në të gjithë dokumentacionin rregullues mbi qytetin. Harta më poshtë tregon se si rrjeti rrugor duhet të zhvillohet në të ardhmen që të përballojë rritjen e pritshme të trafikut. Elementi kryesor që propozohet është spostimi i një segmenti të rrugës interurbane kryesore që lidh Vorëin me Tiranën, spostim që do të ndihmonte si kontekstin urban të zonës së Vorës, po ashtu do siguronte dhe një lëvizje të sigurtë.
3. Rrjeti i propozuar përfshin konceptin e lëvizshmërisë së qëndrueshme që paraqitet në plan. Parimet dhe tiparet kryesore të planifikimit janë bazuar te:
  - a. Lëvizja (multimodale), e cila do të kufizonte rritjen e trafikut të mjeteve të motorizuara, do të ulte ndikimin negativ të trafikut në mjedis dhe do të përmirësonte cilësinë e mjedisit në zonat qendrore urbane.
  - b. Plotësimin e Infrastrukturës, si dhe klasifikimin e sa si një masë efektive për strukturimin e zhvillimit urban hapësinor, si një element kryesor në konfigurimin e rrjetit për reduktimin e trafikut në zonat qendrore urbane.

Baza ligjore në të cilën mbështetet përcaktimi dhe kategorizimi i rrjetit rrugor është ligji Nr. 8378, date 22.7.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë (me ndryshimet), vendimi nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së shqipërisë”, (me ndryshimet), si dhe të gjitha aktet e tjera të dala në zbatim të tyre.

Klasifikimi i rrjetit rrugor

Figura 1  
Hierarkia  
e rrjetit të  
propozuar të  
rrugëve



- c. Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale rrugët klasifikohen si vijon:
- A. Autostradë
  - B. Rrugë interurbane kryesore
  - C. Rrugë interurbane dytësore
  - D. Rrugë urbane kryesore
  - E. Rrugë urbane dytësore
  - F. Rrugë lokale

Sa më sipër klasifikimi i rrugëve në qytetin e Vorës:

**B) Rruge interurbane kryesore:** Rruge me karrexhata të payarura ose të ndara nga trafikndares të pakapercyeshem, secila me të paktën dy korsi levizjeje dhe bankina të shtruara, pa kryqezime në nivel, me hyrje të koordinuara për objekte anësore, e dallueshme nga siniale të veçanta të fillimit dhe mbarimit, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjeteve me motor. Për të tjera kategori të mundshme mjeteve të përdoruesve duhet të parashikohen hapësira të pershtatshme. Për qëndrimin duhet të jenë parashikuar zona të caktuara, me hyrje e dalje, të pajisura përkatësisht me korsi ngadalesimi dhe shpejtimi.

**C) Rruge interurbane dytësore:** Rruge me një karrexhatë me të paktën një korsi levizjeje për sens dhe bankina. Rrugët interurbane janë rrugët me funksione hyrëse dhe dalje nga qyteti dhe në shërbim të transportit të kembimit ndërmjet territorit urban dhe ekstra urban, si dhe të transportit transit përkundërt zonave urbane. Në këto kategori rruges, në të cilën hyjnë – për qytetet me të mëdha – autostradat urbane, pranohen elementet e transportit me levizjen e automjeteve të linjes dhe jo të linjes, duke përjashtuar në këto rast automjetet që nuk mund të levizin me shpejtësi mbi 50 km/ore. (Në këto rruge nuk lejohen vendparkimet, ndalesat e mjeteve publike, motorcikletat dhe levizjet e kembësoreve, me përjashtim të rasteve kur paisen me korsi të veçanta përdorimi si pjesë e rruges).

**D) Rrugë Urbane Kryesore:** Rrugë me karrexhata të pavarura, ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi levizjeje dhe një korsi i mundshme e rezervuar për mjete publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqezime në nivel të pajisura me semafor, për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqëndruara.

**E) Rrugë Urbane Dytësore:** Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi



manovrimi jashtë karrexhatës. Rruge urbane funksioni i të cilave është garantimi i fluiditetit të cvendosjes të kembimit të automjeteve edhe rrjetit të qarkullimit brenda qytetit po dhe të ndërlidhjes me rrugët interurbane. Ato lejojnë një nivel të lartë të shërbimit të cvendosjes në distanca më të mëdha brenda rrjetit urban. Në këtë kategori rruges bëjnë pjesë rrugete shpejta urbane, rrugët me shpejtesë të kufizuar urbane, itineraret e rezervuara të mjeteve publike të krijuara në korsitë e rrugëve të rezervuara. Në rrugët urbane kryesore me korsitë jo të rezervuara, janë të lejuara të gjithë komponentet e Transportit si dhe sipas përkufizimit edhe përjashtimi i qendrimeve të automjeteve aty ku rruga duhet të jetë rrjedhëse kryesore.

**F) Rrugë Lokale:** Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme. Rrugët lokale kanë funksion lidhës ndërmjet lagjeve fqinje (cvendosje në distanca minimale, gjithmone brenda qytetit) ose për zonat urbane me dimensione më të mëdha, ndërmjet pikave ekstreme të lagjeve. Në këtë kategori hyjnë, rrugët e destinuara për shërbimet kryesore urbane të lagjeve. Janë të pranueshme në këto rrugë të gjithë komponentet e Transportit, përfshi këtu dhe vendparkimet e automjeteve private. Rrugët lokale janë në shërbim direkt të zonës ku ndodhen. Në këtë kategori bëjnë pjesë rrugët për kembësore dhe rrugët për parkim; Klasifikimi funksional i sipërpermendur i rrugëve nuk përjashton mundësinë që (atje ku shihet e nevojshme) të përcaktohen itinerare specifike të rezervuara, të detyrueshme ose preferenciale, për kategori të veçanta të përdoruesve të mjeteve levizëse dhe komponentet e tjera të transportit rrugor si: bicikleta, automjete në shërbim të invalidëve, automjete tregtare dhe automjete të urgjencës dhe ndihmës të shpejta. Klasifikimi në fjalë nuk përjashton, për kundërshtim, studimin e ndërveprimit ndërmjet transportit rrugor dhe llojeve të tjera të transportit. Po kështu një vëmendje e veçantë duhet të kushtohet klasifikimit funksional të ndërveprimeve, me stacionet hekurudhore, aeroportet, portet dhe të transportit me teleferik etj.

Në qytetin e Vores infrastruktura rrugore do të përbëhet sipas klasifikimit:

- Rrugë interurbane kryesore 18 km
- Rrugë interurbane dytësore 39 km
- Rrugë urbane kryesore 0 km
- Rrugë urbane dytësore 7 km
- Rrugë lokale 192 km
- Rrugica 219 km

**Neni 53 – Struktura e rrjetit rrugor**



KODI RRUGOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE  
KAPAKTERISTIKAT SIPAS TIPI TË RRUGEVË

Tipi i rrugës	Klasifikimi territorial	Kategori e rrugës	Niveli i kurbave per drejtim	shpejtësia loretuale km/orë	Prindësia e rrugës	Largësia e kurbave	Largësia maksimale	Largësia minimale	Largësia maksimale koef.ansurimi	Koridori i trafikut	Koridori i shpejtësive	Përshkrimi
	1											
A	Interurbane	rrugë kryesore	2 e me lartë	90 - 140	1100	3,75	0,70	0	3,00			
	Interurbane	rrugë shprehëse	1 e me lartë	40 - 100	650/1350	3,50	0,50	1,75	0			
	urbane	rrugë kryesore	2 e me lartë	90 - 140	1450	3,75	0,70	0	3,00			
	urbane	rrugë shprehëse	1 e me lartë	40 - 60	1150/1650	3,50	0,50	1,75	0			
B	Interurbane	rrugë kryesore	2 e me lartë	70 - 120	1000	3,75	0,50	1,75	0			
	Interurbane	rrugë shprehëse	1 e me lartë	40 - 100	650/1200	3,50	0,50	1,50	0			
C	Interurbane	rrugë kryesore	2 e me lartë	60 - 100	950	3,75	0	1,50	0			
	urbane	rrugë kryesore	2 e me lartë	50 - 80	950	3,50	0,50	1,00	0			
	urbane	rrugë kryesore	1 e me lartë	40 - 60	800	3,25	0,50	0,50	0			
	urbane	rrugë kryesore	1 e me lartë	40 - 60	800	3,50	0,50	0,50	0			
D	urbane	rrugë kryesore	1 e me lartë	40 - 60	800	3,50	0,50	0,50	0			
	urbane	rrugë kryesore	1 e me lartë	40 - 60	750	3,25	0,50	0,50	0			
	urbane	rrugë kryesore	1 e me lartë	40 - 60	700	3,25	0,50	0,50	0			
	urbane	rrugë kryesore	1 e me lartë	40 - 60	800	3,00	0	0,50	0			
E	urbane	rrugë kryesore	1 e me lartë	40 - 60	600	3,00	0	0,50	0			
	urbane	rrugë kryesore	1 e me lartë	40 - 60	600	3,00	0	0,50	0			
F	urbane	rrugë lokale	1 e me lartë	25 - 60	500	2,75	0	0,50	0			

Figura 2  
Klasifikimi i rrjetit rrugor








1. Ndertimi i rrugëve në të ardhmen për menyrat alternative të lëvizjes është parashikuar si më poshtë:
  - a. Projekti i spostimit të rrugës interurbane kryesore Tiranë – Durrës dhe krijimi i një Bypass-i të ri në zonën e Vores që nderlidh rrugët SH2 dhe SH52
  - b. Zgjerimi i nën-kalimit për Shargë dhe Marqinet, si dhe zgjidhja e lëvizjes për zonat përtej hekurudhës
  - c. Projekti i lëvizjes së këmbësorëve dhe biçikletave në parkun që ndodhet krahas rrugës të mjeteve


#### **Neni 54 – Profili i rrugëve**

1. Profili i rrugëve që përcakton dhe gjërësinë e rrugëve që duhen ruajtur në kuadrin e Planit Rregullues përcaktohen në figurën e mëposhtme. Dimensionet e dhëna për seksionet që propozohen janë parashikuar me tolerancë, me qëllim që të lehtësohet menaxhimi i hapësirës për të përballuar ngarkesën e ardhshme të trafikut apo kërkesat e sistemit të transportit publik. Analiza dhe seksionet “tip” përfundimtare, të detyrueshme për zbatim, do të jepen nga projekti teknik i rrjetit rrugor.
2. Deri në përfundimin e projektit teknik të skemës së rrjetit rrugor aplikohet seksioni maksimal i parashikuar nga plani, sipas kategorisë së rrugës.
3. Klasifikimi i rrugëve (figura nr.2), si dhe seksionet tip të rrugëve (figura nr.3).






B<sub>1</sub> Projektimi i Stacionit Kryesorit  
TRUPI I PROJEKTIT 14.5m




B<sub>2</sub> Projektimi i Stacionit Kryesorit  
TRUPI I PROJEKTIT 17.5m




C<sub>1</sub> Projektimi i Stacionit Kryesorit  
TRUPI I PROJEKTIT 9m




C<sub>2</sub> Projektimi i Stacionit Kryesorit  
TRUPI I PROJEKTIT 10.5m



D<sub>1</sub> Projektimi i Stacionit Kryesorit  
TRUPI I PROJEKTIT 12m



D<sub>2</sub> Projektimi i Stacionit Kryesorit  
TRUPI I PROJEKTIT 10m



**F<sub>10</sub>** Njësitë e Nivelit të Dytësor  
TIRANË (RREGULLOJA 138)



**F<sub>11</sub>** Njësitë e Nivelit të Dytësor  
TIRANË (RREGULLOJA 138)



**F<sub>12</sub>** Njësitë e Nivelit të Dytësor  
TIRANË (RREGULLOJA 138)



**F<sub>13</sub>** Njësitë e Nivelit të Dytësor  
TIRANË (RREGULLOJA 138)



**F<sub>14</sub>** Njësitë e Nivelit të Dytësor  
TIRANË (RREGULLOJA 138)



**F<sub>15</sub>** Njësitë e Nivelit të Dytësor  
TIRANË (RREGULLOJA 138)








Figura 3  
Profilet tip të rrugëve

### Neni 55 – Përshkrimi i kryqëzimeve (ndërprerjeve) të rrugëve

1. Figura 4 ofron një panoramë të ndërprerjeve të rrugëve brenda rrjetit rrugor të propozuar. Tipologjia e kryqëzimeve (ndërprerjeve) ka si qëllim vetëm përcaktimin e hapësirave për t'u rezervuar, pra nuk përbën propozimin final për mënyrën e operimit të trafikut, gjë që duhet të përcaktohet në bazë të një studimi në nivel mikro-simulimesh për manaxhimin e trafikut.
2. Kryqezimet e rrjetit rrugor përcaktohen duke ju referuar figures në varesi të hierarkisë (Tipit nga A në F) nga të cilat është e qartë që kemi dy lloje kryqezimesh kryesore: në nivel (në rrafsh) dhe në disnivel. Duke ju referuar planit të levizjes për qytetin e Vorës si dhe në përputhje me rezultatet e modelimit dhe simulimeve të trafikut duhet të përcaktohen zgjidhjet për nyjet e kryqezimeve.
3. Realizimi i kryqezimeve të reja të rrjetit rrugor në rrafsh (në nivel) si dhe rikualifikimi i disa prej tyre, duhet të bazohet në kriteret projektuese të standartit dhe VKM përkatëse që lidhen me Kodin Rrugor. Kryqezimet në rrafsh karakterizohen nga rreze të ndryshme kthimi të formuara nga drejtime që kryqezohen me kënde të ndryshme nga ky rrjet që i kundërvihen hapësirave të gjera egzistuese në kryqezim. Në këto raste mund të lindin të paktën tre raste të mos përshtatshmerisë:
  - a. Levizje të pakontrolluara të automjeteve
  - b. Vendkalime të zgjatura të kembësoreve (sidomos në zonat urbane)
  - c. Zona të asfaltuara të përdorshme
4. Kryqezimi në nivel - është një zonë e përbashkët për disa rrugë, e organizuar në mënyrë të tillë që të lejojë zhvendosjen e rrymave të trafikut nga njëra rrugë të tjetra, siç paraqitet në figurën e mëposhtme (Me Kater dhe tre dege).






Figura 5:  
Kryqezim me  
kater dhe tre  
dege





Figura 6:  
Kryqezim 3  
rrugor





- Legjenda: Lidhja e skemes me klasifikimin e rrjetit rrugor sipas Kodit Rrugor
- Kategoria A ne skeme – korespondon me kategorine A – Autostrade; me kategorine B – Interurbane Kryesore dhe me kategorine D – Urbane Kryesore
- Kategoria B ne skeme – korespondon me kategorine B – Interurbane Kryesore; me kategorine D – Urbane Kryesore
- Kategoria C ne skeme – korespondon me kategorine C – Interurbane Dytesore; me kategorine E – Urbane Dytesore
- Kategoria D ne skeme – korespondon me kategorine E – Urbane Dytesore ; me kategorine F – Lokale
- Kategoria E ne skeme – korespondon me kategorine F – Lokale

Figura 4:  
Nderprerje te  
rrugeve brenda  
rrjetit rrugor te  
propozuar

5. Nderkohe qe kryqezimet me rrethrotullim - perfaqesojne nje nyje, e organizuar ne menyre te tille qe te lejoje zhvendosjen e rrymave te trafikut nga njera rruge te tjetra nepermjet rampave te vecanta, pa perzier rrymat e trafikut , sic paraqitet ne figuren e meposhtme.
6. Nderkohe qe kryqezimet ne disnivel - perfaqesojne nje nyje, e organizuar ne




Figura 7:  
Kryqezim me  
rrethrotullim






Figura 8:  
Kryqezim në diznivel

menyre te tille qe te lejoje zhvendosjen e rrymave te trafikut nga njera rruge te tjetra nepermjet rampave te vecanta, pa perzier rrymat e trafikut, sic paraqitet ne figuren e meposhtme.

### Neni 56 – Parkimet publike

- I. Baza ligjore ku sot bazohet kryesisht numri i vendeve të parkimit të nevojshme për çdo tip aktiviteti përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.686 datë 22/11/2017 në të cilin përcaktohet se:
  - a. Referuar nenit 81: Standardet dhe treguesit e planifikimit për zonat dhe njësitë strukturore të banimit të cilat ndryshojnë sipas numrit të popullsisë në territore urbane dhe kategorizohen, sipas rastit, për tri grupe kryesore:
    - i. deri në 10,000 banorë; 6 m<sup>2</sup> për banor
    - ii. mbi 10,000 banorë; 6 m<sup>2</sup> për banor
    - iii. mbi 100,000 banorë. 6 m<sup>2</sup> për banor
  - b. Referuar nenit 82: Përveç sa është parashikuar në neni 81, të kësaj rregulloreje,



standardi minimal i parkimit do jetë:

- i. Për parkimin publik, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, është 6 m<sup>2</sup>/banor ose 1 vend parkim prej 12 m<sup>2</sup> për çdo 2 banorë.
  - ii. Për hapësirën e parkimit të dedikuar për objekte me përdorim jo banim, është 12 m<sup>2</sup>/përdorues dhe llogaritet mbi bazën e fluksit mesatar deri në maksimal 24-orësh të përdoruesve të objektit.
  - iii. Për parkimin privat për objekte banimi, pavarësisht formës së zgjidhjes së tij, është 15 m<sup>2</sup>/familje ose apartament.
  - iv. Në të gjitha rastet të parashikohen vendparkime për personat me aftësi të kufizuar.
- c. Parkimi mund të jetë privat ose publik dhe format e zgjidhjes janë në rrugë, në sheshe publike, në sipërfaqe mbi ose nën tokë, në struktura me një ose disa nivele dhe në pjesë të objekteve me përdorime të ndryshme.
2. Përveç sa parashikohet në V.K.M më sipër, më poshtë po japim dhe disa referenca shtese lidhur me parkimin:

Aktiviteti	Numri i nevojshëm i vendeve të parkimit
Hotele	>1 vend për çdo 5 dhoma
Aktivitete tregtare	> qendra e qytetit: 1 vend për çdo 100m <sup>2</sup>
Aktivitete dhe Shërbime	> zona tregtare larg qendrës: 2 vende për çdo 100m <sup>2</sup>
Shkollat dhe arsimit:	>1 vend për çdo klasë

Në lidhje me Tabelen e mësipërme, duhet vënë në dukje se:

- a. Në rast përdorimi të kombinuar, kërkesa totale lidhet në mënyre proporcionale me secilin tip përdorimi.
- b. Kërkesat e dhëna më lart mund të rishikohen për të marrë parasysh objektivin politik për transportin, i cili parashikon uljen e kërkesës për vende parkimi në qytet nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të transportit publik dhe rritjes së numrit të vendeve të parkimit në periferinë urbane.

## Neni 57 – Përshkrimi i kryqëzimeve

### 1. Transportit publik



- a. Shërbimi i transportit qytetës të udhëtarëve në Bashkinë Vorë do të jetë i organizuar nga strukturat përkatëse të saj në përputhje me Ligjin Nr.8308. dt.18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", (i ndryshuar), Ligjit Nr.8378. dt.22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar) Ligjin Nr.7961.dt.12.07.1995."Kodi i Punës", (i ndryshuar), si dhe udhëzimeve të tjera të fushës së transportit që në thelb kanë disiplinimin e parametrave tekniko - ekonomik që operatorët duhet të plotësojnë në lidhje me kushtet e kryerjes së shërbimit.
- b. Qyteti i Vorës ka një shtrirje të vogël gjithësesi synon tashmë t'i rrisë mundësitë për transport publik sidomos në lidhjet me Tiranën, Vorëin dhe Aeroportin. Për këtë qëllim duhet të bëhen disa rregullime në infrastrukturën e ofruar për të siguruar një shërbimi transporti publik të shpeshtë, të shpejtë, të besueshëm dhe konfort:
  - i. Të përmirësohet infrastruktura e stacioneve të autobusëve me të gjithë elementët e nevojshëm për t'ju siguruar akses të gjithë përdoruesve si psh ulja e trotuarëve, vendosja e kabina, informimi i qytetarëve etj.
  - ii. Të përcaktohen korsi të veçanta për autobusë në rrugët kryesore dhe dytësore.
  - iii. Të vendosen sistemet e biletave elektronike në të gjitha linjat e transportit urban qytetës.
- c. Mjetet e shërbimit publik autobusë duhet të konsiderojnë:
  - i. Kondicionimi: 100 % i mjeteve të transportit.
  - ii. Mjetet duhet të jenë të pajisura me pajisje të veçanta për invalidët.
  - iii. Dyert e autobusëve të kenë të shkruar dukshëm brenda dhe jashtë autobusit hyrjet dhe daljet.
  - iv. Në autobusët të jenë caktuar dhe shënuar dukshëm numri i vendeve të ulura dhe numri maksimal i udhëtarëve që mund të transportojnë.
  - v. Të kenë ndriçim të brendshëm të korridoreve, në hyrje dhe dalje si dhe mbi sediljet, të komandueshme, funksionale dhe me sistem mbrojtje elektrike.

## 2. Lëvizja me Bicikleta

- a. Në lëvizjen me mjete alternative si një element i rëndësishëm për plotë-



simin e skemës së transportit multimodal është dhe lëvizja me bicikleta. Në të gjitha projektet që do të aplikohen nga Bashkia e Vorës është i rëndësishëm ndjekja e parimit të mëposhtëm në projektim :




Figura 9:  
Skema e  
projektimit të  
rrugës

Kjo mënyrë projektimi vjen si një zbatim i strategjisë së transportit multimodal në qytetin e Vorës dhe parashikon sistemimin e infrastrukturës sipas parimit të shpërndarjes së sipërfaqes të rrugës për cdo përdorues duke i dhënë prioritet shërbimit publik, lëvizjes me bicikleta dhe lëvizjes këmbësorëve.


- b. Në vijim po japim disa standarte që duhet të konsiderohen gjatë projektimit të korsive të bicikletava:
  - i. Gjerësitë e korsive variojnë duke patur parasysh dimensionet e bicikletës dhe balancës të përshtashme në lidhje me hapësirën e lirë dhe pengesat.
  - ii. Gjerësia e korsisë së bicikletës duhet të jetë 1.5 deri 1.8 m për një drejtim lëvizje
  - iii. Gjerësia e korsisë me dy drejtime (vajtje – ardhje) duhet të jetë minimumi 2.5 m
- c. Në raste të veçanta për të mundësuar zgjidhjen në mungesë të hapësirës




- i. Një korsi , për gjatësi të minimale mund të jetë deri 1 m
  - ii. Dy korsi, për gjatësi të minimale mund të jetë deri 2 m
  - iii. Rrezja e përdorimit duhet të jetë më e madhe se 5 m
- d. Korsitë e biçikletave duhet të ndahen qartësisht nga mënyrat e tjera të lëvizjes me anë të një brezi sigurie i cili ka një minimum prej 0.5m.
- e. Struktura e korsive të biçikletave
- i. Rugë me shtrese betoni te stampuar me ngjyrë të veçantë.
  - ii. Rugë me shtrese asfalti të stampuar me ngjyrë të veçantë.
  - iii. Rugë me pllaka betoni me ngjyre të veçantë.
- f. Shpejtësia e lëvizjes së bicikletës
- i. Çiklistët duhet të lëvizin (pedalojnë) me një shpejtësi prej 20-25 km/orë
  - ii. Dhe në korsi me pjerrësi prej 5% shpejtësia duhet të arrijë deri në 40 km/orë
- g. Sinjalistika e nevojshme dhe stacionet e qëndrimit:
- Për të drejtuar fluksi e çiklistëve do të përdoret:
- i. Sinjalikë horizontale e verdhe.
  - ii. Sinjalikë vertikale.
  - iii. Stacione qëndrimi komfort










KREU IX – SISTEMI MJEDISOR DHE PEIZAZHIK





## Neni 58 – Sistemet e kullimit të ujërave

1. Rregulla të përgjithshme për sistemet e kullimit të ujërave:
  - a. Nuk lejohet në asnjë rast që zhvillimet e reja publike apo private të çënojnë, ndikojnë apo t'i mbivendosen sistemeve të kullimit ekzistuese, në toka bujqësore, pranë rrugëve, etj. Në të gjitha rastet duhet të ruhet vazhdimësia e plotë e sistemeve të kullimit si dhe e të gjithë strukturës ekologjike përreth tyre.
  - b. Nuk lejohet që rrugët e reja apo rinovimi/përmirësimi i tyre, të çënojë sistemet ekzistuese të kullimit, përveç rasteve kur ndërhyrja për përmirësimin e infrastrukturës prek dhe vet infrastrukturës e sistemeve të kullimit.
  - c. Në çdo kohë, autoritetet vendore të inspektojnë gjëndjen ekzistuese të sistemeve të kullimit dhe të ndërhyjnë për zhvillimin e kanalizimeve të reja apo përmirësimin e atyre ekzistuese.
  - d. Autoritetet vendore në çdo ndërhyrje në sistemet e kullimit, të sigurojnë që përmirësimi të parashikojë edhe kryqëzime rrjetesh kanalizimi të hapura dhe të pasuruara me shtrat bimësie.
  - e. Autoritetet vendore të kontrollojnë rregullisht që shkarkimi i mbetjeve të mos kryhet në sistemet e kullimit, dhe të ndëshkojnë ligjërisht shkelësit e këtij kushti.
2. Rregulla për sistemet e kullimit në tokat bujqësore:
  - a. Nuk lejohet shkarkimi i ujërave të bardha në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në toka bujqësore. Shkarkimi i ujërave të bardha të bëhet vetëm në rrjetin e kanaleve të shkarkimit.
  - b. Për parcelat bujqësore në proces zhvillimi dhe zgjerimi të aktivitetit bujqësor, apo në parcelat ku do zhvillohet aktivitet bujqësor, të parashikohet sistem kullimi i cili është i aftë të akomodojë sasi shkarkimesh ( $m^3/s$ ) të njëjta apo më pak se sasi të kullimit përpara zhvillimit/zgjerimit të aktivitetit bujqësor në parcela.
3. Rrjeti i kanalizimeve përgjatë rrugëve:
  - a. Për rrugët e reja ose zhvillimin, rizhvillimin dhe përmirësimin e sistemit ekzistues rrugor, nuk lejohet shkarkimi i prurjeve të ujërave të shiut në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane dhe ujërat e shiut duhet të shkarkohen në rrjetin e kullimit të ujërave të bardha duke siguruar më parë largimin e vajrave dhe grasove.



I.2.5	Çatite, Ulluket e Çatave dhe Ulluket e Shkarkimit	<p>Te gjitha ndertesat qe kane nje fasade ne vazhdim me ndertesat fqinje ne te dyja krahet, do te kene çati me pjerrresi nga dy krahe (me dy faqe); nese njera ane e nderteses eshte e lire atehere çatia do te kete pjerrresi (faqe) edhe ne kete krah.</p> <p>Te gjitha ndertesat do te pajisen me ulluke çatie dhe ulluke shkarkimi per mbledhjen dhe largimin e ujrave te shiut.</p> <p>Perdorimi i Eternitit (asbestos cement) eshte i ndaluar! Daljet e çatave (strehat apo konsolat) ne ndertesat e reja nuk do te jene me pak se 0.30 m. Ulluket e çatave dhe ato te shkarkimit do te fiksohen ne oborret e brendshme dhe ne sipefaqet e tjera te hapura dhe do ta shkarkojne ujin ne kanalet e drenazhit. Nuk do te lejohet derdhja e ujit ne trotuar ose ne nivelin e rruges ose ne pronat publike; drenazhi do te lejohet vetem ne oborre te brendshme, kopshte, çisterna ose puseta te pershtatshme.</p> <p>Derdhja e çdo lloj uji tjetër pëveç ujrave të shiut në ulluket e çatave apo ato të shkarkimit është e ndaluar. Ulluket e shkarkimit do të shtrohen nën trotuare dhe do të derdhen në kanalet e drenazhit që i perkasin hapësirave publike ose hapësirave për përdorim publik.</p> <p>Do të instalohen puseta të pershtatshme inspektimi, në ato zona ku tubacion i drenazhit ka ndryshim të drejtimit të rrjedhës ose ku ka lidhje me tubacione të tjera drenazhi; një pusete përfundimtare inspektimi do të vendoset në fund të pronës, që do të bëjë lidhjen me sistemin publik të kanalizimeve të ujrave të bardha.</p>
-------	---	--





I.2.6	Parapetat dhe Parmaket (pengesat)	Parapetat dhe parmaket do te vendosen kudo ku ka rrezik rrezimi nga nje hapesire e larte pavaresisht nga menyra e perdorimit.
		Parapetat dhe parmaket e ballkoneve, verandave, etj., do te:
		- jene me te larte se 1 m nga dyshemeja per ndertesat deri ne 4 kate
		- jene me te larte se 1,1 m nga dyshemeja per ndertesat deri ne 8 kate
		- jene me te larte se 1,2 m nga dyshemeja per ndertesat mbi 8 kate
		- jene rezistente ndaj goditjeve
		Parmaket e shkalleve nuk lejohet te jene me te ulet se 0,9 m nga drejteza qe bashkon kendet e çdo kemb-shkalle ne prerje.
		Dhe nuk do te:
		- jene te shkallezuara
		- kene çarje ose hapesira me interval me shume se 0,10 m
		Per ndertimin e parapeteve dhe barrierave mund te perdoret çdo material, qe garanton fiksimin (lidhjen) ne strukturen horizontale.



I.2.7	Rrugekalimet e Kembesoreve dhe Trotuaret	<p>Brenda kufijve të qytetit, të gjitha rrugët e reja, dhe nëse është mundur edhe ato ekzistuese, do të kenë trotuare ose rrugë kalime publike për kembesoret, të ndërtuara në përputhje me Ligjin(et) për eliminimin e barrierave arkitektonike.</p>
		<p>Nëse trotuaret rreth ndërtesës, rrafsh me rrugën apo të ngritur, sigurohen nga pronaret e parcelës, ato do të ndërtohen në mënyrë të tillë që të përshatën materialeve dhe radhitjes së përcaktuar nga autoriteti vendor.</p>
		<p>Trotuaret dhe rrugekalimet e kembesoreve (si në paragrafin e parë) edhe nëse ndërtohen në pronë private, janë subjekt i lehtësimit të kalimit të publikut. Trotuaret e rinj nuk do të jenë më pak se 1.20 m në gjerësi, nuk do të kalojnë një diferencë lartësie prej 0,15 m dhe do të kenë një përrjesi jo më të madhe se 3%.</p>
		<p>Çdo diferencë lartësie që vjen si rezultat i punimeve lokale të ndërtimit, për shkak të nivelit të rrugës ose interseksioneve do të kapërcehet me rampa që nuk do të kalojnë përrjesinë maksimale prej 12%. Nëse vërehen kushte rreziku për shkak të ndërtimit ose për shkak të trafikut të autojeteve, atëherë autoritetet vendore kanë të drejtën të vendosin barriera (pengesa) në anët e trotuareve që të mos lejojnë kalimin e kembesoreve në këto vende por të drejtojnë ata në vend më të sigurt.</p>
		<p>Trotuaret e rinj do të përbehen nga materiale të ashpra rezistente ndaj rreshqitjes dhe frenimit; materiale të tjera rifiniturash mund të përdoren nga pronaret e veprimtarive tregtare që i japin rendësi trotuareve para pronës së tyre, vetëm me kushtin që materialet dhe veshjet të jenë të miratuar nga UPD.</p>
I.2.8	Ndërtimet e perkohshme	<p>Ndërtimet e perkohshme do të konsiderohen si ndërtesa shërbimi. Ato do të lejohen vetëm nëse i shërbejnë një ndërtese kryesore ekzistuese dhe nëse kjo ndërtese shërbimi bën pjesë në të njëjtën parcelë me atë ekzistuese. Ato duhet të përshatën në mënyrë harmonike me mjedisin përreth, si në lidhje me kerkesat e tyre formale ashtu edhe me materialet, sic mund të përcaktohet nga Bashkia e Vorës dhe nga PPV. Përdorimi i beton armësë, për ndërtimin e këtyre elementeve do të jetë rreptesisht i ndaluar, përveç rasteve kur nevojiten punime të vogla themeli.</p>



1.2.9	Rrethimi dhe Portat	<p>Murret rrethuese, ose gardhet me tela ose zinxhira dhe portat me pamje te plote apo te pjeshme nga hapesirat publike, do te jene ne perputhje me standartet e pergjithshme te ndertimit. Rrethimi nuk do te pengoje shikueshmerine apo te rrezikojte rrjedhen e sigurte te trafikut.</p> <p>Rrethimet e reja midis pronave me njera tjetren, ose midis pronave dhe hapesirave publike do te behen si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nje mur solid i mbuluar me shkurre me nje lartesi maksimale prej 1,6 m;</li> <li>- Nje mur i ulet ose nje gardh me nje lartesi maksimale prej 0,60 m i pasuar nga nje gardh vegetacioni me nje lartesi te pergjithshme prej jo me shume se 3,00 m.</li> <li>- Shkurre (bimesi) me nje lartesi maksimale prej 1,6 m;</li> <li>- Garadhe druri jo me te larte se 1,6 m;</li> <li>- Gardhe me hekur te perpunuar dhe dru, jo me te larte se 1,8 m.</li> </ul> <p>Gardhet dhe pengesat e lartesive te ndryshme do te lejohen gjithashtu me qellim qe te pershtaten me gardhet e tjera fqinje, per te ruajtur harmonine kompozicionale.</p> <p>Portat per kembesoret apo makinat perfshi edhe gardhet nuk do te kalojne lartesine prej 3 m dhe do te hapen nga brenda drejt prones (nga jashte prones vetem nese portat jane te vendosura ne thellesi dhe nuk pengojne kalimin ne trotuare apo rruge).</p> <p>Per zona specifike urbane do te vendosen kritere specifike.</p>
-------	---------------------	--



L.2.10	Sinjalistika Publike	<p>Bashkia e Vorës, mbasi te kete njoftuar pronarin(et), ka te drejten te aplikoje (vendose, instaloje) ose mirembaje pajisje informuese, sinjale dhe objekte te tjera per perfitim publik ne fasadat e ndertesave si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pllaka te toponimeve urbane dhe numra rruges apo adresash;</li> <li>- Tabela te vogla per tregime planimetrike dhe altimetrike dhe harta qe tregojne planimetrine rruges, hidrantet dhe gjera te ngjashme;</li> <li>- Pajisje dhe shenja sinjalizimi;</li> <li>- Shenja informacioni ne lidhje me transportin, kushtet e rruges dhe sherbimet publike;</li> </ul> <p>Struktura mbeshtetese per sistemet e sherbimeve publike me pllakate dhe pajisjet qe lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sahate dhe sinjale lajmerimi rrugor mbi ditën, datën, temperaturën kushtet e rruges etj</li> <li>- Pllakata memoriale;</li> </ul> <p>E çdo pajisje apo sistem tjetër qe te nevojshme dhe ne dobi te publikut.</p> <p>Mirembajtja e artikujve te permendur ne paragrafin e pare te ketij seksioni, si dhe e fasadave perkatese te tyre do te behet me shpenzimet ose te autoriteteve vendore ose te instaluesve private. Demet ne prone, mure, suvatime, etj, te rregullohen nga instaluesi, publik apo privat. Bashkia ka detyrimin te çdemtoje çdo demtim ne prone private apo publike te kryer nga nje instalim i kryer prej saj.</p> <p>Pronaret e tokes, pronaret e apartamenteve te veçanta, perdoruesit e prones nuk lejohet te heqin asnje nga artikujt e renditur ne paragrafin e pare te ketij seksioni, e as ti fshehin ato nga pamja e publikut dhe te riparojne me fondet e tyre nese ndonje nga keto artikuj demtohet per faj te tyre. Punimet e ndertimet ne ndertesat ku jane instaluar artikujt e renditur ne paragrafin e pare te ketij seksioni, do te kryhen duke garantuar te gjitha punimet e nevojshme per mirembajtjen e ketyre sherbimeve publike; dhe nese duhet qe keta artikuj te hiqen patjeter ne menyre qe te kryhen punimet, me pas ato duhet te rivendosen si duhet ne vend.</p>
--------	----------------------	---



I.2.11	Daljet fikse	<p>Daljet per elemente dekorative, kornizat, pragjet e dritareve, tendat, kulluesit dhe pengesat nga fasadat e ndertesave qe shikojne nga hapesirat publike ose nga hapesirat per perdorim publik do te jene te lejueshme.</p> <p>Ndertimi i ballkoneve dhe terracave ne fasadat qe shikojne nga hapesirat publike ose ne hapesirat per perperdorim publik eshte i ndaluar ne rastet kur keto hapesira kane siperfaqe te limituar dhe reniet e objekteve perbejne rrezik te larte per kalimtare (referuar rregulloreve te termeteve); ne rastin e fundit (hapesirat per perdorim publik) ndertimi i ballkoneve ne fasadat e mbrapme te ndertesave dhe/ose brenda strukturese se vet ndertesave eshte i lejuar.</p>
I.2.12	Rruget Private	<p>Ndertimi i rrugeve private do te jete subjekt i autorizimeve dhe procedurave te zakonshme (per ndertimine rrugeve) te kontrollit te rregulloreve ne fuqi.</p> <p>Autoritetet qeverisese (Bashkia) ose pronaret e rrugeve do te sigurojne:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shtrimin e rrugeve, nese Autoritetet e qytetit e shikojne te nevojshme;</li> <li>- mirembajtjen dhe pastrimin;</li> <li>- instalimin dhe mirembajtjen e sinjalistikes se kerkuar;</li> <li>- nje baze dhe siperfaqe efciente te rruges</li> <li>- ndertimin dhe mirembajtjen e tubacioneve te mbledhjes dhe largimit te ujrave te shiut derisa atote derdhen ne kanalizimet publike te qytetit;</li> <li>- ndricimin e rruges.</li> </ul>





I.3 Rregulloret Sanitare		
	Emri	Përshkrimi
I.3.1	Higjena e tokes dhe e ndertimit	Ndalohet ndertimi i godinave te reja ne nje toke qe me pare eshte perdorur si depozite per materiale te pashendetshme (plehra, plehra organike, mbeturina organike etj.) neqoftese kjo toke nuk i eshte nenshtuar bonifikimit.
		Gjykimi ne lidhje me punimet e bonifikimit (nese eshte kryer) do te behet nga autoriteti qeverises kompetent per ceshtjet e Sigurise dhe Shendetit, pasi jane grumbulluar me pare dokumentat dhe vleresimet teknike te nevojshme nga ana e aplikantit me shpenzimet e tij.
		Nese sheshi i ndertimit eshte i lagesht dhe/ose subjekt i infiltrimeve te ujrave nentokesore ose siperfaqesore, atehere kerkohet nje drenazh i pershtatshem e i mjaftueshem si dhe masa parandaluese per te menjanuar kalimin e lageshtise nga themelet ne mure dhe/ose ne strukturen me siper.
		Do te adoptohen zgjidhje konstruktive te pershtatshme per te menjanuar infiltrimin e ujit nga veprimi kapilar ne punimet e mureve qe jane pjeserisht nentoke ose hapësirat e bodrumeve. Ato do te mbrohen duke aplikuar siperfaqe te papershkueshme nga uji ose duke lenë te çara ne mur.
		Dyshemete nuk do te shtrohen direkt ne toke dhe ndertesa duhet te izohet nga toka me nje shtrese guresh e pas zhavorri (drenazhim Francez) me nje trashesi minimale prej 3,30 m e ventiluar nga te cara ventilimi.
		Zgjidhjet teknike te ndryshme nga ato qe jane theksuar ne kete seksion, mund te adoptohen me kusht qe, te merren parasysh te njejtat masa per mbrojtjen nga lageshtia dhe infiltrimi i ujit, sidomos ne rastet e ndertesave/pronesive ekzistuese.
		Soleta e dyshemse si per hapësira te banueshme dhe per ato te pabanueshme duhet te ngrihet mbi nivelin e ujit ose mbi nivelin maksimal te sistemit te kanalizimeve.
		Ndertimi i godinave te reja ne toke qe ka burime radioaktiviteti te demshem per shendetin e njeriut eshte i ndaluar. Perdorimi i materialeve me radioaktivitet te demshem per shendetin e njeriut eshte gjithashtu i ndaluar.
I.3.2	Gjeresia e Ndertesave	Ndertesat e reja nuk do te jene me te gjera se 16 m.





I.3.3	Gjeresia e hapësirave të banueshme	Ndërtimi i hapësirave të banueshme, duke përfshirë gjysem katet (mezzanine) ose loftet me një gjeresi prej më pak se 2 m, ose një sipërfaqe prej më pak se 8 m <sup>2</sup> (me tolerancë deri në 4 m <sup>2</sup> për ato sipërfaqe të përdorura ekskluzivisht për kuzhinë) ose një volum prej më pak se 21 m <sup>3</sup> , është i ndaluar.
I.3.4	Ndërtimi i Banjos	<p>Banjot duhet të jenë të pakten 120 cm të gjata dhe 90 cm të gjera. Dyshemeja duhet të jetë e mbuluar me material të papërshkueshëm nga uji dhe që lahet me lehtësi, po ashtu edhe muret deri në një lartësi prej të pakten 160 cm nga dyshemeja.</p> <p>Rekomandohet që banjot do të kenë një ventilim direkt nga jashtë në mënyrë që të sigurohet ndërrimi i vazhdueshëm i ajrit. Të gjitha banjot do të kenë një dritare xhami të operueshme me gjeresi jo më pak se 50 cm dhe me lartësi të barabartë me lartësinë e dritareve të dhomave të tjera të banesës dhe me një sipërfaqe prej jo më pak se 0,50 m<sup>2</sup>.</p> <p>Ndertesat e reja mund të kenë banjo pa dritare me kusht që gjatë ndërtimit të sigurohet një sistem i detyruar për ventilimin e ajrit. Për asnjë arsye banjot nuk duhet të kenë lidhje (hyrje) direkte me kuzhinën. Muret që ndajnë banjën nga dhomat e tjera nuk do të kenë më pak se 0,08 m trashësi.</p>
I.3.5	Dritaret	Çdo dhomë që përdoret si hapësirë banimi duhet të ketë të pakten një dritare, kasat e së cilës duhet të ndalojnë futjen e ujrave të shiut. Në ndërtimet e reja dhe në rinovimin e atyre ekzistuese, sipërfaqja e dritareve nuk do të jetë më pak se 1/8 e sipërfaqes së dyshemesë së dhomës. Për atiket (papafingot), sipërfaqja e dritareve do të jetë të pakten sa 1/10 e sipërfaqes së dyshemesë. Të gjitha sipërfaqet, pavarësisht nga lloji i ndertesës, duhet të marrin ajër dhe dritë direkt nga rruga dhe/ose nga oborri, përveç hyrjeve, korridoreve, të cilët shërbejnë si sipërfaqe hyrëse e qarkullimi midis banesave dhe nuk nevojiten të përputhen me keto klauzola.



I.3.6	Lartësitë e brendshme të ndërtesave	Sipas rregulloreve të tanishme, lartësia e brendshme e dhomave përcaktohet si distancë midis dyshemise së përfunduar dhe tavanit të përfunduar, e matur në metra (m) pingul me të dyja sipërfaqet. Në rast sesipërfaqja e tavanit nuk është e sheshtë por me trare matja do të bëhet nën trare.
		Nëse tavani është i pjerrët ose dhoma ka një tavan të komplikuar me disa lartësi, atëherë lartësia e brendshme do të matet konvencionalisht duke pjestuar vëllimin e dhomes me sipërfaqen neto të dyshemise, duke përjashtuar (distancat) pragjet midis dhomave dhe dyerve dhe pezuleve të dritareve deri në një thellesi maksimale prej 0,50 m.
		Lartësia minimale e brendshme e një banese duhet të jetë 2,70 m; për dhoma ndihmëse lartësia nuk do të jetë më pak se 2,40 m.
		Lartësi minimale më pak se sa ato të përshkuara në ligj do të lejohen në ndërtimet e reja vetëm nëse:
		– vendndodhja e ndërtesës së re është brenda një konteksti ndërtimi historikisht, artistikisht ose urban ku duhet të ruhet rradhëtja dhe orientimi që ekzistonte më parë.
		Per ndërtimet ekzistuese vetëm nëse:
		– projekti i ndërtimit ka të bëjë me rehabilitimin e ndërtesës;
		– projekti i ndërtimit, që mund të mos jetë rehabilitim i banesës, ka një vlerë të dukshme historike, artistike dhe/ose urbane ku duhet të ruhen karakteristikat origjinale.







I.4 Normat e Mbrojtjes ndaj Termeteve														
Emri	Përshkrimi													
I.4.1	Kategorite e Përdorimit të Ndertesave	Ndërtimet e reja duhet të kenë nivele të diferencuara mbrojtjeje nga termeti në varësi të rëndësise dhe përdorimit të tyre, si dhe të pasojave që mund të sjellë dëmtimi i tyre nga rënia e termetit.												
		Per këte arsye janë përcaktuar "kategoritë rëndësise" të ndryshme për ndërtesat, seciles prej të cilave është bashkëngjitur një faktor "I" i njohur si faktori i rëndësise.												
		Ky faktor amplifikon intensitetin e mbrojtjes sizmike të projektit kundrejt vleres që i jepet çdo ndërtese të zakonshme (ndaj aktivitetit sizmik). Ky faktor rëndësise aplikohet në mase të barabarta me normen e mbrojtjes sizmike që duhet të adoptohet për limitin e gjendjes së shkatërrimit (kolapsit), duke variuar sipas probabilitetit të ndodhjes të këtyre ngjarjeve.												
		<table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Ndërtesat</th> <th>Faktori i Rëndësise</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>I</td> <td>Ndërtesat, funksioni dhe rëndësia themelore e të cilave gjatë termetit është mbrojtja e qytetareve (siç janë spitale, bashkite, stacionet e zjarrfikeseve)</td> <td>1.4</td> </tr> <tr> <td>II</td> <td>Ndërtesa të rëndësishme në lidhje me pasojat që mund të ketë shkatërrimi i tyre në rast termeti (si shkolla, teatro)</td> <td>1.2</td> </tr> <tr> <td>III</td> <td>Ndërtesa të zakonshme që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Ndërtesat	Faktori i Rëndësise	I	Ndërtesat, funksioni dhe rëndësia themelore e të cilave gjatë termetit është mbrojtja e qytetareve (siç janë spitale, bashkite, stacionet e zjarrfikeseve)	1.4	II	Ndërtesa të rëndësishme në lidhje me pasojat që mund të ketë shkatërrimi i tyre në rast termeti (si shkolla, teatro)	1.2	III	Ndërtesa të zakonshme që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme	1
		Kategoria	Ndërtesat	Faktori i Rëndësise										
		I	Ndërtesat, funksioni dhe rëndësia themelore e të cilave gjatë termetit është mbrojtja e qytetareve (siç janë spitale, bashkite, stacionet e zjarrfikeseve)	1.4										
		II	Ndërtesa të rëndësishme në lidhje me pasojat që mund të ketë shkatërrimi i tyre në rast termeti (si shkolla, teatro)	1.2										
III	Ndërtesa të zakonshme që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme	1												
<i>Tabela 1: Faktori i Rëndësise për banesat në lidhje me mbrojtjen sizmike</i>														
Klasifikimi i sipërpermendur do të merret në konsideratë gjatë përgatitjes së Planit për Gadishmerine ndaj Emergjencave.														





I.4.2	Ndertimi i Banesave te Reja	Eshte e ndaluar te ndertoet ne cepa shkembor, ne terrene me soliditet te dobet dhe me konsistence heterogjene, ne terrene te gerryera ose ne ato qe jane subject i rreshqitjeve te dheut ose ne shpate te pjerrta.	
		Lartesia maksimale e ndertesave te reja.	
		Lartesia H e ndertesave te reja tregohet ne tabelen e meposhteme:	
		Lloji I struktures	Lartesia maksimale (m)
		Ndertesat me strukture betoni	Sipas percaktimeve ne rregullore
		Ndertesat me kornize strukture celiku	Sipas percaktimeve ne rregullore
		Ndertesat e strukture te perzier betoni dhe kornize celiku	Sipas percaktimeve ne rregullore
		Ndertesat me strukture mur tulle	7.5
		Ndertesat me strukture mur tulle te armuar	13
		Ndertesat me strukture druri	7
		<i>Tabela 2: lartesia maksimale per ndertesat e reja</i>	
		Ne rast se ndertesat kane qilare ose bodrume, diferenca midis çatise dhe fundit te themeleve (te matura ne te njejten vertikale) nuk duhet te jete me e madhe se 4 m nga kufijte e lartesis se percaktuar ne Tabelen 2.	
		Nese ka lartesi te ndryshme çatie (pjerresi te ndryshme), lartesia maksimale do te llogaritet nga pjerresia me e larte.	
		Ne terrenet dhe rruget e pjerrta, lartesia maksimale nga tabela e meparshme mund te rritet me 1,50 m me kusht qe mesatarja e te gjitha lartesisve fasades te jete brenda kufijve te te njejtes table. Per ndertesat me skelet druri, ndertimi me llaç çimento, beton ose beton arme, lejohet per themelet por jo me shume se per 4 m lartesi. Ne kete rast, kufijte e lartesis se percaktuar ne tabelen e meparshme 2 do ti referohen vetem struktures prej druri.	
Kufizimi i lartesis se ne lidhje gjeresine e rruges			
Lartesia e ndertesave te reja qe shikojne nga rruget nuk do ti kaloje kufijte e meposhtem:			
Per rruge me gjeresi W<11m	H ≤ W		
Per rruge me me gjeresi W>11m	H = 11 3*(W - 11)		





<p>1.4.2</p>	<p>Ndertimi i Banesave te Reja</p>	<p>Gjeresia <math>\bar{E}</math> eshte distanca e llogaritur nga konturi i ndertesës e deri ne cepin perballë te rruges, duke perfshire edhe rrugen.</p> <p>Per sa u tha me siper, termat do te perkufizohen si me poshte:</p> <p>a. Si lartesi e ndertesës do te kuptohet diferenca maksimale e lartesisë midis siperfaqes me te larte te çatise dhe tokes, ose me mire rrafshit te rruges ose trotuarit.</p> <p>b. Rruga do te thote siperfaqja per perdorim publik qe perdoret per qarkullimin e kembesoreve dhe automjeteve, siperfaqe ku nuk mund te ndertohet, e hapur, e parrethuar e lire per kembesoret (trotuaret).</p> <div data-bbox="750 739 1244 1153" data-label="Diagram"> <p style="text-align: center;"> <math>W</math>  <math>H</math>  <math>W \leq 11</math>  <math>H \leq W</math>  <math>W &gt; 11</math>  <math>H = 11 + 3(W - 11)</math> </p> </div> <p><i>Figura 2: Limitet e lartesisë lidhur me gjeresinë e rruges</i></p> <p>Nese nje ndertese ne qoshe shikon nga rruge me gjeresi te ndryshme, lartesia e fasades qe bie ne rrugen me te ngushte do te jete e barabarte me lartesine e lejuar per rrugen me te gjere me nje gjatesi qe fillon nga qoshi i rruges, te barabarte me gjatesine e rruges nga fasada shesh.</p> <p><b>Distancat midis ndertesave</b></p> <p>Dy ndertesave mund te prekin njera-tjetren vetem ne ato raste kur arrihet uniteti (harmonia) totale e struktures.</p> <p>Distanca midis dy ndertesave fqinje nuk do te jete me pak se shumica e perhapjes (zhvendosjes) maksimale te rrenojave nga shkaterrimi i tyre, e llogaritur kjo per secilen ndertese, sipas metodave te llogaritjes per secilin tip strukturor te tyre.</p> <p>Distanca inferiore lejohen vetem ne ato raste kur ndertesat e grupuara formojne (perbejne) skema te planifikimit te qytetit te parashikuara nga plani rregullator me ndryshime plani-volumetrike.</p>
--------------	------------------------------------	--





I.4.3	Karakteristikat e Pergjithshme te Ndertesave	<p><b>Rregullsia</b></p> <p>Ndertesat duhet te kene sa me shume qe te jete e mundur karakteristika te thjeshtesise, simetrisje, hiperstatikes dhe rregullsise, kjo e fundit e perkufizohet duke u bazuar ne kriteret e meposhtme. Ne funksion te rregullsise se nje ndertese do te gjenden zgjidhje te ndryshme persa i perket metodes se analizave dhe parametrave te tjere te projektit.</p> <p>E rregullt quhet nje ndertese e cila i ploteson kerkesat e rregullsise si ne plan edhe ne lartesi.</p> <p>Nje ndertese eshte e rregullt ne plan nese plotesohen te gjitha kushtet e meposhteme:</p> <p>a) konfigurimi i planimetrisje eshte kompakt dhe afersisht simetrik me te dy drejtimet ortogonale persa i perket shperndarjes se mases dhe ngurtesise (rigidity);</p> <p>b) raporti midis faqeve te drejtkendeshit brenda te cilit eshte skalitur ndertesa do te jete me pak se 4;</p> <p>c) hyrjet apo daljet (konsolat) nuk do t'i kalojne 25% te madhesisje totale qe ndertesa ka ne drejtimin e daljes apo futjes;</p> <div data-bbox="710 1041 1284 1388" data-label="Diagram"> <p style="text-align: center;"> <math>a_1 + a_2 + a_3 &lt; 25\% a</math>  <math>b_1 + b_2 + b_3 &lt; 25\% b</math> </p> </div> <p><i>Figura 3: Hyrjet dhe daljet nuk do te kalojne 25% te madhesisje se nderteses ne drejtim te hyrjes ose daljes.</i></p> <p>d) strukturat e dyshemese do te konsiderohet pafundesisht te ngurta ne planin e tyre, ne lidhje meelementet vertikale.</p> <p>Nje ndertese eshte rregullt ne ngritje (lartesi) nese plotesohen te gjitha kushtet e meposhteme:</p> <p>e) te gjitha sistemet e rezistences vertikale te nderteses (sic jane kornizat dhe muret) e pershkojne te gjitha lartesine e nderteses;</p> <p>f) masa dhe fortesia (ngurtesia) qendrojne konstante ose ndryshojne gradualisht, pa variacione te menjehershme, nga baza e deri ne maje te nderteses (ndryshimet nga njeri kat ne tjetrin nuk do ta kalojne 20%);</p>
-------	--	---



I.4.3	Karakteristikat e Pergjithshme te Ndertesave	<p>g) raporti midis rezistences aktuale dhe te llogaritur nuk duhet te jete shume i ndryshem midis katevete ndryshme (norma midis 0.85 -1.15);</p> <p>h) ngushtimi i seksionit te ndertesave do te behet gradualisht nese plotesohen kushtet e meposhtme: ne çdo kat futjet nuk do ta kalojne 30% te permasave korresponduese te katit te pare dhe as 10% te permasave korresponduese te katit menjehere me poshte.</p> <p>Mbulimi (çatia) duhet te ndertohej ne menyre te tille qe te evitohen shtytjet horizontale. Te gjitha ndertesat shume-kateshe duhet te realizohen me kollona beton armeje ne muret perimetrike dhe ne te gjitha muret mbajtese te secilit kat.</p> <p>Per gjithçka qe i perket specifikimeve teknike te ndertimit, permasave te elementeve strukturore, si dhe verifikimeve statike dhe dinamike, referojuni Eurocode 8 "projektimi i strukturave per rezistence ndaj termetit".</p> <p><b>6.3.2 Elementet qe dalin nga fasadat dhe bien mbi pronat publike</b></p> <p>Ballkonet dhe terracat do te lejohen vetem ne pjesen e mbrapme te ndertesave, dmth nuk duhet te bien (shohin) mbi rruge apo siperfaqe te tjera publike.</p> <p>Ballkonet e çdo forme apo madhesie qe shikojne mbi siperfaqet publike ose rrugekalimet (rruge apotrotuare) qe kane gjeresi me te vogel se 10 m, jane gjithsesi te ndaluara.</p> <p><b>Elementet Pezull</b></p> <p>Elementet vertikale si oxhaket, parmaket etj duhet te sigurohen (fiksohen) sic duhet ne strukturen mbajtese te ndertesave dhe te jene rezistent ndaj aktiviteteve sizmike.</p> <p><b>Elementet jo-strukturore</b></p> <p>Te gjitha elementet qe nuk kane funksion strukturor, por qe shkaterrimi i te cilave mund te shkaktoje dëme ne njerez, do te verifikohen per aktivitet sizmik, duke perfshire ketu edhe lidhjet (fiksime) e tyre me strukturen. Efekti i aktivitetit sizmik duhet te vleresohet duke llogaritur nje force qe aplikohet ne qendren e rendeses se elementit jo-strukturor.</p> <p><b>Bashkimet Sizmike</b></p> <p>Goditjet midis strukturave bashkuese duhet te menjanohen duke krijuar bashkime (joints) me nje madhesi jo me pak se shuma e zhvendosjeve te pritshme, sic parashikohet nga verifikimi i gjendjes limit (parakolapsit) te vete ndertesave, te llogaritur sipas Eurocode 8. Zhvendosja maksimale e ndonje ndertesave ekzistuese fqinje mund te llogaritet me 1/100 e lartesis se ndertesave.</p>
-------	--	--





I.4.4	Ndertesat Ekzistuese	Ndertesat ekzistuese dallohen nga ato te rejat nga aspektet e meposhteme:
		- Projekti reflekton njohurite ndertimore per kohen kur eshte kryer ky ndertim.
		- Projekti mund te kete difekte te planifikimit konceptual dhe ndertimit qe nuk vihen re menjehere.
		Keto ndertime mund te kene qene subjekt i termeteve ose ngjarjeve te ngjashme ne te kaluaren, por demet nuk jane te dukshme.
		Per pasoje, vleresimi i kushteve te sigurise dhe projekti i mundshem per te nderhyre ndikohen nga nje shkalle paqartesishte te ndryshme nga ajo e nderesave e ndertuara rishtas. Kjo nenkupton perdorimin e koeficienteve pjesore te sigurise, qe modifikohen sic duhet, si dhe analiza te pershtashme dhe metoda testimi te bazuara ne permbushjen dhe besueshmerine e informacionit ne dispozicion.
		Zbatimi i vleresimeve te sigurise sizmike dhe kryerja e modifikimeve korrigjuese eshte i detyrueshem perketo qe ka ndermend:
		a) te ngreje ose zgjeroje ndertesen (zgjerimi i referohet ngritjes se pjeseve me te ulta te nderteses deri ne kufirin maksimal te lartesishte se vete nderteses);
		b) te ndryshoje destinacionin e perdorimit te nderteses qe do te thote rritje te ngarkeses (te perhershme apo te rastesisshme) ne krahasim me ate me pare me me shume se 20%;
		c) te kryeje ndryshime strukture qe me ane te nje serie punimesh sistematike duan ta transformojne ndertesen duke sjelle nje sistem ndertimi te ndryshem nga ai i pari;
		d) te kryeje ndryshime strukture duke implementuar punime dhe modifikime, ndryshime dhe zevendesime te pjeseve strukture te nderteses, kur keto nenkuptojne ndryshime thelbesore ne krejt aftesine mbajtese te vete nderteses.
Si lartesimet, ashtu edhe ndryshimet qe shkaktojne rritjen e numrit te kateve jane te pranueshme vetem kur ato jane pajtueshme me gjeresine e rruges nga e cila shohin. Nje ndryshim lartesishte eshte i pranueshem edhe pa qene ne perputhje me rregullat 2.1 & 2.2 vetem nese eshte i nevojshem per ta kthyer nje dhome te pabanueshme ne te banueshme, ne perputhje me rregulloret e ndertimit por duke mos ndryshuar numrin e kateve.		



I.4.4	Ndertesat Ekzistuese	Ndryshime strukturore ne elemete te veçante te ndertesese ose permiresime, qe do te thote implementime te ndonje punimi te pershtatshem per ti dhene ndertesese nje shkalle me te larte sigurie ndaj aktiviteteteve sizmike, jane te lejuara edhe pa kryer analiza dhe verifikime te ketij kapitulli, me kusht qe te demonstrohet qe keto punime te planifikuara i japin ndertesese nje shkalle me te larte sigurie ndaj aktiviteteteve sizmike.
-------	----------------------	--







SHTOJCA 2






Fig.1 Sipërfaqe relieve.




Fig.2 Vendkalimi i këmbësorëve në vendin me lartësi më të vogël të trotuarit.



Përmbledhje e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar" miratuar me VENDIM Nr.1503, datë 19.11.2008



#### Neni 5 - Zonat për zhvillim

Zonat e destinuar për zhvillim publik për të cilat kryet studimi i fisibilitetit-paraprojekti, zgjidhen duke preferuar, ato që sigurojnë projektimin e ndërtesave dhe hapësirave pa barriera arkitektonike.

#### Neni 6 - Hapësirat për këmbësorët

Projektet që i përkasin hapësirave publike dhe veprave të urbanizimit me qëllimin e vetëm për t'u përdorur nga këmbësorët, duhet të parashikojnë të paktën një rrugë hyrëse që të lejojë përdorimin e impianteve ngritëse aty ku është e nevojshme, përdorimin e shërbimeve sociale dhe shfrytëzimin e ambienteve nga personat me aftësi të kufizuara. Rrugët në hapësirat e jashtme, që të çojnë tek hyrja e ndërtesave, duhet të paktën një prej tyre të parashikohet me karakteristikat që lejojnë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara ose paaftësi lëvizëse dhe t'u garantojë atyre përdorimin e pajisjeve, të parkimeve dhe të shërbimeve të vendosura jashtë ndërmesës.



Rrugët duhet të sigurojnë një ecje sa më të rehatshme dhe të lehtë për në hyrje të ndërtesës pa ngushëtim, pajisje, pengesa të natyrave të ndryshme të cilat zvogëlojnë gjerësinë e kalimit ose që mund t'i shkaktojnë dëmtime fizike përdoruesit të karrigës me rrota. Madhësia e tyre duhet të garantojë lëvizshmërinë dhe në pika jo shumë të largëta midis tyre edhe ndërrimin e drejtimit nga ana e një personi në karrige me rrota.

Kur një vendkalim për këmbësorët është pranë me zonat e pa shtruara, është e nevojshme të parashikohet krijimi i një rrethi me material të përshtatshëm që të sigurojë perceptimin e menjëhershëm vizual dhe përdorimin e akustikës për personat që ecin me shkop.

Ndryshimet e mundshme të nivelit të rrugëve duhen zbotur me një pjerrësi të lehtë ose të bëhet i mundur kalimi me anë të platformave të pjerrëta duke i realizuar me ndryshime ngjyrash për t'i dalluar. Në veçanti, kur vendkalimi i këmbësorëve njëtrajtësohet me nivelin e rrugës ose ndërpritet nga një kalim i rezervuar, duhet realizuar platforma me pjerrësi që të bëjë të mundur kalimin e një karrigeje me rrota.

Kryqëzimet midis vendkalimeve të këmbësorëve dhe zonave të rezervuara të kalimit duhet të jenë të sinjalizuara edhe për personat e verbër dhe me shikim të kufizuar.

- Vendkalimet për këmbësorët duhet të kenë një gjerësi minimale prej 90 cm, për të lejuar ndryshimin e drejtimit të lëvizjes nga ana personave në karrige me rrota dhe të kenë zgjerime në të njëjtin plan, çdo 10 metra gjatësi.
- Çdo ndërrim drejtimi për gjatë rrugës së drejtë duhet të bëhet në të njëjtin rrafsh.
- Aty ku është e nevojshme marrja e këthesave 90° në drejtim të lëvizjes, vendi duhet të jetë me gjerësi të paktën 170 cm duke filluar nga pika më e jashtme, në të njëjtin plan dhe pa ndërprerje.
- Aty ku është e nevojshme të parashikohet një rreth, ky duhet të jetë i ngritur me 10 cm nga toka i realizuar me një material dhe ngjyrë ndryshe nga shtrimi i rrugës, të mos jetë me kënde të theksuara dhe të ndërpritet të paktën në çdo 10 metra nga kalime për në vendet ngjitur të pashtuara.
- Pjerrësia gjatësore nuk duhet t'i kalojë të 5%. Nëse nuk është e mundur, lejohen pjerrësi me të mëdha, me kusht që të jenë në përputhje me sa parashikohet në pikën 2.11 të këtij neni.
- Në rrugët me pjerrësi të 5% është e nevojshme vendosja e një shesh qëndrimi horizontal, me një hapësirë prej të paktën 150 cm, çdo 15 metra në gjatësi të rrugës. Për pjerrësi më të mëdha gjatësia duhet të zvogëlohet proporcionalisht deri në 10 metra për një pjerrësi 8%.




Fig.3  
Vendkalimi i këmbësorëve jashtë udhëkryqit. Vija e udhëheqëse.




Fig.4 Ishulli për këmbësorë në nivel me sipërfaqen e rrugës.



Fig.5 Ishulli për këmbësorë.

- Pjerrësia maksimale e tërthortë e lejueshme është 1%.
- Në prani të kundër-pjerrësisë në fund të një rruge të pjerrët ose të një bashkimi midis kësaj rruge dhe nivelit rrugor, shuma e të dy pjerrësive lidhur me planin horizontal duhet të jetë më e vogël se 22%.
- Disniveeli optimal mes rrafshit rrugor dhe rrafshit të terrenit ose të vendeve të rezervuara ngjitur me to është 2.5 cm.
- Kur trotuari bashkohet me nivelin rrugor ose ndërpritet nga një zonë e rezervuar, lejohen platforma të shkurtra me pjerrësi jo më të madhe se 15% për një disniveel maksimal prej 15 cm.
- Deri në një lartësi minimale prej 210 cm nga toka, nuk duhet të ekzistojnë pengesa të asnjë lloji, si tabela sinjalistike ose elementë të dalë nga ndërtesa, që mund të jenë shkak për aksidente për një person në lëvizje.

Ishulli i këmbësorëve duhet të mundësoj përmbytjen e këtyre kushteve:

- në rastet kur ishulli i këmbësorëve ndodhet në nivel me rrugën ose nivelin e tyre në vendkalim bëhet i njëjtë me nivelin e rrugës, atëherë 15 cm nga fillimi dhe 15 cm nga fundi shënohet vija relievore paralajmëruese me gravurë normal në drejtim të lëvizjes, me gjerësi jo më e vogël se 40 cm, sipas paraqitjes në fig. 38 të shtojcës B të kësaj rregulloreje;
- në raste kur ishulli i këmbësorëve është i ngritur në krahasim me nivelin e rrugës, kalimi nga rruga në ishullin e këmbësorëve realizohet me pjerrësi sipas fig. 5.

Udhëkryqi i cili ndodhet në zonat e vendbanimeve ku banojnë persona që nuk shikojnë ose me shikim të dobësuar, vendkalimi për këmbësor duhet të ketë semaforin e përshtatur me sinjalizim zanor dhe vijat relievore drejtuese. Vija relievore paralajmëruese realizohet deri të skaji i pjerrtësisë së kalimit në gjatësi jo më të vogël se 110 cm.

-Kur në udhëkryq nuk mund të evitohen pengesat në nivel të njëjtë, realizohen nënkallime ose mbikalime me aplikimin e elementeve përshtatës për arritjen në nivele me lartësi të ndryshme.



#### Neni 7 - Trotuaret

1. Për vendkalimet e këmbësorëve ngjitur me hapsirat e rezervuara për automjetet, shtrimi i rrugëve për këmbësorët duhet të kryhet me material kundër rrëshqitës (fig. 1).

Ndryshimet e mundshme të nivelit midis elementeve që përbëjnë një shtrim rruge, duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të mos përbëjnë pengesë për kalimin e personit në karrige me rrota. Për shtrimin e tyre përdoren sipërfaqet relievore të realizuara me relief në lartësi deri në 5 mm në mënyrë që të mos vështirësoj lëvizjen e personave në karrige me rrota, të jetë e ndjeshme me preken e shpatës së këmbës ose me shkop, të mos bëhet vatër për qëndrimin e ujit, borës, mbeturinave dhe të ketë mundësi mirëmbajtje pa vështirësi.

Grilat që përdoren në sipërfaqet e ecjes duhet të kenë boshllëqe që të mos krijojnë pengesa ose rreziqe për rrotat, shkopinjtë mbajtës.

*Dyshemetë*, disnivelet e mundshme të tyre nuk duhet t'i kalojnë 2.5 cm. Aty ku janë parashikuar shtrime të rrugëve kundër rrëshqitjes, realizohen me materiale koeficienti i fërkimit i të cilëve është më i lartë se:

- 0.40 për elementin rrëshqitës lëkurë në shtresë të thatë;
- 0.40 për elementin rrëshqitës gomë e fortë standarde në shtresë të lagur.

Vlerat e fërkimit të lartpërmendur nuk duhet të ndryshojnë nga vendosja e shtresave lustruese të shtresës së fundit ose të mbrojtjes të cilat nëse vendosen duhet të aplikohen para provës. Hipotezat e kushteve të asfaltimit (e thatë ose e lagur) duhet të merren në bazë të kushteve normale klimatike të zonës ku do të zbatohet.

Shtresat mbajtëse të shtrimit duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur për një kohë të gjatë shtrimin dhe mbingarkesën e parashikuar, përveç sigurimit të bllokimit të qëndrueshëm të elementeve përbërës të vetë shtrimit. Elementet përbërës të një shtrimi duhet të kenë njëzime më të vogla se 5mm, të realizuar me material të qëndrueshëm, të jenë të rrafshët me një trashësi të dukshme jo më






Fig.6  
Udhëkryqi.




Fig.7 Rampa.

të vogël se 2 mm. Hekurat e futura në shtrim duhet të jenë realizuar me hallka të papërshkueshme nga një sferë me diametër prej 2 cm; hekurat me elemente paralele duhet gjithashtu të vendosen me elemente drejtkëndore në drejtim të lëvizjes. Vlejnë karakteristikat e shtrimit dhe të bashkimit të dyshemeve të trotuarit me hapësirat e rezervuara për makinat.

2. Disniveli, mes sipërfaqes së trotuarit dhe rrugëve pranë tyre nuk duhet të kalojë 5 cm.

3. Gjerësia e trotuareve të realizuar në ndërhyrjet e reja të urbanizmit duhet të jetë e tillë, që të mundësojë shfrytëzimin dhe nga ana e personave në karrige me rrota, duke patur parasysh edhe pengesat e krijuara nga shtyllat e ndriçimit publik, sinjalistika rrugore dhe nga çdo element tjetër që mund të zvogëlojë gjërësinë e përshkueshme të tyre, jo më pak se 1.2 m.

#### Neni 8 - Vendkalimet për këmbësorët

1. Në rrugët me fluks të lartë trafiku, vendkalimet për këmbësorë duhet të jenë të ndriçuara në orët e errësirës ose të rënies së fluksit të dritës në atë të lejuar.

2. Fundi i rrugës, në afërsi të vendkalimeve për këmbësorët, bëhet i dallueshëm nëpërmjet ashpërsimit të krijuar mbi sipërfaqen e rrugës, pengesave të vendosura mbi rrugë me qëllim sinjalizimin e domosdoshmërisë për uljen e shpejtësisë.

3. Paltformat e shpëtimin duhet të jenë të arritshme për personat në karrige me rrota.

4. Semaforët, të instaluar rrishtas ose që janë zëvendësuar, duhet të jenë të pajisur me lajmërues akustik, që sinjalizojnë kohën kur kalimi është i lirë, për personat që nuk shohin edhe për ata që lëvizin ngadalë, aty ku është e nevojshme me komanda manuale të arritshme për të lejuar kohën e mjaftueshme për kalimin e rrugës.



#### Neni 10 - Shërbimet publike higjienike

1. Shërbimet higjienike duhet të garantojnë, nëpërmjet hapësirave të llogaritura, manovrimet e nevojshme të një karrigeje me rrota, për përdorimin e pajisjeve sanitare, në veçanti:

- hapësira e nevojshme për afrimin anësor të karriges me rrota të WC-ja, bideja, dushi, vaska dhe lavatriçja;
- hapësira e nevojshme për afrimin ballor të karriges me rrota të lavamanit, i cili duhet të jetë i llojit të futur;
- vendosja e një mbajtëseje të përshtatshme dhe e një zileje emergjence e vendosur afër WC-së dhe vaskës.

Përparësi kanë rubinetat me levë, dhe ku parashikohet furnizim me ujë të ngrohtë përzierësit, termostatikë dhe dýer rrëshqitëse ose atyre që hapen për nga jashtë sipas standarteve të dhëna në rregullore.

Shërbimet higjienike duhet të garantojnë manovrimin dhe përdorimin e pajisjeve të personave me aftësi të kufizuara motorike, duhet të parashikojnë në lidhje me hapësirat e manovrimit, afrim anësor të WC-ja, bideja, vaska, dushi, lavatriçja dhe afrim ballor të lavamanit. Kështu duhen respektuar përmasat minimale të mëposhtme:

- Hapësira e nevojshme e afrimit dhe e lëvizjes anësore e karriges me rrota të WC-ja dhe bideja, nëse është e parashikuar, duhet të jenë minimumi 100 cm, e matur nga boshti i pajisjes sanitare
- Hapësira e nevojshme e afrimit anësor e karriges me rrota të vaska, duhet të jetë minimumi 140 cm përgjatë vaskës me një thellësi minimumi 90 cm;
- Hapësira e lirë për lëvizjen me karrocë për PAK duhet të jetë me sipërfaqe rrethore me diametër të paktën 150 cm






Fig.8  
Vendparkimi,




Fig.9  
Vendparkim  
me hapësirë të  
ndërmjetme.



- Hapësira e nevojshme e afrimit ballor e karriges me rrota të lavamanit, duhet të jetë minimumi 80 cm e matur nga ana e përparme e lavamanit. Për sa i përket karakteristikave të pajisjeve sanitare përveç të tjerash lavamanët duhet ta kenë pjesën e sipërme të vendosur në 80 cm nga dyshemeja dhe të jenë pa kolonë me sfidon mundësisht gjysmë të mbyllur ose të futura në mur;
- WC-të dhe bidetë të jenë të tipit të varura, në mënyrë të veçantë boshti i WC-së ose i bidesë duhet të vendoset në një distancë minimale 40 cm nga muri anësor, pjesa e përparme duhet të jetë më e madhe se 65 cm nga muri mbrapa dhe pjesa e sipërme duhet të jetë 45-50 cm nga dyshemeja. Në rast se aksi i WC-së ose i bidesë është më shumë se 40 cm largë nga muri, duhet parashikuar një halkë ose parruk për të lejuar lëvizjen në një distancë 40 cm nga aksi i pajisjes sanitare. Paisja e lëshimit të ujit në WC të vendoset në lartësinë prej 70 cm mbi sipërfaqen e dyshemesë;
- Dushi duhet të vendoset poshtë, i paisur me një karrige që ulet dhe ngrihet dhe me telefonin e dushit;
- Varsja e robave duhet të vendoset në lartësinë prej 120 cm nga dyshemeja;
- Të gjitha paisjet duhet të kenë kontrast të theksuar në ngjyrë nga dyshemeja dhe muret;
- Instalim i mekanizmit të hapjes së derës nga jashtë në rast dhënie të ndihmës së shpejtë;
- Instalim i sistemit të alarmit brenda banjës për t'u përdorur nga PAK në raste nevojë.



Në hanesat e arritshme të banuara, të dhënat në nenin 3 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje, përveç të tjerash, duhen vendosur paisje me halka dhe parrukë horizontale dhe/ose vertikale pranë pajisjeve. Në shërbimet higjienike të vendeve publike është e nevojshme instalimi i parrukëve pranë WC-ve, të vendosur me një lartësi prej 80 cm nga dyshemeja dhe me diametër baras me 3-4 cm; nëse është i fiksuar në mur duhet vendosur 5 cm larg nga vetë ai.

Në rastin e përshtatshmërisë lejohej heqja e bideve dhe zëvendësimi i vaskës me një dush të vendosur poshtë, me qëllim që të përfitohet një hapësirë anësore për afrimin të WC-ja dhe për të përcaktuar hapësirat e nevojshme të manovrimit.

Në hanesat e ndërtesave rezidenciale, në të cilat është parashikuar kërkesa e mundësisë së shfrytëzimit, shërbimi higjienik do të quhet i arritshëm nëse do të mundësohet të paktën arrija e një WC-je dhe e një lavamani nga ana e personit në karrige me rrota. Me arrije të pajisjeve sanitare kuptohet mundësia për të arritur deri atëherë saj edhe pa afrimin anësor për WC-në dhe afrimin ballor për lavamanin.

Duhet të parashikohet mundësia e mbërritjes në të paktën të një aparat banjë dhe lavamani, për çdo grup shërbimesh publike.

2. Tabelat dhe pajisjet sinjalizuese të shërbimeve publike duhet të jenë të instaluar në pozicion të tillë që të shihen dhe të lexohen lehtësisht.

3. Tabelat dhe pajisjet sinjalizuese, dhe strukturat mbajtëse të linjave elektrike, telefonike, instalimet e ndriçimit publik dhe pajisjeve të çfarëdoqsi tipi, duhet të jenë të instaluar në mënyrë të tillë që të mos bëhen burim aksidentesh ose pengesash për personat në karrige me rrota.

4. Pjesët hyrëse të rrugëve e me trafik këmbësor të përzgjedhur, duhet të jenë gjithmonë të pajisura me të paktën një njësi të arritshmërisë.

## Neni 12 - Parkimet

1. Parkimi konsiderohet i arritshëm nëse sipërfaqja në të cilën lëviz personi në karrigen me rrota është në të njëjtin plan me sipërfaqet e këmbësorëve të shërbimit ose lidhja midis tyre, në raste disnivelsesh që kalojnë kafirin e lejuar, kryhet nëpërmjet pllathmave të pjerrëta ose të pajisjeve të përshtatshme të ngjites.

Hapësira e rezervuar e ndalimit të makinave të personave me aftësi të kufizuara duhet të ketë dimensionet të tilla që të lejojë edhe lëvizjen e këtyre personave në kohën e hyrjes në mjet. Ajo duhet bërë e dukshme nëpërmjet sinjaleve përkatëse horizontale dhe vertikale sipas standarteve të dhëna.

Parkimet duhet të vendosen në masën minimale 1 në çdo 50 vende makinash, me gjerësi



jo më të vogël se 320 cm dhe e rezervuar falas për makinat e personave me aftësi të kufizuara. Të ashtuquajtura vende makinash, të sinjalizuara, caktohen në ngjitje të vendkalimeve të këmbësorëve dhe në afërsi të hyrjes së ndërtesave ose pausjeve. Me qëllim lehtësimin e transferimit të personit në karrige me rrota në kushte të njëjta atmosferike, preferohet që vendet e makinave të rezervuara të jenë të pajisura me mbulesë. Vendparkimi për PAK duhet të vendoset afër hyrjes së ndërtesës. Vendparkimi për automjete, kur parkimi bëhet pjerrtas apo për së gjati në raport me trotuarin për këmbësorët, madhësia e tij duhet të jetë 370 x 500 cm, fig. 8. Nëse vendparkimi është për dy makina madhësia e tij duhet të jetë 590 x 500 cm me distancë ndërmjet tyre 150 cm, fig. 9. Dalja nga vendparkimi dhe hyrja në trotuarin e këmbësorëve kryhet me një pjerrësi 10% dhe gjërësi 120 cm.

2. Për vendet e rezervuara të vendosura paralelisht me drejtimin e lëvizjes, gjërësia duhet të jetë e tillë që të lejoj kalimin e një personi në karrige me rrota në mes të dy makinave. Kjo kërkesë është e plotësuar nëse gjatësia e vendit të makinës nuk është më e vogël se 6 m. Në një rast të tillë, gjërësia e një vendi të rezervuar për makinë nuk tejkalon gjatësinë e një vendi të zakonshëm për makinë (250 cm).

3. Vendet e rezervuara mund të kufizohen me vendosjen e mjeteve bllokuese të posaçme.

#### Neni 25 - Ndërtesat e institucioneve arsimore

1. Ndërtesat e institucioneve parashkollore, shkollore, përfshirë universitetet dhe institucione të tjera me interes shoqëror në sektorin e arsimit duhet të sigurojnë përdorimin e tyre edhe për nxënës me aftësi të kufizuara lëvizëse.

2. Strukturat e brendshme dhe të jashtme duhet të kenë karakteristikat për të cilat fitet në nenet përkatëse të "Rregullores për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara".

3. Mobilimi, mjetet ndihmëse didaktike dhe pajisjet e nevojshme për të siguruar zhvillimin e aktiviteteve didaktike duhet të kenë karakteristika të veçanta për personat me aftësi të kufizuara (banka, karrige, makina shkrimi, materiali Braille, dhoma zhveshjeje, etj).

4. Në rastin e ndërtesave shkollore me shumë kate pa ashenzor, klisa që frekuentohet nga një nxënës me aftësi të kufizuara duhet të jetë e vendosur në katin përdhe e arritshme nëpërmjet një kalimi të vazhdueshëm horizontal dhe me pjerrësi në pjesë të nevojshme të saj.

#### Neni 28 - Stacionet e mjeteve të transportit udhëtar

1. Stacionet kryesore hekurudhore duhet të jenë të pajisura me plane të pjerrta, platforma të lëvizshme ose mjete të tjera të përshtatshme për ngritje, me qëllim që të lehtësojnë hyrjen në to dhe në trenat të personave me vështirësi lëvizëse. Në hekurudhë është e lejueshme kalimi, nëpërmjet platformave të pjerrta lëvizëse dhe për disnivele më të mëdha se 3, 20 m. Në mungesë të platformave të pjerrta, ashenzorëve ose pajisjeve të tjera të nevojshme për një zhvendosje nga një trotuar në tjetrin, invalidi në karrige me rrota mund të përdori kalimet e shërbimit rrafsh me tokën vetëm kur është i shoqëruar nga personeli i autorizuar i stacionit.

2. Në stacionet e metrosë duhet të lehtësohet hyrja në katin e kalimit të trenit të metrosë për personat që qëndrojnë në karrige me rrota nëpërmjet instalimit të ashenzorëve të përshtatshëm dhe platformave të pjerrta lëvizëse sipas disniveleve.

3. Sistemi i thirrjes për njollimin i shërbimit të asistencës, duhet të realizohet në stacionet kryesore i mbështetur dhe nga personeli i hekurudhave, nëpërmjet aktivizimit të qëndrave të veçanta të ndihmës publike e bërë prezentë nëpërmjet mjeteve të informimit.

4. Enti që monashon këto shërbime është i detyruar që të informojë për shërbimet e ofruara klientët (PAK), si nëpërmjet stacione, biletari edhe në orarin e vet zyrtar.

5. Në çdo rast duhet të rezervohet një numër i përshtatshëm vendesh për t'u ulur për personat me aftësi të kufizuara lëvizëse ose ndihuese. Transporti i karrigës me rrota kryhet falas.



6. Ministria që mbulon fushën e transporteve, mbi bazën e të dhënave të marra nga ministria që mbulon fushën sociale në bashkëpunim me të, merr parasysh veçantitë e shërbimit hekurudhor, ndërhyrjet dhe planifikimin e tyre, mënyrën e financimit si edhe kriteret e detyrimeve që vijnë nga zbatimimi i rregullave për të cilat flitet në këtë nen, brenda limiteve të zakonshme të parashikuara në buxhet.

7. Rregullat e përcaktuara me këtë rregullore nuk janë të detyrueshme për ndërtesat, stacionet dhe ndalesat pa shërbime, pra pa personel shërbimi, si të përkohshëm ashtu edhe të përhershëm.



